



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Agjencia
Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe AdZM Kukës, Berat, Vlorë**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“MBI AUDITIMITN E PËRPUTHSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË MBI VEPRIMTARINË E USHTRUAR
NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË
MBROJTURA TIRANË DHE AdZM KUKËS, BERAT, VLORË”**

Tiranë, mars 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	8-10
1.	Objektivat dhe qëllimi	8-8
2.	Identifikimi i çështjes	8-8
3.	Përgjegjësitë e strukturave të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura	8.8
4.	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5.	Kriteret e vlerësimit	9-9
6.	Standardet e auditimit	9-10
7.	Metodat e auditimit	10-10
8.	Dokumentimi i auditimit	10-10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10-89
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10-11
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11-11
2.1	Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.	11-17
2.2	Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare dhe mbledhjes e përdorimit të të ardhurave.	17-34
2.3	Mbi auditimin e procedurave për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura, hartimit të planeve të menaxhimit si dhe monitorimin, inspektimin e kontrollin e veprimtarive të zhvilluara brenda territorit të tyre.	34-54
2.4	Mbi auditimin e procedurave të prokurimeve të fondeve publike.	54-83
IV.	REKOMANDIME	83-92

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr.1125/1 prot., datë 02.10.2024, i ndryshuar me nr.1125/2 prot., datë 08.11.2024, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe njësisë vartëse AdZM, Kukës, Berat, Vlorë, nga data 03.04.2021 deri në datën 30.09.2024.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është institucion publik, i cili është i varur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e ligjit 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar me ligjin nr.21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 4.2.2015 dhe ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në 12 qarqe, sipas administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të cilat kanë për detyrë administrimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura mjedisore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Zonat e mbrojtura mjedisore janë pasuri kombëtare, miratohen me Vendim përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit dhe aktualisht përbëjnë 21.3% të territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është organ qendror i specializuar në mbrojtjen e trashëgimisë shqiptare të agropylltarisë, mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit. Struktura dhe organigrama e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe institucioneve të varësisë së saj miratohen me urdhër të Kryeministrit. Buxheti i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura miratohet nga Ministria e Financave me propozim të ministrit përgjegjës. Të ardhurat, që rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit pasardhës. të cilat përdoren nga AKZM, si të ardhura jashtë limitit mbi bazë të legjislacionit në fuqi.

b. Rëndësia e auditimit:

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi, pasi i kushtohet vëmendje e veçantë çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të saj, si administrimi e kontrolli i zonave të mbrojtura; monitorimi dhe inspektimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe administrata rajonale të zonave të mbrojtura në qarqe mbi ushtrimin e veprimtarive ekonomike të lejuara në zonë të mbrojtur; përdorimi me efektivitet i fondeve publike; zbatimi i ligjshmërisë të procedurave të prokurimeve publike; grumbullimi i të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhën në zonat e mbrojtura dhe përdorimi i tyre, si dhe i krijimit të fondit të veçantë për zonat e mbrojtura.

c. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe AdZM Kukës Berat, Vlorë, me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 03.04.2021-30.09.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Ligjshmëria e hartimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Auditimi i të ardhurave të institucionit.
- Hartimi dhe miratimi i pasqyrave financiare.
- Monitorimi i procedurave për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura.
- Auditimi i procedurave të prokurimit me fonde publike dhe zbatimi i kontratave.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është miks, sasiore dhe cilësore. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe

në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse: Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit; Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit; Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 21 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime. Nga të cilat: 15 masa organizative; 3 masa për shpërblim dëmi në vlerë 4,973,060 lekë dhe 3 masa për eliminimin e efekteve negative, të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për periudhën objekt auditimi u konstatuan problematika si më poshtë:

-Rezultuan parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues dhe në procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave nga strukturat e AdZM-ve dhe AKZM-së. Sektori i Menaxhimit në AdZM-të nuk ka përcaktuar dhe përshkruar në mënyrë specifike objektin e veprimtarisë së lejuar që do të ushtrohet në zonën e mbrojtur, siç kërkohet në pikën 3/c të VKM-së nr. 1156, datë 24.12.2020.

-Për periudhën Janar 2022 - 30 Shtator 2024 nga Drejtoria/Sektori i Monitorimit në AKZM dhe AdZM-të, rezultoi të jenë kryer 636 inspektime dhe sipas procesverbaleve të mbajtur në vend, ka vlerësuar gjithsej me vlerë dëmi shumë prej 590,457,704 lekë, përkatësisht: nga zjarret 157 raste me vlerë 260,795,000 lekë dhe nga veprimtaritë e kundërligjshme (prerje drurësh, gurë dekorativë, etj.) 479 raste me vlerë 329,662,704 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se kjo vlerë nuk është kontabilizuar si detyrim dhe nuk është arkëtuar për periudhën objekt auditimi, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e AKZM-së.

-Deri në 30.09.2024 janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje, për dhënie në përdorim të sipërfaqeve në zonë të mbrojtur. Nga auditimi u konstatua se, 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë rezultuan me detyrime të papaguara dhe të pakontabilizuara, përkatësisht: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë (16 në proces gjyqësor, 4 kallëzim penal, 7 në negociatë për lidhje akt marrëveshje) dhe 26 HEC-e me detyrime të papaguara në vlerë 367,508,531 lekë (25 në proces gjyqësor, 1 kallëzim penal), të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e AKZM-së.

-Brenda zonave të mbrojtura u konstatuan 784 ndërtime informale, të cilat janë krijuar kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. AKZM gjatë periudhës 2022- shtator 2024 dhe për të gjitha rastet ka njoftuar institucionet ligj zbatuese si: IKMT-në, Drejtorinë e Policisë dhe Prokurorinë e qarkut përkatës, prej të cilave nuk konfirmohet të kenë kthyer përgjigje zyrtare, duke mos vijuar kështu me procedurat e mëtejshme, me qëllim ndëshkimin sipas ligjit të subjekteve/personave përgjegjës.

- Nga kualifikimi i OE "I." sh.p.k dhe s'kualifikimit të padrejtë të BOE "A." u konstatua se veprimet KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor të këtij të fundit në vlerën 600,000 lekë (11,200,000 – 10,600,000) si diferenca midis ofertave të BOE në klasifikim.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike me objekt: "Ndërtim i Hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur "Syri i Kaltër" rezultuan punime të pakryera, nga kontraktori "F." sh.p.k, në vlerën 2,901,420 lekë me T.v.sh.

-Lidhur me procedurat e prokurimit me objekt: "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi" (gjashtë lote) me vlerë të realizuar 2,741,250 lekë pa T.v.sh dhe të procedurës së prokurimit me objekt: "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi" (nëntë lote) me vlerë të realizuar 4,866,222 lekë pa T.v.sh, gjithsej me vlerë të realizuar 7,227,472 lekë pa T.v.sh rezultoi se, grupi i punës së përllogaritjes së fondit limit, nuk ka kërkuar analizën e ofertave sipas përbërjes së zërave të kostos (kosto ekspertesh, kosto administrative) të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, Termave të Referencës.

- Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi se, kjo llogari në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 3,528,693 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërsa në pasqyrën nr. 5 "Shënime shpjeguese për periudhën raportuese të bilancit" paraqitet në vlerën 148,426,101 lekë. Nga Drejtoria e Financës nuk u paraqit analizë se kujt i përkasin detyrimet e vitit 2022 dhe mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël e ligjor për heqjen e tyre në fund të vitit 2023. Ndërsa nga auditimi, rezultoi se vlera e detyrimeve të papaguara e të pa kontabilizuara nga kontratat e qirasë, deri në 30.09.2024 është në vlerë të konsiderueshme, në total 397,013,980 lekë.

-Nga analiza e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar" rezultoi se, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në shumën prej 1,084,595,950 lekë. Në Formatin nr. 4 (Pasqyra e Ndryshimeve të aktiveve neto), teprica në çelje e fondeve neto është pasqyruar gabimisht duke iu referuar mbylljes së vitit 2021, në shumën prej 306,793,959 lekë, ndërkohë që duhet të ishte në shumën prej 805,735,096 lekë, sipas mbylljes së vitit 2022. Ky gabim ka bërë që ndryshimet e fondeve neto gjatë vitit 2023 të mos pasqyrohen saktë.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdZM-të në vijimësi, të marrë masa që nënshkrimi i kontratave të qirasë për dhënie në përdorim të sipërfaqeve zonë e mbrojtur, të jetë i shoqëruar me dokumentacionin e plotë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Monitorimit/Inspektimit dhe Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Institucionet ligj zbatuese si, IKMT, Drejtorinë e Policisë dhe Prokurorinë e rrethit përkatës, të marrin të gjitha masat administrative dhe ligjore me qëllim arkëtimin e plotë të vlerës së dëmit në shumën prej 590,457,704 lekë.

-Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të bashkëpunojnë nëpërmjet komunikimit zyrtar me institucionet ligj zbatuese si: Gjykatë, Prokurori të rrethit përkatës, për ndjekjen e 53 subjekteve në vlerë 397,013,980 lekë, deri në daljen e vendimit përfundimtar, me qëllim arkëtimin e plotë të vlerës së detyrimit.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdZM-të të marrin masa për të adresuar aktivitetet informale dhe ndërtimet e paligjshme brenda zonave të mbrojtura, duke krijuar një plan veprimi të detajuar e duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet lokale dhe institucionet ligj zbatuese IKMT, Drejtorinë e Policisë, Prokurorinë e qarkut përkatës dhe të njoftojnë MTM-në, për nxjerrjen e përgjegjësive dhe ndëshkimin e autorëve sipas legjislacionit për zonat e mbrojtura për 784 rastet informale.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ligjore e financiare të nëpunësve, të cilët kanë kryer veprime në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, me qëllim që të vlerësojnë e të analizojnë shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën prej 600,000 lekë në dëm të Buxhetit të Shtetit.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej 2,901,420 lekë, dëm ekonomik nga kontraktori "F." sh.p.k për punime të likuiduara, por të perealizuara.

-Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa që çdo kriter i vendosur duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës sipas Termave të Referencës me qëllim përcaktimin e vlerës sa më reale të kontratës.

-Drejtoria e Financës në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese kontabël në lidhje me pasqyrimin dhe evidentimin e të drejtave dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në pasqyrën e pozicionit financiar.

-Drejtoria e Financës të marrë masa të pasqyrojë ndryshimet aktiveve neto në Formatin nr. 4, duke siguruar që të dhënat të jenë në përputhje me pasqyrën e pozicionit financiar dhe me parimet kontabël të pranura.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion i auditimit të përputhshmërisë (i modifikuar)¹

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë:

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për periudhën 03.04.2021-30.09.2024, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të modifikuar**.

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomali të konstatuara, si më poshtë:

- Janë konstatuar 784 ndërtime dhe aktivitete in formale, që i përkasin periudhës kohore kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), të cilat janë adresuar tek institucionet ligj zbatuese, por nuk konfirmohet kthim përgjigje prej tyre.

¹ Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.103), Kapitulli VII, pika 7.3.3 Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

-Deri në 30.09.2024 janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje, për dhënie në përdorim të sipërfaqeve në zonë të mbrojtur, nga të cilat 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë rezultojnë me detyrime të papaguara dhe të pa kontabilizuara, të përbërë nga: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë (16 në proces gjyqësor, 4 kallëzim penal, 7 në negociatë për lidhje akt marrëveshje) dhe 26 HEC-e me detyrime të pa paguara në vlerë 367,508,531 lekë (25 në proces gjyqësor, 1 kallëzim penal), që përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

-Lidhur me dy procedurat e prokurimit me objekt: “Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi” me vlerë të realizuar gjithsej 7,227,472 lekë pa T.v.sh, u konstatua se: nga grupi i punës, përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë specifikisht sipas përbërjes së zërave të kostos (nga kosto ekspertësh, kosto administrative) dhe sipas termave të referencës të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Hartime Planesh të Integruara të Menaxhimit*” datë 15.10.2021 ka rezultuar vlera 600,000 lekë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, veprime të kryera në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike me objekt: “Ndërtim i hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur “Syri i Kaltër” rezultuan punime të pakryera, nga kontraktori “F.” sh.p.k, në vlerën prej 2,901,420 lekë me T.v.sh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

-Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi se, kjo llogari në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 3,528,693 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërsa në pasqyrën nr. 5, "Shënime shpjeguese për periudhën raportuese të bilancit" paraqitet me vlerën 148,426,101 lekë.

Nga Drejtoria e Financës nuk u paraqit analizë se kujt i përkasin detyrimet e vitit 2022 dhe mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël e ligjor për heqjen e tyre në fund të vitit 2023. Ndërsa nga auditimi, rezultoi se vlera e detyrimeve të papaguara e të pa kontabilizuara nga kontratat e qirasë, deri në 30.09.2024 është në vlerë të konsiderueshme, në total 397,013,980 lekë.

-Nga analiza e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar” rezultoi se, teprica në çelje e fondeve neto është pasqyruar gabimisht duke iu referuar mbylljes së vitit 2021, me një shumë prej 306,793,959 lekë, ndërkohë që duhet të ishte në shumën prej 805,735,096 lekë, sipas mbylljes së vitit të mëparshëm 2022.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1125/1 prot., datë 02.10.2024, ndryshuar me nr.1125/2 prot., datë 08.11.2024, "Auditim mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë" mbi veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë, për periudhën nga 03.04.2021 deri në 30.09.2024, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

V. B. Përgjegjëse Grupi

Xh. K. Audituese

A. K. Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat dhe qëllimi i auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në AdZM Kukës, AdZM Berat, Vlorë, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datë 30.09.2024 është dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar

në standardet ISSAI. Gjithashtu objektivat përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315) dhe hartimin e Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

Identifikimi i çështjes: Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm në administrimin e kontrollin e zonave të mbrojtura; monitorimi dhe inspektimin nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe administrata rajonale të zonave të mbrojtura në qarqe, mbi ushtrimin e veprimtarive ekonomike të lejuara në zonë të mbrojtur. Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor në fuqi, etj.;

-Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).

-Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

-Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Udhëzimit Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;

-UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;

-Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

-VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;

Në fushën e administrimit të të ardhurave:

Ligji nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i azhurnuar me Ligjin nr.21/2024.

-Vendimin nr.1156, datë 24/12/2020 “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”

-Vendimin nr.19, datë 20.01.2021, të Këshillit të Ministrave “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”,

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit:

-Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

-VKM nr.102, datë 4.2.2015 i ndryshuar “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administratave rajonale të zonave të mbrojtura”;

-Rregullores Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave të Zonave të Mbrojtura”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.51, datë 6.2.2024;

Në fushën e prokurimit:

-Ligji nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” etj.

-Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;

-Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

Standardet e auditimit:

-ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;

-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;

-Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
-Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

Metodat e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikash me drejtimet e auditimit;

c. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH-së janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti.

Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet dhe Verifikimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt dhe Raport Auditimi.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, kryen veprimtarinë e saj referuar dispozitave të Ligjit nr.81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, i azhurnuar me Ligjin nr.21/2024, të VKM-së nr.102, datë 4.2.2015, i ndryshuar “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administratave rajonale të zonave të mbrojtura” dhe ka si qëllim të sigurojë mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura

mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore.

Veprimtaria buxhetore dhe financiare e AKZM -së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i AKZM-së miratohet nga Ministria e Financave me propozim të ministrit përgjegjës. Të ardhurat, që rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës, të cilat përdoren nga vetë AKZM sipas rregullave dhe udhëzimeve në fuqi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve:

2.1. Mbi auditimin e hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Për auditimin e të cilave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Urdhri i titullarit për hartimin e projekt buxhetit për periudhën 2021-2024.
- 2.Programi Buxhetor Afatmesëm i miratuar për periudhën 2021-2023, 2022-202, 2023-2025, 2024-2026 me ndryshimet përkatëse dhe shkresat përcjellëse për periudhat përkatëse.
- 3.Çelja e buxhetit të vitit 2021-2024, si dhe detajimi i shpenzimeve administrative sipas programeve dhe produkteve.
- 4.Shkresat për rishikimet e buxhetit (rialokime, shtesa/pakësime) gjatë vitit 2021-2024.
- 5.Raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021, 2022, 2023 dhe 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

A. Kërkesat buxhetore PBA 2021-2023, PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025 nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk janë dërguar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me pikën 7 të Udhëzimit Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” ku citohet: “Çdo njësi e qeverisjes qendrore përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm, gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare) duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikës së programi” dhe pika 2.3 Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Qeverisjes Qendrore “..Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore ka përgjegjësi të miratojë kërkesat buxhetore..”; me Nenin 27 pika 1 të Udhëzimit plotësues nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”; me pikën 1 të Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, me pikën 1 të Udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

-Duke qenë se nga ana e Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk janë hartuar dhe dërguar kërkesat buxhetore PBA 2021-2023, PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025 nuk mund të analizojmë dhe krahasojmë kërkesat sipas artikujve ekonomikë për shpenzimet korrente dhe ato kapitale për periudhën e auditimit 2021-2023, mos hartimi i të cilave nuk bën të mundur një para shikueshmëri në alokimet e ardhshme afatmesme (3-vjeçare) për investime dhe shpenzime korrente midis qeverisjes qendrore dhe subjektit, përgjegjës i së cilës është struktura menaxheriale e institucionit

-Kërkesat buxhetore PBA 2024-2026, janë dërguar pranë Drejtorisë së Financave së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me shkresë nr.2921 prot., datë 28.02.2023, të shoqëruara me relacionin shpjegues.

-Kërkesat buxhetore për PBA 2024-2026 nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) dhe jo sipas formatit të udhëzimeve të MFE për përgatitjen e PBA-së, në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit plotësues nr.5, datë 2F8.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026". (Sipas të dhënave të paraqitura në Aneksin 1/1 bashkëlidhur Raportit të Auditimit).

-Nga shqyrtimi i të dhënave, del se plani përfundimtar i buxhetit të vitit 2024, krahasuar me kërkesat buxhetore rezulton me diferencë më pak për 913,509 mijë lekë, ku shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale me nga 50% më pak secila.

-Kërkesat buxhetore për investime nuk janë miratuar për shumën 458,250 lekë (10% zënë shpenzimet kapitale pa trupëzuara (Ilog.230) dhe 90% zënë shpenzimet kapitale të trupëzuara (Ilog.231).

B. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe plani përfundimtar.

Detajimi i limitit mujor të fondeve të AKZM-së është bërë mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në ligjet vjetore të buxhetit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave përkatësisht sipas viteve. Për vitin 2021 është dërguar nga MTM me shkresë nr.522 prot., datë 21.01.2021 detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente; me shkresë nr.1098/1 prot., datë 04.03.2021 detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale dhe me shkresë nr.1604/2 prot., datë 26.03.2021 detajimi i fondit të veçantë, ndërsa për vitin 2022 me shkresë nr.134 prot., datë 03.02.2022 është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente dhe me shkresë nr.174 prot., datë 08.02.2022 detajimi i fondit të veçantë. (Sipas të dhënave të paraqitura në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit të Auditimit).

Nga shqyrtimi i të dhënave del se, plan buxheti i vitit 2021 është 266,002 mijë lekë dhe 304 numri gjithsej i punonjësve.

-Buxheti përfundimtar i akorduar nga MTM, është në shumën 428,745 mijë lekë dhe rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

-Plani fillestar ka ndryshuar me një vlerë në rritje me 162,743 mijë lekë (duke rritur shpenzimet kapitale rreth 95% dhe shpenzimet për paga rreth 5%), krahasuar me planin përfundimtar.

Plan buxheti i vitit 2022 është 319,000 mijë lekë dhe 304 numri gjithsej i punonjësve.

-Buxheti përfundimtar i akorduar nga MTM është në shumën 333,663 mijë lekë dhe rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit me shkresë nr.651 prot., datë 20.02.2023.

- Plani fillestar ka ndryshuar me një vlerë në rritje me 14.663 mijë lekë, krahasuar me planin përfundimtar (duke rritur shpenzimet kapitale për rreth 96% dhe shpenzimet për paga rreth 4%). Për vitin 2023, detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Nga MTM është dërguar me shkresë nr.487/1 prot., datë 30.01.2023 dhe shkresë nr.1612/1 prot., datë 13.03.2023, plan buxheti për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale të vitit 2023 në limit vjetor dhe mujor.

Plan buxheti për vitin 2023 është në shumën 358,250 mijë lekë dhe 308 numri gjithsej i punonjësve, i cili rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit, sipas shkresës me nr.589 prot., datë 08.02.2024.

-Plani fillestar krahasuar me planin përfundimtar ka ndryshuar me një vlerë në rritje në total me 47,162 mijë lekë (rritur: rreth 87% shpenzimet operative, rreth 25% shpenzimet për paga dhe rreth 5% shpenzimet për sigurime shoqërore si rezultat i 24 vendeve të lira të punës dhe zbritur shpenzimet kapitale për rreth 17%).

-Me shkresë nr.988/1 prot., datë 02.03.2024 të MTM-së është alokuar shuma 600 mijë lekë për fondin e veçantë.

-Me shkresë nr.5154/5 prot., datë 12.09.2023 të MTM-së, është bërë transferim i fondeve në pakësim të shpenzimeve kapitale (Ilog.230) në shumën 8,400 mijë lekë për Projektin “Hartim projekti multifunksional në Luginën e Vjosës” dhe shtohet (Ilog.231) Aparati i MTM për

Projektin: “Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore Eko Park Ulza”, e cila nuk rezulton të jetë e shoqëruar me relacion shpjegues dhe argumentues.

-Sipas VKM-së nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me BE” janë paguar 2 koordinatorë sipas listës së konfirmuar me shkresë nr.84/1prot., datë 09.01.2024 të MTM-së.

-Sipas VKM-së nr. 834, datë 28.12.2023, pika 1/a, kanë përfituar shpërblim në masën 10,000 lekë 146 punonjës të shërbimeve mbështetëse.

Gjatë vitit janë bërë kërkesa për shtesë fondi:

▪ Me shkresë nr.1858 prot., datë 24.5.2023 të AKZM-së është kërkuar shtesë fondi për shpenzime operative në shumën 25,886,105 lekë dhe për shpenzime kapitale në shumën 9,524,844 lekë, përkatësisht:

-Shuma 5,000,000 lekë, për likuidimin e detyrimit për vitin e mëparshëm 2022 dhe vitin koherent 2023 për blerje fidanë.

-Shuma 4,524,844 lekë (kap 4) për rimbursim të t.v.sh-së për vitin 2022, për Projektin e “Rezervës ndërkufitare të Biosferës së Prespës-Shqipëri” Grandi Nr.BZ201366830, sipas Marrëveshjes financiare KFW Frankfurt AM Main dhe qeverisë shqiptare, i cili ka hyrë në fuqi 2 maj 2018 me datë mbyllje 30.12.2024.

-Shuma 15,943,974 lekë për blerje karburant, sipas kontratës me nr.1609, datë 24.04.2023 dhe kontratës nr.1610 datë 28.04.2023 lidhur midis operatorit ekonomik fitues dhe AKZM, sipas Marrëveshjes Kuadër e zhvilluar nga Agjencia e Blerjes së Përqendruar, për të cilën procedura e kontrollit mbi limitet e angazhimit, është bërë në kundërshtim me Udhëzimin plotësues, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” pika 43 ku “*Në rastet e marrëveshjes kuadër ...Urdhri i prokurimit që titullari i njësisë shpenzuese nxjerr bazuar në marrëveshjen kuadër do të konfirmohet paraprakisht për vlefshmërinë e fondeve pranë degës respektive të thesarit ose do të regjistrohet në SIFQ nga njësitë shpenzuese me akses të drejtpërdrejtë në sistem*”.

-Shuma 4,240,703 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për shërbim roje fizike për periudhën prill-dhjetor 2023, nga Amendimi i kontratës nr. 2876, datë 13.12.2022, lidhur midis operatorit ekonomik "N....." sh.p.k dhe AKZM, për shkak të ndryshimit të pagës minimale, sipas VKM nr. 113, datë 01.03.2023;

-Shuma 5,000,000 lekë për regjistrim të pronave të institucionit, pranë ASHK-së;

-Shuma 701,428 lekë, për ekzekutim të vendimeve gjyqësore ndaj dy ish punonjësve;

▪ Me shkresë nr. 1920 prot., datë 29.05.2023, të AKZM-së dhe shkresë nr. 3460/3, datë 16.06.2023, të MTM-së, është rialokuar fondi buxhetor në shumën 11 milionë lekë, nga artikujt 600 dhe 601 (9.8 milionë lekë dhe 1.2 milionë lekë) në artikullin 602, për shpenzime emergjente për objektet në administrim të AKZM-së. Kërkesa për këtë rialokim nuk është e detajuar dhe e argumentuar.

▪ Me shkresë nr. 4512/1, datë 24.07.2023, të MTM-së, është rialokuar një fond shtesë prej 46,700 mijë lekë për të mbuluar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si pasojë e rritjes së pagave.

▪ Me shkresë nr.3332/2 prot., datë 27.9.2023 të AKZM-së është kërkuar shtesë fondi për llog. 602 “shpenzime operative” në shumën 39,182,611 lekë, të cilat përfshijnë detyrime të disa muajve të vitit 2023 dhe vitit të mëparshëm dhe 7,348,161.95 lekë për rimbursim t.v.sh fatura të vitit 2022, për Projektin e Prespës nga KFW-Rezerva ndërkufitare e biosferës së Prespës. Kodi projektit BMZ201366830, të cilat nuk janë të analizuar dhe argumentuar për secilën prej tyre. Përsa më lart, nga analiza e të dhënave të kërkesës për shtesë fondi nga AKZM, del se nevojat për të mbuluar kostot e rritura operative dhe kapitale nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të mjaftueshme, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 *Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme,*

kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimit e mundshme dhe pasojat; pika 80/a Regjistrimi dhe mbartja e kontratave, vjetore apo shumëvjeçare, bëhet nga dega e thesarit përkatës, sipas vlerave të përcaktuara për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar” dhe Udhëzimit plotësues, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 22, Projektet në vazhdim nga viti 2021-2022 ose më parë do të financohen me përparësi dhe duhet të jenë pjesë e prioritetëve të propozuara për financim gjatë vitit 2023”; pika 22/c “Likuidimet e detyrimeve (faturave) kontraktore, të jenë të lidhura me ecurinë fizike të punimeve, pika 45 “Nëse në muajin janar në përfundim të rakordimit vjetor të angazhimit të mbartur (mbetur nga pagesat e kryera gjatë vitit kaluar) nuk ka fonde buxhetore të reregjistruara në SIFQ për vitin ushtrimor apo për dy vitet e ardhshme, atëherë vlera e mbetur e kontratës regjistrohet në vitin buxhetor pasardhës që vjen menjëherë pas vitit të fundit të ligjit të miratuar të buxhetit trevjeçar për të siguruar evidentimin e vlerës së plotë të angazhimit të qeverisë ndaj operatorëve ekonomikë”.

Për vitin 2024, detajimi i limitit mujor të AKZM-së është bërë mbështetur në Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” dhe me shkresë nr.133/4 prot., datë 12.02.2024; nr.1011/2 prot., datë 01.03.2024 të MTM-së është dërguar plan buxheti për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale të vitit 2024 në limit vjetor dhe mujor.

Buxheti i akorduar nga MTM-ja për vitin 2024 në shumën 459,400 mijë lekë dhe 308 numri gjithsej i punonjësve, i cili rakordon me situacionet mujore/progresive të muajit shtator 2024 të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit me nr.3569 prot., datë 28.10.2024.

-Plani fillestar krahasuar me planin përfundimtar deri në 30.09.2024, ka ndryshuar me një vlerë në rritje në total me 33,700 mijë lekë (zbritur 7,000 mijë lekë shpenzimet për paga si rezultat i 25 vendeve të lira dhe rritur shpenzimet për art. 602).

-Shpenzimet kapitale janë në shumën 48,000 mijë lekë, të cilat nuk kanë pësuar ndryshime me planin përfundimtar deri në 30.09.2024.

▪ Me shkresë nr.1110/3 prot., datë 11.03.2024 të MTM-së janë alokuar shpenzime për fondin e veçantë, në shumën 700 mijë lekë.

▪ Me shkresë nr.294 prot., datë 19.01.2024 të AKZM-së është kërkuar shtesë fondi në llog. ek. 602, në shumën 59,466,974 për blerje karburant, shërbim roje fizike, për regjistrimin e pronave në ASHK, të cilat janë të parashikuara në PBA 2024-2026, por nuk është e argumentuar dhe shoqëruar me relacion shpjegues, për çdo zë shpenzimesh, në kundërshtim me Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71.

▪ Me shkresë nr.509 prot., datë 02.02.2024 të AKZM-së është kërkuar çelje e fondit të veçantë në llog. ek (606) në shumën 938,750 lekë për punonjësit që dalin në pension dhe për ndihma në raste fatkeqësish, sëmundjesh etj, shoqëruar me listën e punonjësve përfitues.

▪ Me shkresë nr.1094 prot., datë 20.03.2024 të AKZM-së është kërkuar saktësimi i emërtimit dhe llogarisë ekonomike i projektit nga hartimi (230) në zbatim të projektit (231) “Shtigjet në rrjetin e zonave të mbrojtura”- Shtegu ish-rezervat Liqeni Bovillës, në vlerën 30,000 mijë lekë, e cila është parashikuar në PBA 2024-2026 në shumën 250,000,000 lekë.

▪ Me shkresë nr.1083/2 prot., datë 08.04.2024 të AKZM-së është kërkuar shtesë fondi në llog ek. 602 për “Shërbimin e ruajtjes fizike, viti 2024” në shumën 40,500 mijë lekë dhe në llog. ek. 231 projekti “Environmental and Tourism solutions for the Shkodra Lake” në shumën 495,733.3 lekë.

▪ Me shkresë nr.2962 prot., datë 08.09.2024 të AKZM-së është kërkuar çelje e fondit të veçantë në llog. ek (606) në shumën 280,000 lekë për punonjësit që dalin në pension dhe për ndihma në raste fatkeqësish, sëmundjesh etj, shoqëruar me listën e punonjësve përfitues.

C. Realizimi i planit të buxhetit.

Realizimi i buxhetit të AKZM për vitin 2021, 2022 krahasuar me planin e përfundimtar përkatësisht, paraqitet si më poshtë: (sipas të dhënave të paraqitura në Aneksin 1/3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit).

Nga shqyrtimi i të dhënave të realizimit të buxhetit rezulton se, **për vitin 2021** sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar 428,745 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore është në vlerën 426,923 mijë lekë ose 99.6%. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 186,343 mijë lekë, ose 100%, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 31,334 mijë lekë ose 98%. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime janë realizuar në shumën prej 54,307 mijë lekë ose 100 % e buxhetit të rishikuar dhe zënë 20% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 154,266 mijë lekë ose në masën 99%.

Viti 2022. Sipas buxhetit të rishikuar janë alokuar 333,664 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore është në vlerën 332,708 mijë lekë ose 99.7%. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 188,734 mijë lekë, ose 100%, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 31,785 mijë lekë ose 99%. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime janë realizuar në shumën prej 42,927 mijë lekë ose 100 % e buxhetit të rishikuar dhe zënë 16% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 63,304 mijë lekë ose në masën 99%.

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se për **vitin 2023** fillimisht janë alokuar 358,250 mijë lekë, dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 405,412 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore është në vlerën 390,006 mijë lekë ose 96%. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 231,006 mijë lekë ose 100%, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 38,807 mijë lekë, ose 100%. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime janë realizuar në shumën prej 74,504 mijë lekë ose 86 % e buxhetit të rishikuar dhe zënë 22% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor. Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 45,411 mijë lekë ose në masën 96%.

-Edhe pse në total shpenzimet janë realizuar në masën 96%, shpenzimet në fakt në fund të periudhës për zërin shërbime (602) dhe zëri transferta (606) rezultojnë të realizuara më pak, krahasuar me planin përfundimtar, ndërsa zëri shpenzime kapitale (230 dhe 231) rezultojnë të realizuar më pak, krahasuar me planin fillestar, pra kërkesat për shtesë fondi dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit nuk kanë qenë të mirë studiuar, të analizuara e të argumentuara për çdo zë shpenzimesh.

Sipas PBA 2024-2026 për **vitin 2024** në total janë kërkuar 1,372,909 mijë lekë, nga të cilat janë alokuar me planin fillestar 425,700 mijë lekë. Ndërsa si 9-mujor plani i alokuar është 459,400 mijë lekë dhe realizuar në shumën 281,926 mijë lekë ose 61%.

Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 196,400 mijë lekë, ose 72%; shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 33,262 mijë lekë ose 71% të cilat vijnë nga mosplotësimi i 25 vendeve të lira të punës, që sjellin diferenca si në planifikim ashtu dhe në realizim të fondit të pagave dhe të sigurimeve shoqërore. Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 51,550 mijë lekë, ose rreth 57 % dhe zënë rreth 18% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Shpenzimet për investime janë parashikuar në shumën 48,000 mijë lekë, të cilat nuk rezultojnë të realizuara.

Në mënyrë të përmbledhur buxheti dhe realizimi i tij për vitet 2021-2024:

Në vitin 2021, buxheti i alokuar është 266,002 mijë lekë dhe rishikuar në 428,745 mijë lekë, me një rritje prej 162,743 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve është 426,923 mijë lekë, ose 96% e buxhetit të përfundimtar, që tregon një rishikim të konsiderueshëm të buxhetit nga plani fillestar në atë përfundimtar dhe përdorim efikas të shpenzimeve.

Në vitin 2022, buxheti i alokuar është 319,000 mijë lekë dhe rishikuar në 333,664 mijë lekë, me një rritje prej 14,664 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve është 332,708 mijë lekë, ose 99.7% e buxhetit përfundimtar, që tregon një rritje të moderuar të buxhetit dhe një realizim shumë afër 100%, si dhe një menaxhim më të mirë të alokimeve dhe përdorim efikas të shpenzimeve.

Në vitin 2023, buxheti i alokuar është 358,250 mijë lekë dhe rishikuar në 405,412 mijë lekë, me një rritje prej 47,162 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve është 390,006 mijë lekë, ose 96% e buxhetit përfundimtar. Viti 2023 ka një rishikim të konsiderueshëm dhe mosrealizim të shpenzimeve, kryesisht shpenzimet për shërbime dhe ato kapitale.

Në vitin 2024, buxheti i alokuar është 425,700 mijë lekë dhe deri në 30.09.2024 rishikuar në 459,400 mijë lekë, me një rritje prej 33,700 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve deri në 30.09.2024 është 281,926 mijë lekë, ose 61% e buxhetit përfundimtar, që tregon vonesa në realizimin e buxhetit ose rishikime të mundshme për periudhën e ardhshme apo mund të kërkojë nevojën e menaxhimit më të mirë të shpenzimeve gjatë vitit.

Analiza e shpenzimeve sipas artikujve:

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor dhe progresiv për çdo vit kalendarik. Një kopje e situacionit dërgohet çdo muaj Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në MTM. Regjistrimi shpenzimeve bëhet sipas Urdhër Pagesës dhe sipas rendit kronologjik.

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore shoqërohen me dokument justifikues si listë pagesa e firmosur nga NZ, nga NA dhe firmosur dhe vulosur nga punonjësi Degës së Thesarit. Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2021 zënë 80 %, për vitin 2022 zënë 82% dhe për vitin 2023 zënë 78% dhe në 9-mujorin e vitit 2024 zënë 82% të totalit të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor përkatës.

Shpenzimet operative shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, faturë blerje, fletëhyrje në magazinë, urdhër prokurimi, kontratë furnizimi, procesverbal, etj. Në strukturë shpenzimet operative për vitin 2021 zënë 20 %, për vitin 2022 zënë 16%, për vitin 2023 zënë 22% dhe në 9/mujorin e vitit 2024 zënë 18% të totalit të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor përkatës, jo të mjaftueshme duke pasur parasysh aktivitetin dhe shtrirjen në këto qarqe.

-Shpenzimet për materiale zyre, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, fletë hyrje në magazinë, etj.

Shpenzimet korrente në total për këtë institucion, janë realizuar në vitin 2021 dhe vitin 2022 me 100% , në vitin 2023 me 96% dhe në 9/mujorin e vitit 2024 me 69%.

-*Shpenzime nga të tretët* përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes së sigurisë, etj. Shpenzimet bazohen në urdhër shpenzim, faturë shitje, urdhër prokurimi, kontratë shërbimi, etj.

-*Shpenzimet e transportit* paraqesin shpenzime për blerje karburanti për automjetet e institucionit. Dokument vërtetues urdhër prokurimi, fatura e shitjes, fletë hyrje në magazinë, fletë dalje etj.

-*Shpenzimet kapitale* në total janë realizuar në vitin 2021 dhe vitin 2022 me 99%, në vitin 2023 me 96% dhe në 9-mujorin e vitit 2024 me 87%, dhe përfshijnë shpenzime për hartime projektsh për zonat e mbrojtura, për blerje fidanësh për shëndetësimin e zonave të mbrojtura, për zbatim projektsh etj,

-Nga auditimi ka rezultuar mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për vitin 2021, për 4/mujorin dhe 8/mujorin e vitit 2022, të cilat duhet të dërgohen në MTM. Mungesa e raporteve të monitorimit cënon vlerësimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor. Po ashtu, mungesa e masave korrigjuese për të përmirësuar situatën është në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III dhe pikën 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”; Udhëzimin plotësues, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 127, Ligji 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65:

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm znj.D.P, drejtores Drejtorisë së Financës znj.R. M.

2.2 Mbi auditimin e rregullshmërisë së pasqyrave financiare dhe mbledhjes e përdorimit të të ardhurave.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiar për vitin 2023 së bashku me pasqyrat shoqëruese;
- Kartelat e llogarive kontabël me tepricat dhe lëvizjet përgjatë vitit në nivel analitik;
- Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël;
- Ditari i kontabilitetit nga sistemi kontabël;
- Regjistri i aktiveve afatshkurtra së bashku me lëvizjet;
- Pasqyrë e llogarisë bankare në bankë të nivelit të dytë;
- Akt rakordim me thesarin për të ardhurat, shpenzimet, mjetet në ruajtje, etj.
- Të tjera dokumente mbështetëse.
- Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit të aktiveve.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare.

Për vitin 2023 njësia shpenzuese Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet si dhe në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë.

Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2023.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm si njësi shpenzuese pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese. Ky subjekt është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë me NIPT L41515454H.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, Sekretarit të Përgjithshëm së Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresë përcjellëse nr. 1210 prot., datë 28.03.2024.

Janë plotësuar për vitin 2023 pasqyrat financiare me anekset e tyre, me përbërjen si vijon:

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; (formati 7/a, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), formati 7/b, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Nga verifikimi i situacionit të shpenzimeve dhe të të ardhurave, rezultoi të jenë të rakorduar për çdo muaj për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor. Në bazë të të dhënave kontabël të tyre janë përpiluar pasqyrat financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

- Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet vërtetuese (situacionet e shpenzimeve dhe transaksionet e kryera dhe të rakorduar me Degën e Thesarit), të cilat kanë shërbyer si të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për regjistrimin e sistemimeve në kartelat kontabël, të cilat pasqyrojnë veprimet e kryera sipas dokumenteve vërtetuese, ditari i magazinës, veprime që janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE nr.5 , datë 21.02.2022“.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe në vlerë, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi janë të hartuara me elementet që kërkon formati i miratuar dhe shoqërohen me dokumente vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, procesverbalet, etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), mbi të cilat vlerësohet gjendja pasurore dhe financiare njësisë.

Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, ku u konstatua se, ka rast ku tepricat në çelje për vitin 2023 nuk rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Informacionet shpjeguese në Formatin 5 - Shënimet shpjeguese nuk janë përfshirë në të gjitha rastet në pasqyrat financiare.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezultoi se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF.

Pasqyra e pozicionit financiar me tepricat e llogarive në fund të vitit 2023, krahasuar me pozicionet e një viti më parë paraqitet në Aneksin nr.2 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

I. Aktive Afatshkurtra.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 159,417,031 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow) sipas metodës direkte” të paraqitur në Aneks.

-Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 159,417,031 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në Formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues “Gjendja e inventarit qarkullues” në mbyllje të bilancit të vitit 2022 është 10,435,354 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2023 është 8,289,595 lekë. Në mënyrë analitike gjendjet e llogarive paraqiten si më poshtë:

- “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,435,354 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet 8,289,595 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale”. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -2,145,759 lekë e cila rakordon me gjendje e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive, si vijon:

Tabelë nr.1. Lëvizjet e llogarisë 31 “Materiale”, për vitin 2023. Në lekë

Lëvizje e llogarisë	Vlerë
Çelje në 01.01.2023	10,435,354
Shtesa (K)	13,841,068
Pakësime (D)	15,986,827
Gjendja në 31.12.2023	8,289,595

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës pasqyrat financiare të vitit 2023

3. Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 25,979,593 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 43,247,302 lekë ku kemi pakësim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i uljes së detyrimeve të debitorëve të ndryshëm.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 3,528,693 lekë.

Nga analizimi e kësaj llogarie rezultoi se, nga Drejtoria e Financës nuk u paraqit analizë se kujt i përkasin detyrimet dhe mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël e ligjor për heqjen e detyrimit të vitit 2022 në vlerën 3,528,693 lekë. Ndërkohë që detyrimet e paraqitura në pasqyrën nr.5 Shënime shpjeguese për periudhën raportuese të bilancit, në gjendjen e llog. 411 “Të drejta për tu arkëtuar” janë në shumën 148,426,101 lekë (66,221,214 lekë vlerë e parketuar nga kontratat e qirasë nga subjekte, Hec-e, kullotat, biletat, verifikuar në terren gjatë vitit 2023 dhe nga paraqitja e detyrimeve nga AdZM Tiranë në shumën 82,204,887 lekë). Ndërsa nga auditimi, rezultoi se vlera e detyrimeve të papaguara nga kontratat e qirasë deri në 30.09.2024 është në vlerë të konsiderueshme, në total në vlerën 397,013,980 lekë dhe e pa kontabilizuar (sipas Aneksit nr.3). Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32, Aneksi 1- 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”; Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, pika 5 dhe 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4).

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (Të drejta),** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 25,979,593 lekë. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-404 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 441,610 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 17,346,488 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,775,838 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 5,557,217 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 782,638 lekë dhe vlerën pjesore prej 75,802 lekë të llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" të planifikuar për likuidim në vitin 2024. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundër parti në pasiv të bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

II. Aktivet Afatgjata.

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

1.Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
 - U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale;
 - U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
 - U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
 - U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
 - U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.
3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:
- a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Për aktivet e blera janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
 - Për aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.
- b. Për inventarin, janë kryer teste për t’u siguruar që subjekti:
- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
 - Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 933,141,743 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 980,815,306 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,185,529,161 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,133,756,423 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 93,782,575 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 60,394,550 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 114,351,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 70,403,000 lekë, që përbëhet nga: -Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë neto 90,636,075 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 56,573,800 lekë. Gjatë vitit ka pasur shtesa në vlerën 43,948,475 lekë (Kosto historike), të cilat në total i përkasin 5 projekteve, investimi i të cilave është në proces dhe janë pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”.

Tabelë nr. 3 Llog 202 “Studim dhe kërkime” në vlerë neto në 31.12.2023 Në lekë

Nr	Emërtimi	Periudha e përfundimit të Projektit	Fatura Nr. ,datë	Vlera
	Projekt preventivat për objektet:			
1	Çelja	2022		46,687,600
2	Hartim projekti për Rikonst. Zyrat e AdZM Vlorë	2026	Nr.1, dt 13.01.2023	455,555
3	Hartim projekti zbatim Shtigjet në ZM	2026	Nr.39, dt 22.12.2023	15,720,000
4	Studim në Ekosistemin e lagunave	2023	Nr.89, dt 26.12.2023	16,579,920
5	Hartim projekt ide Qendra multifunksional luginën e Vjosës	2027	Nr.5435, dt 9.12.2023;Nr231213 dt 13.12.2023; Nr.09 dt	11,193,000

		6.12.2023; Nr.5439, dt 22.12.2023	
Totali			90,636,075

Burimi: të dhëna nga Drejtori Financës AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH

Nga analiza e kësaj llogarie, rezulton se:

a) Vlera neto 90,636,675 lekë i përket 5 projekteve për investimet, për objekte të cilat janë në proces.

b) Amortizimi vjetor i llogaritur në kosto historike për vitin 2023 dhe pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”.

-Gjendja e llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme ” në aktiv (vlerë neto) në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë neto 3,146,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë neto 3,820,750 lekë, për të cilat nuk ka analizim nga se përbëhet dhe janë pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”(Kosto Historike). Kjo llogari është pakësuar për vlerën e amortizimit e cila është llogaritur mbi kosto historike dhe pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”(Vlera Neto).

Nën rubrika Aktivet Afatgjata materiale (AAM).

Formati nr.1 **Aktivët Afatgjata**. Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën neto 839,359,168 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 920,420,756 lekë ku rezulton me ulje prej 81,061,588 lekë, si rezultat i ndikimit të vlerës së amortizimit të AAGJ materiale. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,071,177,686 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,063,353,423 lekë. Në mënyrë analitike, në vlerë neto, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.4 : “AAM” Vlerë Neto Klasa 2 Në Lekë

ref e llogarisë	Emërtimi	Viti 2022	Vti 2023	Diferenca (23-22)
	2.Aktive Afatgjata materiale	920,420,756	839,359,168	-81,061,588
211	Pyje, plantacione	262,681,662	240,183,895	-22,497,767
212	Ndërtesa e Konstruksione	423,997,048	403,337,196	-20,659,852
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	36,563,640	32,907,276	-3,656,364
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	47,274,422	30,334,824	-16,939,598
215	Mjete Transporti	148,588,983	114,628,867	-33,960,116
218	Inventar ekonomik	530,420	16,614,991	16,084,571
28	Caktime(rimbursim t.v.sh JICA)	784581	1,352,119	567,538

Burimi: Të dhëna nga Drejtori Financës AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Gjendja e Llogarisë 211 “Pyje, plantacione” (me vlerë neto) në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 262,681,662 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 240,183,895 lekë. Vlera e kësaj llogarie në kosto historike paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 285,531,115 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 289,301,515 lekë.

Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 423,997,048 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 403,337,196 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 458,497,390 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 459,037,390, ku diferenca në rritje është shtesë me pagesë në vlerën prej 540,000 lekë, e cila përfaqëson “Rikonstruksion AdZM Lezhë”.

Tabelë nr.5 Llog 212 “Ndërtesa” sipas AdZM (Lekë)

Gjithsej AdZM	459,037,390
Lezhë	9,103,080
Dibër	17,802,359
Gjirokastrë	18,968,939
Durrës	8,848,238
Shkodër	46,399,615
Fier	42,824,223
Vlorë	40,412,726
Korçë	63,145,293

Elbasan	25,850,670
Berat	4,631,572
Tiranë	162,155,549
Kukës	18,895,126

Burimi: Të dhëna nga Drejtori Financës AKZM,

Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 36,563,640 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 32,907,276 lekë. Kjo llogari është pakësuar për vlerën e amortizimit, i cili është llogaritur me normën 10%, ndërkohë që norma e lejuar e amortizimit është 20%, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018.

-Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 6,531.436 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën 30,334,824 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 65,971,779 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 52,524,346 lekë, diferenca më pak 13,447,433 lekë (17,779,850 lekë nga kalimi i aktiveve nga kjo llogari në llog. 218 ”inventar ek” dhe shtesa 669,480 lekë për 14 copë tableta lenovë, ardhur nga Inspektorati Qendror i MTM-së dhe 3,662,937 lekë pajisje elektronike nga 3 donatorë UNDP, Projekti PONT, projekti Prespës), për të cilat ka inventar fizik.

-Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 148,588,983 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 114,628,867 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 209,273,646 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 201,955,897 lekë. Shtesat në vlerën 8,059,401 lekë (automjet tip Toyota me vlerë 3,899,840 dhe Traktor Shibaura në vlerë 4,159,561 lekë të dhuruara nga projekti Ndërtimi i kapacitetit në AdZM Fier në kuadër të projektit JICA me qeverinë japoneze sipas akt-marrëveshjes datë 8.10.2020 dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim nr.3865 prot., datë 08.11.2023 nga komisioni i marrjes në dorëzim, për të cilat është ndjekur procedurë e plotë për hyrjen e këtij aktivi në AKZM dhe pakësim në vlerën 15,377,150 lekë cila përfaqëson transferimin e automjetit për pastrim kanalizim i cili ka ardhur në kuadër të projektit të Prespës sipas marrëveshjes financiare midis KFW dhe Qeverisë së Shqipërisë për projektin “Rezerva Ndërkombëtare e Biosferës së Prespës” në Maj 2018 destinuar për Ujësjetllës Kanalizime Korçë, kryer me procedurë të rregullt. Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti" me datë 31.12.2023.

Tabela nr.6 llog.215 “Mjete transporti”

Në lekë

Emërtimi mjetit	Sasia	Cmimi	Vlera	Shtesa	Pakësime
Motorr Autonymon uji	1	767,280	767,280		
Furgon Renault	1	3,573,973	3,573,973		
Toyota HILUX	1	2,887,238	2,887,238		
Dacia Duster	1	1,947,696	1,947,696		
Motocikletë Locusta	16	608,260	9,732,165		
Motorra barke	2	588,667	1,177,334		
Bicikleta	50	48,852.6	2,442,630		
Bicikleta Natura	15	48,852.6	732,789		
Land Rover Defender	1	4,406,510	4,406,510		
Motorr Quad Engine	1	489,060	489,060		
Motocikletë 50cc	2	98,800	197,601		
Motocikletë	2	429,821	859,642		
Automjet Ujësjetllës Kanalizime	1	15,377,150	15,377,150		
Gjendja 31.01.2023			209,273,640		
Toyota TiranaLTD				3,899,840	
Traktor Shibaura				4,159,561	
Automjet Ujësjetllës Kanalizime					15,377,150
Gjendja 31.12.2023			201,955,,897	8,059,401	15,377,150

Burimi: Të dhëna nga Drejtori Financës AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” (vlerë neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 530,420 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 16,614,991 lekë. Ndërsa sipas Formatit

nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 530,420 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 24,241,926 lekë. Në këtë gjendje përfshihen shtesa me pagesë në vlerën prej 1,047,184 lekë nga blerjet e vitit dhe 4,884,473 lekë nga hyrjet pa pagesë nga 3 donatorë: UNDP, Projekti PONT, Projekti Prespës për pajisje si tabela informuese, mobilje zyrash dhe shtesa për 17,779,850 lekë nga kalimi i aktiveve nga llog.214 në llog 218, për shkak të ri klasifikimit të tyre sipas planit kontabël.

- Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 252,387,418 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Nën rubrika Llogari të pagueshme.

Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 42,232,012 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 62,906,275 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” janë raportuar detyrime për fatura shërbimesh, mallrash dhe investimesh të papaguara deri në fund të vitit financiar 2023 në shumën 441,610 lekë si më poshtë:

-Pagesa për këshilltarë(dhjetor 2023)	280,500 lekë
-Pagesë për ASHK Korçë (tarifë info pasurie)	17,000 lekë
-Faturë uji dhjetor 2023	2,340 lekë
-Faturë internet	95,000 lekë
-Pagesë Tatim burim	49,500 lekë
-Sistemim (ujë Vlorë, memo kredi)	(2,730) lekë

Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 17,346,488 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 1,775,838 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas liste pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 5,557,217 lekë, të llogaritura për t’u paguar në muajin pasardhës.

- Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 782,638 lekë, të llogaritura për t’u paguar në muajin pasardhës.

-Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,550,321 lekë, e cila nuk kuadron me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit, paraqitur me 0 lekë, duke qenë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 Aneksi I, Kap 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, Llogaritë e Marrëdhënive me shtetin.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 3,002,118 lekë, vlerë e cila kuadron me raportin e analizës së kësaj llogarie nga Dega e Thesarit (teprica në fillim të vitit është 14,552,439 lekë, pagesa janë 11,626,123 lekë dhe të hyrat për 75,802 lekë).

-Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 1,775,782 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 1,185.229 lekë me një diferencë në zbritje prej 590,553 lekë në krahasim me vitin 2022.

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar) deficiti i akumuluar”, tregon lëvizjet e aktiveve afatgjata: shtesa, blerje, nxjerrje jashtë përdorimit, konsumin si dhe ndryshimin e gjendjes (llogaria 603). Kjo llogari është e pasqyruar në pasqyrën e Pozicionit Financiar (si edhe në Formatin 4 Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me Kosto Historike dhe Vlerë neto.

Nga analiza e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar”, rezultoi se në mbyllje të vitit 2023 është 1,084,595,950 lekë. Në Formatin nr. 4 (Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto), teprica në çelje e fondeve neto është pasqyruar gabimisht duke iu referuar mbylljes së vitit 2021, me një shumë prej 306,793,959 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 805,735,096 lekë, sipas mbylljes së vitit 2022. Ky gabim ka bërë që ndryshimet e fondeve neto gjatë vitit 2023 të mos pasqyrohen saktë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, Kap.3,2 pika 44 “Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm.”, Kap. 3.6 Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, pika 82 “Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare evidentohen: Në rubrikën I, evidentohen shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga I deri në 5”.

Pasqyra e Performancës Financiare (F2)

Pasqyra e Performancës Financiare përfshin të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës kontabël.

Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në PF për vitin ushtrimor 2023 dhe vitin paraardhës, sipas zërave më poshtë:

A. Analiza e llogarive të të ardhurave në bilancin 2023 në total 539,696,393 lekë si dhe referuar akt rakordimit me Degën e Thesarin Tiranë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 169,197,146 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Degën e Thesarit në këtë zë të ardhurash.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 127,856,297 lekë, e cila përfshin të ardhurat e trashëguara nga viti mëparshëm nga qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 41,265,047 lekë, e cila përfshin të ardhurat nga qiratë nga viti ushtrimor, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë 719 “Të ardhura të tjera jo tatimore” në vlerën 75,802 lekë përfshin të ardhur nga garancitë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë 7200 “Të ardhurat nga Buxheti për NJQP (Qendrore)” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 370,499,247 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit, dhe përfaqëson grandin e akorduar nga MTM për AKZM.

- Gjendja e llogarisë 7200 “Të ardhura nga buxheti për NJQP (Qendrore)” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 344,595,456 lekë, e cila përfaqëson të ardhurat nga fondet e akorduara, kjo sipas akt-rakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është në vlerën prej 25,903,791 lekë, vlerë e cila nuk rakordon për vlerën 75,802 lekë me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit, e cila paraqitet në vlerën 25,979,593 lekë. Kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, veprime që janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”.

B. Analiza e shpenzimeve të bilancit në vitin 2023 në vlerën 541,842,152 lekë:

- Gjendja e llogarisë 600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’ për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 236,712,593 lekë dhe sipas akt akordimit me thesarin.
 - Gjendja e llogarisë 601 ‘Kontribute për sigurime’ për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 39,906,018 lekë dhe sipas akt akordimit me thesarin.
 - Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 73,908,401 lekë dhe sipas akt akordimit me thesarin.
 - Gjendja e llogarisë 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 277,634 lekë dhe sipas akt akordimit me thesarin.
 - Shpenzime të tjera në vlerën 188,891,747 lekë, e cila nuk analizohet se çfarë përfaqëson.
- Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 539,696,393 lekë dhe totali shpenzimeve është 537,550,634 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 2,145,759 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.
- Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është e barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën 2,145,759 lekë.
- Zëri "Burimet për investime" Format 6, i plotësuar për shumën 239,424,092 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 43,948,475 lekë fonde të akorduara për investime AAGJ jo materiale dhe vlera 195,475,617 lekë për investime AAGJ materiale.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiv, situacion, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Nga verifikimi i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin.

Veprimet nëpërmjet magazinës.

- Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se:
- Fletë hyrjet shoqërohen me faturën e shitësit, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, konfirmuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, urdhrin e drejtorit të përgjithshëm.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim, por nuk ka plan-shpërndarje të miratuara nga drejtori përkatësisht.
- Është mbajtur libri i magazinës, në formë kartele për çdo artikull në sasi dhe vlerë, ku evidentohen të gjitha lëvizjet dhe gjendja e tyre, dhe në fund të vitit hartohet përmbledhëse që dërgohet në zyrën e financës.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se: Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për AKZM dhe njësitë administrative.

-Për vitin 2023 Titullari ka nxjerrë urdhrin me nr. 391 datë 20.11.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e inventarit fizik dhe kontabël të AKZM” i përbërë nga komisioni z. K. U, znj. A. N, z. G, C. Afati i përfundimit është 31.12.2023.

Me shkresë nr.4422 prot., datë 29.12.2023 nga komisioni i inventarizimit është bërë fiksimi i numrit rendor fletë hyrje e fletë dalje.

-Me shkresë nr.4422/1 prot., datë 29.12.2023 nga komisioni i inventarizimit, në prani të magazinierit znj.Y. P është mbajtur raporti përfundimtar mbi inventarizimin edhe vlerësimin e vlerave materiale dhe monetare në AKZM për vitin 2023, sipas së cilit gjendja e magazinës në 31.12.2023 është 8,289,595 lekë, dhe shprehet se nuk ka diferenca.

- Memo nr.4422/2 prot., datë 29.12.2023 nga komisioni i inventarizimit dhe drejtore e financës. drejtuar drejtorit të përgjithshëm mbi përfundimin e procesit të inventarizimit, sipas të cilit:

aktive të llog 211 “Pyje” gjithsej në vlerë 289,301,515 lekë

aktive të llog 212 “Ndërtesa ” gjithsej në vlerë 459,037,390 lekë

aktive të llog 214 “Instalime makineri pajisje” gjithsej në vlerë 52,524,344 lekë

aktive të llog 218 “Inventar ekonomik” gjithsej në vlerë 23,472,729 lekë (24,241,926 lekë në bilanc)

aktive të llog 215 “Mjete transporti ” gjithsej në vlerë 201,955,897

aktive të llog 327 “Inventar Imët” gjithsej në 6,482,256 lekë (8,289,595 lekë në bilanc).

* Nga auditimi i procedurës së inventarizimit për vitin 2023 rezultoi se, kjo procedurë është formale dhe e paplotë, pasi në fletët e inventarit mungon krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike të aktiveve. Për këtë arsye edhe raporti i komisionit të inventarizimit, i dalë mbi bazën e këtij inventari, i cili shpreh se nuk ka diferenca, nuk është real. Këtë pasaktësi e tregon mos rakordimi i gjendjes së llog. 218 “Inventar ekonomik” i cili në raportin e inventarizimit paraqitet më pak për 769,197 lekë krahasuar me bilancin dhe e llog. 327 “Inventar i imët” i cili paraqitet më pak për 1,807,339 lekë krahasuar me bilancin, veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël por llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

*Njësia nuk dispononte një regjistër analitik të aktiveve sipas formatit të kërkuar, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale që rrisin vlerën e aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe datën e daljes nga pronësia, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III Regjistri i aktiveve, pika 30 “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Mbi zbatimin i strukturës organizative.

Bazuar në Aneksin 1 të Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave të Zonave të Mbrojtura”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 51, datë 6.2.2024; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, Kreu V, pikës 3, marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKZM-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, përmes rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Sa i përket marrëdhënieve të punës së punonjësve të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, ato rregullohen sipas Kodit të Punës. Referuar pikës 3, Kreu V, të VKM-së nr. 102, datë 04.02.2015, “Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm”. Procedura e rekrutimit është e përcaktuar në Aneksin 1 të Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave të Zonave të Mbrojtura”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 51, datë 6.2.2024. Struktura e realizuar paraqitet si vijon:

Për vitin 2023 numri i punonjësve në fakt sipas strukturës është 284 punonjës, ose në krahasim me numrin e planifikuar (308) paraqitet me realizim në masën 92%. Gjatë vitit kanë ardhur gjithsej 41 punonjës (9 punonjës më status nëpunësi civil dhe 32 punonjës me kod pune) dhe janë larguar 36 prej tyre (5 punonjës më status dhe 31 punonjës me kod pune).

-Nga 36 punonjës të larguar: 2 punonjës transferohen; 2 punonjës përfundon periudha e transferimit. 27 punonjës me dorëheqje, 2 në pension, 3 punonjës lirim nga detyra, për të cilët nuk konfirmohet të ketë çështje gjyqësore.

- Numri i vendeve të lira të punës gjithsej 24, nga të cilët në AKZM: 1 drejtor i përgjithshëm; dhe 5 specialistë dhe në AdZM 1 drejtor rajonal; 2 përgjegjës sektori; 5 specialistë dhe 10 roje mjedisore.

Për periudhën deri në 30 shtator 2024 numri i punonjësve në fakt sipas strukturës është 283 punonjës, ose në krahasim me numrin e planifikuar (308) paraqitet me realizim në masën 92%. Gjatë kësaj periudhe kanë ardhur gjithsej 32 punonjës (3 punonjës më status nëpunësi civil dhe 29 punonjës me kod pune) dhe janë larguar 22 prej tyre (1 punonjës më status dhe 21 punonjës me kod pune),

-Nga 22 punonjës të larguar: 1 punonjës ndërron jetë; 2 punonjës largim me masë disiplinore. 12 punonjës me dorëheqje; 8 në pension, për të cilët nuk konfirmohet të ketë çështje gjyqësore.

- Numri i vendeve të lira të punës gjithsej 25, nga të cilët në AKZM: 1 drejtor i përgjithshëm; 1 koordinator anti korrupsion; 1 drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit dhe 2 specialistë dhe në AdZM 1 drejtor rajonal; 2 përgjegjës sektori; 6 specialistë dhe 11 roje mjedisore.

Gjithashtu pozicioni i drejtorit të përgjithshëm të AKZM-së prej datës 16.05.2022 e në vazhdim, është vakant, pozicion i cili mbahet nga znj. D. P me shkresë Nr.4299/3 prot., datë 16.05.2022 të Ministrit të MTM-së, sipas së cilës: Ngarkimin e znj. D. P për ushtrimin e detyrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, krahas ushtrimit të detyrës aktuale të Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

* Struktura e punonjësve krahasuar me planifikimin, paraqitet me një realizim në masën 92%. Rreth 1/3 e largimeve janë dorëheqje, dhe shumica e vendeve të lira janë në pozita menaxheriale dhe specialistë në AKZM dhe AdZM. Nuk konfirmohet të ketë ndonjë çështje gjyqësore që lidhet me largimet e punonjësve.

-Vendet e lira të punës (viti 2023 me 24 pozicione dhe viti 2024 me 25 pozicione) janë të pranishme në nivele menaxheriale, specialistësh, dhe rojesh mjedisore, duke pasur nevojë kryesisht për plotësimin e pozicionit të rëndësishëm si Drejtor i Përgjithshëm dhe pozicione të tjera të larta në AKZM dhe AdZM.

Vendet e lira të punës si dhe largimet e shumta në numër të punonjësve tregojnë mangësi në procesin e planifikimit të numrit të punonjësve dhe realizimin e strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve për këto pozicione pune. Kjo mungesë stafi sjell ulje të efektivitetit dhe efikasitetit në punë për njësinë.

2.2 Mbi auditimin e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave:

AKZM siguron të ardhura për veprimtaritë e lejuara që kryhen brenda zonave të mbrojtura mjedisore, për të cilat paguhet një tarifë vjetore si dhe të ardhura të tjera, sipas përcaktimit në

nenin 58 të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i azhurnuar me Ligjin nr.21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Rregullat dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen sipas Udhëzimit nr. 1, datë 10.02.2021 “Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to”; Vendimit nr.1156, datë 24/12/2020 “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifave që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kriterëve të përdorimit të tyre”, sipas të cilit aplikimi i tarifave të reja hyn në fuqi në 1 shtator 2021. Për kontratat e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi është bërë amendimi i tyre, duke përditësuar vlerat e qirasë me tarifave të reja.

Sipas pikës 10 të këtij Vendimi: “Të ardhurat e gjeneruara nga tarifave, sipas këtij vendimi, kanalizohen nëpërmjet llogarisë së thesarit (kodi institucionit 1026087 dhe në llog. 7113099) dhe përdoren nga AKZM si të ardhura jashtë limitit mbi bazë të legjislacionit në fuqi”.

Me shkresë nr.1008/3 datë 06.06.2023, në Udhëzimin plotësues Nr.2/1, datë 06.06.2023 “Një shtesë në Udhëzimin plotësues Nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, është bërë ndryshimi në pikën 90 duke shtuar gërma “y”, hequr gërma “l” e pikës 91 ku: “Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në Udhëzimin e “Procedurave standarde të zbatimit të buxhetit”, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme: ”Të ardhura të gjeneruara nga tarifave që paguhen në zonat e mbrojtura në zbatim të VKM-së nr. 1156, datë 24.12.2020”.

Bazuar në pikën 4 të Vendimit nr.1156/2020, çdo vit AKZM harton planin e të ardhurave të siguruara nga tarifave për aktivitetet e përcaktuara në Lidhjen nr.1 të tij dhe planin e përdorimit të tyre. Referuar këtij Vendimi të ardhurat përdoren:

a) 60% për: Investime në zona të mbrojtura; hartimin e planeve të menaxhimit; projektet e pyllëzimit; masat për parandalimin e mbrojtjes nga zjarri; ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura, publikimin e informimin publikut;

b) 40% për: masat për parandalimin e luftimit e erozionit; luftimit e sëmundjeve e të dëmtuesve; mbarështimin, ushqimin e kushteve të jetesës së faunën e egër; blerjen e mjeteve të komunikimit e transportit, për mobilimin e përmirësimin e kushteve të punës së administratës rajonale dhe punës në terren; përbalimin e shpenzimeve për punësime sezonale për aktivitet Brenda ZM; mbështetjen e aktiviteteve tradicionale të komuniteteve lokale.

Rregullat dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave të realizuara nga aplikimi i tarifave të shërbimit në zonë të mbrojtur dhe kryerjes së shpenzimeve, janë përcaktuar në Rregulloren “Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit nga të ardhurat e gjeneruara në zonat e mbrojtura”, miratuar me Urdhër nr.106, datë 20.06.2022, me nr.1089/1 prot., datë 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së. Burimet e financimit krijohen nga:

a) Të ardhurat nga tarifave që paguhen në zonat e mbrojtura në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) Vlerat monetare të zhdëmtimeve që paguajnë dëmtuesit e zonës.

Të ardhurat e gjeneruara në zonat e mbrojtura mjedisore planifikohen dhe përdoren të detajuara në nivel zone të mbrojtur, AdZM-je dhe AKZM-je. Projektet e financuara që i shërbejnë më shumë se një zone të mbrojtur, planifikohen dhe raportohen në nivel AdZM-je. Plani financiar i përdorimit të tyre ndahet dhe përdoret në dy kapituj siç është parashikuar në VKM nr.1156, datë 24.12.2020, pika 4 shkronjat (a) dhe (b). Projektet e financuara brenda kapitujve detajohen në nivel projekti dhe grupohen sipas natyrës së shpenzimit (operacionale, kapitale aktive afatgjata materiale dhe jo materiale), në nivel projekti, klasifikuar sipas natyrës së projekteve të lejuara në VKM nr.1156, datë 24.12.2020. Në planifikimin e shpenzimeve nga të ardhurat e gjeneruara nga tarifave në ZM prioritare janë shpenzimet/projektet në proces nga viti i mëparshëm dhe pas tyre ato të reja. Jo më vonë se data 5 dhjetor, Drejtori i Përgjithshëm miraton listën paraprake të propozimeve nga grupi i punës dhe nivelet tavan të financimit të projekteve, duke firmosur në procesverbalin e grupit të punës. Plani përfundimtar i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i

dërgohet për dijeni Ministrit përgjegjës për Mjedisin dhe gjithë AdZM-ve, jo më vonë se data 30 dhjetor e vitit. Mjetet financiare të gjeneruara përdoren për:

- Financimin e shpenzimeve/projekteve të parashikuara në Vendimin nr.1156, datë 24/12/2020 “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifatat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kriteret e të përdorimit të tyre” dhe ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.
- Financimin e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura, sipas parashikimit në nenin 59 të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” ku: 1. Në llogari të AKZM-së krijohet Fondi i Veçantë për Zonat e Mbrojtura me fondet e siguruar nga të ardhurat dhe nga kontributi i donatorëve, i cili përdoret me miratim të ministrit për përbashkëtimin e emergjencave, për rehabilitimin e pasojave të zjarreve apo të përmbytjeve, të fatkeqësive natyrore, të infeksioneve në bimë a në kafshët e egra për zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike në zonat e mbrojtura për ndërhyrjet e detyrueshme ndaj llojeve të huaja. 2. Me propozim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave miraton vendimin për masën e Fondit të Veçantë për Zonat e Mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij; Vendimin nr.19, datë 20.01.2021, të Këshillit të Ministrave “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”, pika 2 Fondi për zonat e mbrojtura mjedisore (në vijim FVZM) krijohet nga ministria përgjegjëse për financat në bashkëpunim me AKZM-në, në masën 15% nga fondet e krijuara nga të ardhurat, dhe në masën 85%, nga kontributet e donatorëve dhe projektet me mbështetje të institucioneve ndërkombëtare; pika 5 “Fondi i veçantë për zonat e mbrojtura përdoret për rastet e parashikuara në pikën 1, të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” mbështetur në manualin e përdorimit më të detajuar të këtij fondi, të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, me propozim të AKZM-së..”; Ndërsa të ardhurat që krijohen nga gjodat nga inspektimet arkëtohen në llogarinë specifike të dedikuara të MTM-së (llog.7115600).

Viti 2021: Sipas Akt rakordimit nr.70 prot., datë 20.01.2022 midis AKZM dhe Degës së Thesarit Tiranë, të ardhurat e mbartura nga viti 2020 janë 139,000,000 lekë, ndërsa të realizuara gjatë vitit 2021 janë 23,648,660 lekë. Të ardhurat progresive në mbyllje të vitit 2021 janë 162,648,660 lekë, të cilat nuk janë përdorur.

-Nuk rezultojnë të ketë një plan të ardhurash e shpenzimesh, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AKZM-së, i cili i jepet për zbatim çdo drejtorie rajonale.

Viti 2022: Sipas Akt rakordimit nr. 651 prot., datë 20.02.2023 midis AKZM dhe Degës së Thesarit Tiranë, të ardhurat e mbartura nga viti 2021 janë në shumën 162,648,660 lekë, ndërsa të realizuara gjatë vitit 2022 janë në shumën 29,366,636 lekë, në total 192,015,296 lekë, nga të cilat janë përdorur gjatë vitit 64,158,999 lekë.

Nga të ardhurat e gjeneruara nga aplikimi i tarifave të shërbimit në zonë të mbrojtur 15% shkon për krijimin e fondit të veçantë dhe 85% për përdorim nga institucioni, sipas përcaktimit në Vendimin nr.19, datë 20.1.2021, pika 2 “Fondi i veçantë për zonat e mbrojtura krijohet nga ministria përgjegjëse për financat në bashkëpunim me AKZM-në në masën 15% nga fondet e krijuara nga të ardhurat”. Në 6/mujorin e dytë të vitit 2022 hyri në zbatim rregullorja e re, për mbartjen e të ardhurave të papërdorura nga periudha e mëparshme. Gjithashtu filloi dhe përdorimi i biletarisë elektronike në “Syrin e Kaltër”. Të detajuara paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë nr. 1 Mbi të ardhurat e shpenzimet nga aplikimi i tarifave të shërbimit në ZMM, (Kapitulli 6), viti 2022. Në lekë

Të Ardhurat I-II	Plan	Fakt					TOTAL	15% Fondi Rezerve	85% Te Ardh. Institucioni	% realizimit
		602	600	230	231					
	x	43,543,684	1,532,000	-	146,939,613	192,015,297	28,802,295	163,213,002		
I.Të Ardhura të trashëguara nga viti 2021		43,543,684	1,532,000	-	117,572,977	162,648,661	24,397,299	138,251,362		
II.Të Ardhura të realizuara deri në 31 Dhjetor 2022						29,366,636	4,404,995	24,961,641		
Shpenzime deri në 31 Dhjetor 2022	x	6,112,885	35,408	-	58,010,706	64,158,999			39%	
1- Hartim ToR Pl. Menaxh "PK Bredhi i Hotoves -Dangelli"		450,590	-	-	-	450,590				
2- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Syr i Kaltër"		450,580	-	-	-	450,580				
3- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Mali me Gropa-Bize"		450,585	-	-	-	450,585				
4- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Kune Vain Patok"		450,555	-	-	-	450,555				
5- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Liqeni I shkodes"		450,565	-	-	-	450,565				
6- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Lagina e Shales"		450,570	-	-	-	450,570				
7- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku kombetar Llogara"		450,575	-	-	-	450,575				

8- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Porto Palermo"		450,560	-	-	-	450,560		
9- Hartim ToR Pl. Menaxh "Parku Natyror Alpet e Shqipërisë"		450,595	-	-	-	450,595		
10- Hartim ToR per projekt "Shtigjet ne rrjetin e Z.M"		518,399	-	-	-	518,399		
11- Sherbim i ruajtjes Fizike Dhjetor 2022		999,311	-	-	-	999,311		
12- Hartim ToR per projekt "Shtigjet ne rrjetin e Z.M"		540,000	-	-	-	540,000		
13- Paguese e punonjessve me kontrate		-	35,408	-	-	35,408		
14- Vlera e Investimeve sipas Rakordim Thesarit Dhjetor 2022		-	-	-	58,010,706	58,010,706		
Gjendje të ardhura në 31 Dhjetor 2022		37,430,799	1,496,592	-	88,928,907	127,856,298	28,802,295	
Të ardhura te papërdorura në 31 Dhjetor 2022 (163,213,002 - 64,158,999)								99,054,003

Burimi: Të dhëna nga DFSHM në AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi planifikimin dhe shpenzimet nga të ardhurat, në vitin 2022 rezultoi:

-Nuk ka një planifikim të të ardhurave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre. Duke qenë se rregullorja është miratuar në pjesën e dytë të vitit 2022, nuk ka pasur detajim në nivel projektsh për financim që në fillim të vitit dhe projektet e financuara nga të ardhurat e trashëguara dhe të gjeneruara gjatë vitit janë miratuar në nivel projekti, sipas nevojave të identifikuar nga AKZM-ja, dhe angazhimeve të ndërmarra për financim në vitet e mëparshme (si p.sh. vlera e investimeve në infrastrukturë për rreth 58 milionë lekë).

-Të ardhurat e realizuar gjatë vitit 2022 janë 29,366,636 lekë, ose krahasuar me vitin e mëparshëm janë rritur me 5,707,976 lekë, ose në masën 19%.

-Të ardhurat progresive që i përkasin institucionit (85%) me të drejtën për t'u përdorur janë në shumën 163,213,002 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 64,158,999 lekë ose në masën 39% të këtyre të ardhurave, që u përkasin projekte/investime (90% të totalit të shpenzimeve) dhe 13 projekte/shpenzime (10% të totalit të shpenzimeve). Në mbyllje të vitit 2022 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të mbarten në vitin 2023 janë në shumën 99,054,003 lekë (127,856,295 lekë të ardhura - 28,802,295 lekë fond i veçantë).

-Fondi i veçantë progresiv i krijuar deri në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 28,802,295 lekë ose në masën 15 % të të ardhurave gjithsej progresive, i cili nuk është përdorur.

-Për trashëgimin dhe përdorimin e tyre, për çdo rast, janë bërë kërkesa, për rritje të autorizuar mujore dhe progresive në degën e thesarit.

Viti 2023: Sipas Akt rakordimit nr.2077 prot., datë 09.06.2023 me Degën e Thesarit Tiranë, të ardhurat e mbartura nga viti 2022 janë në shumën 127,856,297 lekë, ndërsa të ardhura të realizuara gjatë vitit janë 41,265,047 lekë, në total në shumën 169,121,344 lekë, nga të cilat janë përdorur 11,404,293 lekë ose në masën 85% të totalit të të ardhurave të lejuara për përdorim.

Tabelë nr.2 Mbi të ardhurat e shpenzimet nga aplikimi tarifave në ZMM (Kapitulli 6), viti 2023. Në lekë

Të Ardhurat I+II	Plan	Fakt					15% Fondi Rezerve	85% Te Ardh. Institucioni	% realizi mit
		602	600	230	231	TOTAL			
x		57,761,045	1,496,592	455,555	109,408,152	169,121,344	34,992,052	134,129,293	
I.Të Ardhura të trashëguara nga viti 2022		37,430,799	1,496,592		88,928,907	127,856,297	28,802,295	99,054,003	
II.Të Ardhura të realizuara deri në 31 Dhjetor 2023 nga keto:						41,265,047	6,189,757	35,075,290	
II.1 Të ardhura nga kontrata e qirasë						23,501,836			
II.2 Të ardhura nga biletat						12,570,700			
II.3 Te ardhura nga kullotat						4,812,011			
Derdhur gabimisht individit						75,802			
Shpenzime deri në 31 Dhjetor 2023	x	4,361,586	-	455,555	6,587,152	11,404,293			8.50%
1- Blerje Fidanë viti 2022 (detyrim i prapambetur)		-	-	-	2,579,568	2,579,568			
2- Blerje Fidanë viti 2023		-	-	-	2,420,400	2,420,400			
3- Bilete Avioni per z. P. I.		58,300	-	-	-	58,300			
4- Dieta për Udhëtim Jashtë vendit për z. P. I.		37,686	-	-	-	37,686			
5- Shpenzime Fjetje udhëtim jashtë vendit për z. P. I.		42,500	-	-	-	42,500			
6- Hartimi i projektit te zbatimit për Rikonstruksionin e Zyrrave te ADZM Durrës		-	-	-	540,000	540,000			
7- Hartim ToR per projekt zbatimin Liqeni i Kallabllakut ne PN Korab - Koritnik		558,300	-	-	-	558,300			
8- Hartim ToR per projekt zbatimin Per ndertimin e nje segmenti nga cezma e Tarikos -Ujvara e Sotires		554,760	-	-	-	554,760			
9- Hartim ToR per projekt zbatimin Destinacion Turistik Stebleve dhe liqeni I fushe-Studen ne parkun Kombetar Shebenik		550,800	-	-	-	550,800			
10- Hartim ToR per projekt zbatim Monument Natyre Syri Kalter, Pragu I Kaprese Vaskat e lumit te kaprese		540,600	-	-	-	540,600			

11- Hartim ToR per projektin Monument Natyror: Ujrat Termale te Benjes, Shpelles se Pellumbave dhe Kanioni i Langarices	545,040	-	-	-	545,040		
12- Hartim ToR per projektin "Qendra multifunkionale ne Luginen e Vjoses"	582,000	-	-	-	582,000		
13- Rafte Metalik per Arkiv	-	-	-	112,380	112,380		
14- Hartim projekti per rikonstruk Zyrrat AdZM Vlore	-	-	455,555	-	455,555		
15- Sherbim Konsulence " Vleresim I rendesise ne ekosistem te lagunave"	546,000	-	-	-	546,000		
16- Blerje Orendi dhe Pajisje per Mobilim	-	-	-	934,804	934,804		
17- Dizenjim dhe mirembajtje per 12 Muaj EEB (Janar-Dhjetor)	345,600	-	-	-	345,600		
Gjendje të ardhura në 31 Dhjetor 2023	53,399,459	1,496,592	-	102,821,000	157,717,051	34,992,052	
Të ardhura të papërdorura në 31 Dhjetor 2023 (134,129,293 - 11,404,344)							122,725,000

Burimi: Të dhëna nga DFSHM AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi planifikimin, realizimin dhe shpenzimet nga të ardhurat, në vitin 2023 rezultoi se:

-Me Urdhër nr.106/1 prot., datë 22.06.2022 “Ngritje e grupit të punës për vlerësimin e propozimeve dhe hartimin e planit të të ardhurave të gjeneruara nga tarifrat që paguhen në zm dhe planin financiar të përdorimit të të ardhurave të siguruara nga tarifrat që do të financohen dhe zbatohen për vitin 2023 nga AKZM”, në zbatim të nenit 9 të rregullores mbi të ardhurat, i përbërë nga: Kryetar znj. A. P, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit, Monitorimit dhe Projekteve; anëtarë znj. J. S, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve në Drejtorinë e Menaxhimit, Monitorimit dhe Projekteve dhe znj. E. G, me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Nuk është hartuar një plan përfundimtar mbi të ardhurat.

-Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2023 janë 41,265,047 lekë, ose krahasuar me vitin e mëparshëm janë rritur me 11,898,421 lekë, ose në masën 29%. Sipas peshës specifike në të ardhurat vjetore: kontratat e qirasë zënë 57%, nga biletat zënë 30% dhe nga kullotat 13% të të ardhurave vjetore.

-Të ardhurat progresive që i përkasin institucionit (85%) me të drejtën për t’u përdorur janë në shumën 134,129,293 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 11,404,293 lekë ose në masën 8.5% të këtyre të ardhurave që u përkasin 5 projekte/investime (58% të totalit të shpenzimeve) dhe 12 projekte/shpenzime (42% të totalit të shpenzimeve). Në mbyllje të vitit 2023 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të mbarten në vitin 2023 janë në shumën 122,725,000 lekë (157,717,051 lekë të ardhura- 34,992,052 lekë fond i veçantë).

-Shpenzimet janë miratuar në nivel projekti, por nga totali i tyre janë shpenzuar për likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga investimet (blerje fidanë) në shumën 2,580 mijë lekë dhe shpenzime për dieta në shumën 138 mijë lekë, në kundërshtim me përcaktimin në pikën 4 të VKM-së nr.1156, datë 24.12.2020.

-Fondi i veçantë progresiv i krijuar deri në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 34,992,052 lekë ose në masën 15 % të të ardhurave gjithsej progresive, i cili nuk është përdorur.

-Për trashëgimin dhe përdorimin e tyre, për çdo rast, janë bërë kërkesa për rritje të autorizuar mujore dhe progresive në degën e thesarit.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave janë:

a) Nga përmirësimi në administrimin e territoreve të dhëna në përdorim në zonë të mbrojtur, rritja e kontratave të reja të qirasë dhe rritja e monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të kushteve të kontratës.

b) Kontroll dhe administrim i kujdesshëm dhe i vazhdueshëm nga biletat e vizitorëve në tre zonat e mbrojtura mjedisore, ku kjo tarifë aplikohet.

c) Rritje e arkëtimeve nga kontratat e qirasë me Hec-et.

d) Tarifrat nga kullotat dhe materiale drusore.

Deri në 30.09.2024. Sipas Akt rakordimit nr. 613 prot., datë 09.02.2024 me Degën e Thesarit Tiranë, të ardhurat e mbartura nga viti 2023 janë në shumën 157,717,051 lekë, ndërsa të realizuara deri në 30.09.2024 janë në shumën 71,950,801 lekë, gjithsej në shumën 229,667,852

lekë, nga të cilat janë përdorur 2,641,263 lekë ose në masën 1,4% të totalit të të ardhurave të lejuara për përdorim. Të detajuara plani dhe realizimi i të ardhurave dhe projekteve të financuara për vitin 2024, paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabelë nr.3 Mbi të ardhurat dhe shpenzimet (Kapitulli 6), deri në 30.09.2024.

Në lekë

Të Ardhurat I+II	Plan vjetor	Fakt deri ne 30 Shtator 2024					15% Fondi Rezerve	85% Te Ardh. Institucioni	% realizimit	
		602	600	230	231	TOTAL				
	89,790,969	84,350,260	1,496,592	-	143,821,000	229,667,852	45,784,672	183,883,180		
I.Të Ardhura të trashëguara nga viti 2023		53,399,459	1,496,592			102,821,000	157,717,051	34,992,052	122,725,000	
II.Të Ardhura të realizuara deri në 30 Shtator 2024							71,950,801	10,792,620	61,158,180	
II.1 Të ardhura nga qiratë e kontratave	63,053.87		-				12,700,595			
II.2 Të ardhura nga biletat	26,500,000		-	-			18,598,000			
II.3 Te ardhura nga kullotat	237,100		-	-			237,100			
II.4 Të ardhura nga HEC- Kontratat							40,415,105			
Gjoha							100,000			
Sistemim Memo Kredi te vitit 2023							450			
Shpenzime deri në 30 Shtator 2024	190,004,682	523,263	-	-	2,118,000	2,641,263	45,784,672		1.4%	
Gjendje të ardhura në 30 Shtator 2024		83,826,997	1,496,592	-	141,703,000	227,026,589		181,241,917		

Burimi: Të dhëna nga DFSHM AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, për periudhën janar-shtator 2024 rezultoi se:

- Sipas PBA 2024-2026 janë parashikuar që për vitin 2024 të ardhura gjithsej nga tarifat e shërbimit të jenë në shumën 89,790,969 lekë, ndërsa shpenzimet gjithsej në shumën 190,004,682 lekë, ku deri në 30.09.2024 janë realizuar 71,950,801 lekë.

-Me Urdhër nr.409 datë 24.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. D. S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit dhe Regjistrimit të ZM; znj. J. S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve në Drejtorinë e Zhvillimit të Projekteve; znj. Y. P, me detyrë specialiste finance e komanduar në detyrë në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Me Urdhër nr.481, datë 28.12.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së është miratuar plani përfundimtar i të ardhurave dhe lista e projekteve të reja dhe atyre në vazhdim për vitin koherent.

-Shkresë nr. 1814/2 prot., datë 20.05.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së dërgohet Ministrit të MTM-së plani të ardhurave dhe lista e projekteve që do financohen në vitin 2024 si dhe masa e krijimit të fondit të veçantë për zonat e mbrojtura.

-Të ardhurat e realizuara janar-shtator 2024 janë 71,950,801 lekë. Sipas peshës specifike në të ardhurat vjetore: kontratat e qirasë zënë 74%, biletat zënë 26% dhe kullotat 0.3% të të ardhurave vjetore. Të ardhurat nga kullotat nuk mbledhen më nga AKZM.

-Të ardhurat progresive që i përkasin institucionit (85%) me të drejtën për t'u përdorur janë në shumën 183,883,180 lekë. Në 30.09.2024 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të vijojë të mbartet në vijim, në muajin tetor janë në shumën 181,241,917 lekë (227,026,589 lekë të ardhura- 45,784,672 lekë fond i veçantë).

-Fondi i veçantë progresiv i krijuar deri në 30.09.2024 është në shumën 45,784,672 lekë ose në masën 15 % të të ardhurave gjithsej progresive, i cili nuk është përdorur.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave janë:

a) Aplikimi i tarifave të reja sipas VKM nr.1156, datë 24.12.2020 që hyn në fuqi në 1shtator 2021;

b) Rishikimi dhe garantimi i zbatimit të tarifave të sakta sipas llojit të veprimtarisë ekonomike së subjekteve, objekt kontrate;

c) Përmirësimi në kohë i faturimit dhe arkëtimi të pagesave;

d)Mbledhja e detyrimeve të prapambetura dhe limitimi i krijimit të të rejave;

e)Monitorimi i kontratave dhe tranzitimi tek kontrata e re tip, e cila përfshin edhe garanci financiare në rast mos përmbushje detyrimesh;

f) Lidhja e kontratave të reja dhe anulimi i atyre që nuk kanë zbatuar kushtet kontraktuale;
g) Limitimi i aktivitetit informal në ZMM dhe formalizimi i disa operatorëve të mëdhenj, siç janë HEC-et e ndërtuara në vitet e mëparshme dhe që operonin papaguar tarifat e zbatueshme ligjore apo dhe pa kontratë me AKZM. Të ardhurat e arkëtuara nga Hec-et deri në shtator 2024 janë në vlerën 40.4 milionë lekë.

Shpenzimet e kryera janë paraqitur sipas planit financiar të përdorimit të tyre, miratuar me urdhër nr.481, datë 28.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së, znj. D.P, konkretisht:

Tabelë nr.4 Mbi Planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve (Kapitulli 6), deri në 30 shtator 2024.

Në lekë

Nr.	Emërtimi i Projektit	Plan v.2024	Realizimi Shtator 2024
1	Studim: Rivlerësimi i listës së monumenteve të natyrës	25,200,000	-
2	Punime zbatimi - Rrjeti i shtigjeve ne ZM Shkoder - Theth, Valbone	15,000,000	-
3	Hartimi i planit të integruar të menaxhimit: 1. "Parku Natyror, Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17"; 2. "Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8";	30,000,000	-
4	Hartim projekti - Kullat e vrojtimit në rrjetin e zonave të mbrojtura: studimi, përmirësimi, mirëmbajtja dhe projektimi i kullave të reja	12,000,000	-
5	Studim/ Rivlerësimi i rrjetit te zonave te mbrojtura	6,000,000	-
6	Bateri dhe karte memorje per kamera kurth	1,200,000	-
7	F.V Mobilim per zyra	1,200,000	1,128,000
8	Sinjalistike-Tabela orientuese ne shtigjet e zonave te mbrojtura	1,200,000	-
9	FV Raftë metalike per arkive	1,200,000	-
10	Sherbim I Ruajtjes Fizike	40,400,000	-
11	Luftimi i semundjeve Procecionaria	16,000,000	-
12	Blerje veshje zjarri dhe pajisje per nderhyrje ne shuarjen e zjarreve	1,200,000	-
13	Sherbime Riparime Elektrike	120,000	-
14	Ndricues elektrike per AdZM Fier	1,200,000	-
15	Riparim dyer/ dritare	120,000	-
16	Blerje kamera kurth	1,200,000	-
17	Blerje pajisje elektronike	1,200,000	990,000
18	Sherbim Lyerje Godine	120,000	-
19	Blerje uniforma	1,200,000	-
20	Mbikqyrje punimesh Theth –Valbone	366,000	-
21	Kolaudim Theth –Valbone	37,710	-
22	Mbikqyrje e punimeve per objektin : Nderhyrje ne shtegun ish Rezervat liqeni Bovilles	636,000	-
23	Kolaudim Zonat e Mbrojtura Boville	64,973	-
24	Projekti i In Nature (Qera Ambienti, garanci, mirembajtje, utilitete)	1,700,000	492,663
25	Projekti i In Nature (Hartim Projekt Zbatimi)	1,200,000	-
26	Projekti i In Nature (Zbatim Projekti, mbikqyrje, kolaudim)	30,000,000	-
27	Organizim Eventi In Nature	120,000	30,600
28	Materiale dhe pajisje per Pikat e Aksesit te Kontrolluar	120,000	-
Totali		190,004,682	2,641,263

Burimi: Të dhëna nga DFSHM AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi planin e shpenzimeve rezultoi se:

-Totali i planifikuar për t'u shpenzuar është 190 milionë lekë ose në masën 100% e të ardhurave të parashikuara.

-Janë planifikuar shpenzime operacionale 12 zëra me 44,1 milionë lekë ose në masën 23% dhe 16 projekte investime për 145,9 milionë lekë ose në masën 76% të totalit të shpenzimeve. Në totalin e planifikuar të shpenzimeve operacionale janë përfshirë shpenzime për ruajtje të sigurisë fizike në shumën 40,4 milionë lekë që zë rreth 21% të totalit të planifikuar të shpenzimeve, në kundërshtim me mënyrën e përdorimit të tyre të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr.1156, datë 24.12.2020.

Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet (kapitulli 6), sipas viteve paraqiten në tabelën më poshtë:


Tabelë nr.5 Mbi të ardhurat progresive, shpenzimet dhe gjendja (Kapitulli 6), viti 2021 deri në 30.09.2024.

Në lekë

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	30.09.2024
Gjithsej të Ardhura I+II	162,648,660	192,015,296	169,121,344	229,667,852
I.Të Ardhura të trashëguara	162,648,660	162,648,660	127,856,297	157,717,051
II.Të Ardhura të realizuara gjatë vitit	-	29,366,636	41,265,047	71,950,801
Shpenzime gjatë vitit	-	64,158,999	11,404,293	2,641,263
Gjendje të ardhura	162,648,660	127,856,297	157,717,051	227,026,588

Burimi: Të dhëna nga DFSHM AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH.

Të paraqitura grafikisht të ardhurat progresive, shpenzimet gjatë viteve dhe Fondi i veçantë, paraqiten si më poshtë:



Të përmbledhura të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën e auditimit paraqiten:

Për vitin 2021, të ardhurat e mbartura nga viti 2020 janë 139,000,000 lekë, ndërsa të realizuara gjatë vitit 2021 janë 23,648,660 lekë. Të ardhurat progresive në mbyllje të vitit 2021 janë 162,648,660 lekë, të cilat nuk janë përdorur.

Për vitin 2022, të ardhurat e mbartura nga viti 2021 janë në shumën 162,648,660 lekë, ndërsa të realizuara gjatë vitit 2022 janë në shumën 29,366,636 lekë, në total 192,015,296 lekë, nga të cilat janë përdorur gjatë vitit 64,158,999 lekë. Në mbyllje të vitit 2022 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të mbarten në vitin 2023 janë në shumën 99,054,003 lekë. Fondi i veçantë (15%) progresiv i krijuar deri në mbyllje të vitit 2022 është në shumën 28,802,295 lekë.

Për vitin 2023, të ardhurat e mbartura nga viti 2022 janë në shumën 127,856,297 lekë, ndërsa të ardhura të realizuara gjatë vitit janë 41,265,047 lekë, total në shumën 169,121,344 lekë, nga të cilat janë përdorur 11,404,293 lekë ose në masën 8.5% të totalit të të ardhurave të lejuara për përdorim. Në mbyllje të vitit 2023 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të mbarten në vitin 2023 janë në shumën 122,725,000 lekë. Fondi i veçantë (15%) progresiv i krijuar deri në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 34,992,052 lekë.

Për periudhën janar 2024 –30.09.2024, të ardhurat e mbartura nga viti 2023 janë në shumën 157,717,051 lekë, ndërsa të realizuara deri në 30.09.2024 janë në shumën 71,950,801 lekë, gjithsej në shumën 229,667,852 lekë, nga të cilat janë përdorur 2,641,263 lekë ose në masën 1,4% të totalit të të ardhurave të lejuara për përdorim. Në 30.09.2024 të ardhura të papërdorura (85%), të cilat do të mbartet, në muajin tetor janë në shumën **181,241,917 lekë**. Fondi i veçantë (15%) progresiv i krijuar deri në 30.09.2024 është në shumën **45,784,672 lekë**.

▪ Nga analiza e periudhës janar 2021 - shtator 2024 rezulton se, të ardhurat kanë një rritje prej 18% në vitin 2022, një ulje prej 12% në vitin 2023, dhe një rritje prej 36% në shtator 2024, krahasuar me vitin e kaluar.

Nuk ka pasur një planifikim të projekteve që në fillim të vitit 2022 dhe 2023, por ato janë miratuar gjatë vitit, sipas nevojave të identifikuar nga AKZM, AdZM dhe angazhimeve financiare të viteve të mëparshme, në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores “Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit nga të ardhurat e gjeneruara në zonat e mbrojtura”.

- Disa shpenzime, si: likuidimi i disa detyrimeve të prapambetura, dieta, shpenzime për sigurinë fizike, rreth 24% në vitin 2023 dhe 21% në vitin 2024, janë bërë në kundërshtim me qëllimet e përcaktuara në pikën 4 të VKM-së nr. 1156 “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kriterëve të përdorimit të tyre”.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm znj. D. P, drejtore Drejtorisë së Financës znj. R. M, magazinieri znj. Y. P.

2.3.Mbi auditimin e procedurave për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura, hartimin e zbatimit të planeve të menaxhimit si dhe monitorimit, inspektimin e kontrollin e veprimtarive të zhvilluara brenda territorit të tyre.

Nga auditimi i procedurave për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura, rezultoi si më poshtë:

Sipas Ligjit nr. 81/2017, i ndryshuar me ligjin nr. 21/2024, përcaktohet se zonat e mbrojtura mjedisore shpallen përmes legjislacionit të veçantë, duke u bazuar në kriteret e Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN). Shpallja e këtyre zonave bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës, dhe përfshin emrin, kategorinë, sipërfaqen, institucionin menaxhues, objektivat e ruajtjes, shkallën e mbrojtjes dhe tipologjinë e aktiviteteve të lejuara dhe të ndaluara. Zonat e mbrojtura mjedisore janë të regjistruara në portalin dhe data bazën Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, pjesë e Skedarit Kombëtar të Mjedisit dhe është i aksesueshëm për publikun. Ato janë pasuri kombëtare dhe aktualisht zënë 611,568,38 ha ose 21.4% të territorit të Shqipërisë (Kategori e III - Monument Natyre, Kategori e VI/1- Park Natyror Rajonal dhe Kategori e V- Park Natyror Rajonal nuk llogariten veçmas, pasi ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura të kategorive të tjera).Të detajuara sipas kategorive, në përputhje me nenin 38 pika “dh” të ligjit nr.81/2017, i ndryshuar, paraqiten si më poshtë:

- Kategori e II, Park Kombëtar janë 12 ZM, me sipërfaqe 313,923.76 ha.
- Kategori e III, Monument Natyre janë 725 ZM, me sipërfaqe 3,470 ha.
- Kategori e IV, RNM/PN janë 23 ZM, me sipërfaqe 216,024.68 ha.
- Kategori e VI/1, Park Natyror Rajonal janë 2 ZM, me sipërfaqe 21,711 ha.
- Kategori e V, Park Natyror Rajonal janë 7 ZM, me sipërfaqe 94,101.3 ha.
- Kategori e VI/1, Peizazh i Mbrojtur janë 10 ZM, me sipërfaqe 81.913,63 ha.

Të detajuara sipas kategorisë, qarqeve dhe VKM-së së shpalljes, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë nr.1 Zonat e mbrojtura sipas Kategorive, të krijuara me VKM-të përkatëse, të detajuara në sipërfaqe, sipas qarqeve.

N r.	AdZM QARKU	EMËRTIMI ZM	VENDIMI PARAPRA K I SHPALLJE S	SHPLLJA / MIRATIMI	PLAN MENX HIMI	Urdhri i miratimit te PMI	Total Sip. (Ha)
01. KATEGORIA II PARK KOMBËTAR							
1	Kukës	Alpet e Shqipërisë	VKM 1966 dhe 1996	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 1		Eshte hartuar draft plani ne 2015, nuk eshte miratuar	82844.65
2	Gjirokastrë	Bredhi i Hotovës - Dangëlli	VKM 1996	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 2	Po	Urdhër nr. 2025, datë 31.12.2014	36003.76
3	Vlorë	Butrint	2005 dhe 2013	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 3		Vendim nr. 95, datë 07.04.2020, të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale	8622.2
4	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM 2007	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 4	Po	Urdhër nr. 782, datë 30.12.2015	22389.08
5	Tiranë, Durrës	Mali i Dajtit	VKM 2006 dhe 2009	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 5	Po	Urdhër nr. 343, datë 23.09.2024	28561.84
6	Lezhë	Lurë - Mali i Dejës	VKM 1996 dhe 2018	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 6			19288.88
7	Vlorë	Llogora	VKM 1996	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 7			1769.2
8	Berat, Elbasan	Mali i Tomorrit	VKM 2012 dhe 2018	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 8	Po	Urdhër nr. 2027, datë 31.12.2014	27158.5
9	Vlorë	Karaburun - Sazan	VKM 2010	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 9	Po	Urdhër nr. 750, datë 24.11.2015	12437.7
10	Elbasan, Dibër	Shebenik	VKM 1996	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 10	Po	Urdhër nr. 134 datë 25.04.2018	34507.9
11	Korçë	Prespa	VKM 1996	VKM nr. 59, datë 26.01.2022 Aneksi 11			27613.05
12	Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Korçë	Lugina e Lumit Vjosë	VKM 2022	VKM nr. 155, datë 13.03.2023	Po	Urdhër nr. 342, datë 23.09.2024	12727
Sipërfaqja II							313,923.76
02. KATEGORIA III MONUMENT NATYRE							
Sipas VKM Nr. 187, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019”, “Për miratimin listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”aktualisht kemi 725 MN.3 monumente natyre jane te pajisura me plane menaxhimi:- Shpella e Zezë, Pëllumbas- Delta e Përroit të Palasës- Pylli i Përzier i Maliqit urdhër MTM nr.130,132,133, datë 25.04.2018.							
03. KATEGORIA IV RNM PARK NATYROR							
1	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 1			4927.67

2	Dibër, Kukës	Korab - Koritnik	VKM 2011	VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 2	Po	Urdhër nr. 2029, datë 31.12.2014	53850
3	Dibër, Lezhë	Liçeni i Ulzës	VKM 2013	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 3	Po	Urdhër nr. 341, datë 23.09.2024	4205.15
4	Dibër, Tiranë, Elbasë	Mali me Gropa - Bizë - Martanesh	VKM 2007	VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 4	Po	Urdhër nr. 2028, datë 31.12.2014	26043.34
5	Durrës	Qafshatë	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 5			6864.36
6	Vlorë	Syri i Kaltër	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 6			293.3
7	Gjirokastrë	Zagori	VKM 2018	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 7			24607.63
8	Berat	Balloll	VKM 1997	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 8			323.3
9	Berat	Bogovë	VKM 1997	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 9			342.1
10	Gjirokastrë	Bredhi i Kardhiqit - Rrëzomë	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 10			4303.6
11	Gjirokastrë	Bredhi i Zhulatit		VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 11			936.2
12	Korçë	Ëngonj	VKM 1977	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 12			250.3
13	Elbasan	Dardhë - Xhyrë	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 13			400.3
14	Korçë	Gërmenj		VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 14			1410
15	Vlorë	Karaburun	VKM 1977	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 15			17490.7
16	Lezhë	Kune - Vain - Patok - Fushë Kuqe - Ishëm	VKM 2010	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 16			8092.3
17	Shkodër	Liçeni i Shkodrës	VKM 2005	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 17			24049.75
18	Elbasan	Polis	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 18			45.1
19	Elbasan	Stavraj - Sopot	VKM 1996	VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 19			1548.9
20	Shkodër	Lugina e Shalës		VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 20			10619.35
21	Kukës, Shkodër, Lezhë	Munellë		VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 22			20760.05
22	Korçë	Lugina e Gjergjoviçës		VKM nr. 60, datë 26.01.2022 Aneksi 23			2966.3
23	Vlorë	Porto Palermo		VKM nr. 557, datë 29.07.2022			1694.98
Sipërfaqja IV							216,024.68
04. KATEGORIA V PEIZAZH I MBROJTUR							
1	Lezhë	Bjeshka e Oroshit	VKM 1996	Vendim Nr.598_date 25.9.2024			4650.5
2	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM 1996	Vendim Nr.594_date 25.9.2024			2065.8
3	Korçë, Elbasan	Guri i Nikës - Valamarë - Lenie	VKM 1996	Vendim Nr.591_date 25.9.2024			5172.7
4	Durrës	Krastë - Verjon	VKM 2018	Vendim Nr.595_date 25.9.2024			1470.1
5	Elbasan	Kuturman - Qafë Bushi	VKM 1977	Vendim Nr.590_date 25.9.2024			4160.26
6	Korçë	Liçeni i Pogradeçit	VKM 1999	Vendim Nr.597_date 25.9.2024			27730.54
7	Shkodër	Lumi Buna - Velipojë	VKM 2005	Vendim Nr.593_date 25.9.2024	Po	Urdhër nr. 131, datë 25.04.2018	19471.17
8	Vlorë, Fiet	Pishë Poro - Nartë		Vendim Nr.596_date 25.9.2024			16124.61
9	Durrës	Rrushkull	VKM 1995	Vendim Nr.589_date 25.9.2024			579.5
10	Durrës	Bishkamëz		Vendim Nr.592_date 25.9.2024			491.5
Sipërfaqja V							81,916.68
TOTALI ZM.		45					611,865.12

Burimi: Të dhëna nga AKZM, përpunuar nga Grupi auditimit KLSH-së.

Heqja dhe ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur kombëtare, si dhe i ndryshimit të sipërfaqes së tyre, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, pas marrjes së mendimit nga ministria/ministritë që mund të kenë propozuar heqjen ose ndryshimin e statusit nga bashkia, ekspertë të florës dhe faunës, institucionet kërkimore-shkencore, shoqëria civile dhe

nga pronarët privatë kur në zonën e mbrojtur janë përfshirë edhe pronat e tyre, si dhe nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonë, të pajisur me leje mjedisi².

Tabelë nr. 2 Ndryshimet në sipërfaqe të ZMM, sipas kategorive, për periudhën 2021- shtator 2024.

Nr.	Kategoria ZM	Numër ZM	Sipërfaqja e mëparshme (ha)	Ndryshimet në sipërfaqe		Total Sip. Ha
				Sipërfaqja e shtuar (ha)	Sipërfaqja pakësuar (ha)	
Sipërfaqja II	Park Kombëtar	12	238,359.59	78,279.56	2,715.39	313,923.35
Sipas VKM Nr. 187, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019", "Për miratimi listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare" aktualisht kemi 725 MN . 3 Monumente Natyre janë të pajisura me plane menaxhimi:- Shpella e Zezë, Pëllumbas- Delta e Përoit të Palasës- Pylli i Përzier i Maliqit						
Sipërfaqja IV	Park Natyror	23	173,566.5	50,462.13	8003.95	216,731.33
Sipërfaqja V	Peizazhi i Mbrojtur	10	85,546.34	5,204.56	8,834.20	81,916.7
	TOTAL ZM	45	497,472.43	133,649.5	19,553.55	611,568.38

Burimi i të dhënave: AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH

• Për periudhën e auditimit 2021-shtator 2024, zonat e mbrojtura mjedisore kanë pësuar ndryshime (shtesa/pakësime), me VKM nr.59, datë 26.01.2022 "Për miratimin e ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes të Ekosistemeve Natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore" dhe VKM nr.60, datë 26.01.2022 "Për miratimin e ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV) e zonave të mbrojtura mjedisore", përkatësisht:

- sipërfaqja e ZMM para vitit 2021 është 497,472.43 ha;
- sipërfaqe e shtuar 133,649.5 ha;
- sipërfaqe e pakësuar 19,553.55 ha;

Me ligjin e ndryshuar, nr.21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", sipas nenit 36, pika 2 propozimet për ndryshimet e sipërfaqes së zonës së mbrojtur bëhen nga AKZM-ja, ministritë e linjës, të vetëqeverisjes vendore, konsultuar paraprakisht me komunitetin vendas etj., ku argumentohet nevoja e ndryshimit.

Në mënyrë analitike shtesat dhe pakësimet sipas VKM-ve dhe kategorive të zonave të mbrojtura të prekura nga ndryshimet si dhe ato të shtuara për herë të parë, referuar Kreu V Planet e Menaxhimit, neni 42 i ligjit nr.81/2017, i ndryshuar, paraqiten në Aneksin nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për secilën zonë të mbrojtur hartohet një plan menaxhimi 10-vjeçar, i cili shërben si dokument bazë për ruajtjen e zhvillimin e zonës dhe zbatohet nga administrata e zonës së mbrojtur. Në të përcaktohen qartë në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara, ato që mund të ushtrohen pasi të pajisen me leje mjedisi apo që duan miratim të administratës së zonës.

• Konkretisht, për 45 zona të mbrojtura mjedisore, janë miratuar dhe janë në fuqi 14 plane menaxhimi ose 31% e totalit të zonave të mbrojtura, nga të cilat 4 prej tyre, u mbaron afati në dhjetor të vitit 2024, veprime në mos përmbushje të detyrimit të Kreut V Planet e Menaxhimit, Neni 42 i ligjit nr.81/2017, i ndryshuar.

• Zonat e mbrojtura mjedisore, nuk rezultojnë të regjistruara për sipërfaqen e tyre në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe se deri në përfundim të periudhës së auditimit, nga ballafaqimi me strukturat drejtuese, ende nuk rezulton të jenë ngritur grupe pune për regjistrimin e tyre, duke ndikuar kështu në mos formimin e fondit të sipërfaqeve të mbrojtura në shkallë qarku e republike, bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave, që miratojnë zonat e mbrojtura mjedisore, veprime në mos përmbushje të detyrimit tek Kreu VII Pronësia dhe të drejtat në zonat e mbrojtura, neni 55- Regjistrimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të ligjit nr.81/2017, i ndryshuar.

Auditimi mbi inspektimet dhe monitorimet e veprimtarive ekonomike që ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore.

² Ligji nr. 81/2017, i ndryshuar, Kreu III, Ndryshimi i Zonave të Mbrojtura, Neni 35,36, 36/1.

* Inspektimi i zonave të mbrojtura mjedisore (ZMM) realizohet nga AKZM dhe trupat inspektuese të AdZM-ve rajonale, të cilat kryejnë funksionet kontrolluese, pavarësisht nga forma e pronësisë³, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

* Monitorimi i veprimtarive të zonave të mbrojtura mjedisore përcaktohet në nenin 60 të ligjit të nr.81/2017, i ndryshuar:

1. Monitorimi i veprimtarisë së zonave të mbrojtura mjedisore ushtrohet nga administrata rajonale e zonave të mbrojtura dhe nga subjektet e angazhuara prej saj në monitorim.
2. Subjektet, që kryejnë veprimtari të lejuar në zonat e mbrojtura mjedisore, vetë monitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuara nga AKZM-ja,
3. AKZM-ja është përgjegjëse për drejtimin, organizimin, monitorimin e zbatimit të planit, mbikëqyrjen periodike vjetore, rezultatet e monitorimit të tij, si dhe për administrimin e publikimin në faqen zyrtare elektronike të saj të të dhënave përkatëse.
4. Plani i monitorimit dhe i vet monitorimit të zonave të mbrojtura është pjesë e monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe është pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit, sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.
5. Në zbatimin e programeve të monitorimit, AKZM-ja mund të angazhojë institucione kërkimore-shkencorë, si dhe subjekte publike.

Në tabelën më poshtë paraqiten numri i inspektimeve dhe monitorimeve të realizuara nga Sektori i Monitorimit, Menaxhimit, Kontrollit dhe Regjistrimit nga AKZM dhe AdZM-të rajonale, për periudhën 2022-30.09.2024:

Tabelë nr.3 Mbi numrin e monitorimeve/inspektimeve 2022-30 shtator 2024 nga AKZM dhe 12drejtoritë rajonale.

Nr	AdZM	Viti 2022			Viti 2023		Janar-Shtator 2024		Nr.Mo nitori meve	Nr. Inspekti meve	P.verb ale (raste)
		Nr. p.verbale ve të kostatimi t në ZMM	Nr.Mo nitori m	Nr. Inspekti meve	Nr.i/procesverb aleve të kostatimi në ZM	Nr. Monitori meve	Nr. Inspektim eve	Nr. proëes verbaleve të kostatimi në ZM			
1	AKZM	0	0	21	1	0	14	0	0	8	
2	Berat	45	2170	697	13	2259	742	15	1884	493	
3	Dibër	17	1609	1122	6	1352	687	8	1381	216	
4	Durrës	13	1704	232	9	2028	412	10	1063	384	
5	Elbasan	5	1583	398	24	1912	484	6	1487	282	
6	Fier	7	2759	662	15	2351	908	14	1633	728	
7	Gjirokastër	22	3434	505	11	4053	594	10	2763	755	
8	Korçë	7	1698	246	27	1352	249	9	930	196	
9	Kukës	33	2249	515	5	2604	507	6	2033	360	
10	Lezhë	12	1422	464	16	1509	295	16	1015	270	
11	Shkodër	47	4022	516	23	2499	138	39	2546	106	
12	Tiranë	21	756	218	30	2596	386	20	1960	112	
13	Vlorë	29	3861	277	28	3682	408	17	2339	366	
TOTALI		258	27,267	5,873	208	28,197	5,824	170	21,034	4,276	636

Burimi të dhënave: Sektori Monitorimit, Menaxhimit, Kontrollit në AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Nga auditimi mbi kryerjen e monitorimeve dhe inspektimeve rezultoi se:

- Për vitin 2021 nuk ka të dhëna mbi inspektimet/monitorimet, për të cilën mbajnë përgjegjësi ish Titullari z. Z. D dhe përgjegjësi i Monitorimit mbi kryerjen e monitorimeve dhe inspektimeve në qendër dhe në drejtoritë rajonale.

Për vitin 2022-30.09.2024 janë realizuar gjithsej 76,498 monitorime 15,973 inspektime dhe janë mbajtur 636 procesverbale inspektimesh me vlerë të konsiderueshme dëmi 590,457,704 lekë, vlerë e cila nuk është arkëtuar, pasi deri në muajin dhjetor 2023 AKZM dhe AdZM-të, nuk kanë pasur të sanksionuar me ligj të drejtën e mbledhjes së vlerës së dëmit dhe gjobave, por u janë dërguar për ndjekje të mëtejshme të procedurave ligjore, institucioneve si IKMT, Drejtorive të Policisë dhe Prokurorisë sipas rretheve.

Në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative në zonat e mbrojtura nga AKZM dhe AdZM-të, rezultojnë të jenë marrë dënime plotësuese -vlerë dëmi, por në asnjë rast nuk ka

³ Ligji nr.81/2017, i ndryshuar, neni 66.

sekuestrim mjetesh apo vlerë monetare dhe materiale, në kundërshtim me nenin 69, pika 2 e Ligjit nr.81/217, i ndryshuar ku citohet: “Vendimi për kundërvajtjen administrative përmban dënimin me gjobë për kundërvajtësin dhe dënime plotësuese si më poshtë: a) sekuestrimin e mjeteve dhe automjeteve që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes; b) sekuestrimin e çdo vlere monetare dhe materiali, lëndë drusore e jo drusorë, bimë medicinave, florë dhe faunë, të përfituar nëpërmjet kundërvajtjes; ë) pezullimin e veprimtarisë dhe çmontimin e instalimeve, për sekuestrimin e mjeteve”;

Mbështetur në ligjin nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar, neni 60, 66, 67, si dhe VKM-së, nr.128, datë 13.02.2020 “Përcaktimin e vlerës së dëmit”, strukturat monitoruese në AdZM-të, rajonale mbajnë procesverbal konstatimi, ku përcaktojnë vlerën e dëmit dhe pasojat të lehta apo të rënda. Bazuar në të dhënat e evidencës analitike mbi monitorimet, inspektimet, procesverbalet e konstatimit, të detajuara sipas viteve dhe në vlerë, u hartua evidencë përmbledhëse, si më poshtë:

Tabela nr.4 Përmbledhëse mbi monitorimet, inspektimet, p.verbalet e konstatimit dhe vlera e dëmit 2022-30.09.2024

Viti	Numri Inspektime /Monitorime	Numri procesverbale të konstatimit	Vlera e dëmit në Total (lekë)
2022	33,140	258	148,986,581
2023	34,021	208	240,448,631
2024	25,310	170	201,022,492
Totali	92,471	636	590,457,704

Burimi të dhënave: Sektori Monitorimit, Menexhimit, Kontrollit në AKZM, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

- Vlera e dëmit për 3(tre) vitet është në total **590,457,704** lekë, e cila e detajuar sipas shkaqeve të konstatuara: nga zjarret për 157 raste në vlerën 260,795,000 lekë dhe nga veprimtaritë e kundërligjshme si prerje drurësh, gurë dekorative etj, për 479 raste në vlerën 329,662,704 lekë.

Tabela nr.5 Evidenca e Vlerës së Dëmit në ZMM viti 2022, 2023, 2024.

Në lekë

Viti	Vlera e dëmit nga zjarret	Rastet	Dërguar D.Policisë dhe Kallëzim Penal Prokurori	Vlera e dëmit nga Veprimtaritë e kundërligjshme, si prerje drurësh, gurë dekorative etj.	Rastet	Dërguar D.Policisë dhe Kallëzim Penal Prokurori
2022	12,619,500	65	Po	136,367,081	193	Po
2023	116,352,750	22	Po	124,095,881	186	Po
2024	131,822,750	70	Po	69,199,742	100	Po
Totali	260,795,000	157		329,662,704	479	
			TOTAL DËMI	590,457,704		

Burimi të dhënave: Drejtoria Juridike; Sektori Monitorimit, Menaxhimit, Kontrollit në AKZM, AdZM përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Në përmbushje të detyrave funksionale, në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, si dhe evidentimin, ndëshkimin e subjekteve fizike/juridike që ushtrojnë aktivitete të paligjshme në territorin e zonave të mbrojtura, AKZM-ja dhe strukturat monitoruese të AdZM-ve, kanë dërguar dokumentacionin e duhur ligjor strukturave ligj zbatuese IKMT-së, Drejtorive të Policisë dhe Prokurorisë sipas rretheve, përkatëse ku është konstatuar shkelja, për ndjekje të mëtejshme të procedurave administrative ligjore. Sipas konfirmimit nga struktura drejtuese e AKZM-së, nuk rezultojnë asnjë kthim përgjigje, nëse kanë përfunduar procesin.

Strukturat monitoruese të AdZM-ve në qarqe në të gjitha rastet, kur është me dhe pa autor, kanë plotësuar dokumentacionin në përputhje me ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 66, pika 2, gërma “ç” kanë bënë kallëzim penal në Prokurori.

Me mbylljen e çështjeve nga Prokuroria dhe marrjen e Vendimit nga Gjykata, nga administratat rajonale të zonave të mbrojtura dhe AKZM-ja, fillojnë procedurat administrative për vjeljen e vlerës së dëmit. Nga muaji Dhjetor 2023 e në vazhdim sipas Urdhrit nr.254, datë 11.08.2023 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe AdZM, ka tagrin e marrjes së vendimeve me masa administrative gjore referuar ligjit të Inspektimit në RSH si dhe ligjit të Zonave të Mbrojtura.

-Inspektimet online për zonat e mbrojtura kanë filluar në dhjetor 2023, afro katër muaj më vonë, nga dalja e Urdhrit nr.254, datë 11.08.2023 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit “Për Miratimin e Përmbajtjes dhe Modeleve të Akteve Për Kundërvajtjet në Pyje” si dhe Ligjin nr. 10433/2011 “Për inspektimin në RSH”. Nga muaji dhjetor 2023 deri në 30.09.2024 janë kryer 57 inspektime online, për të cilat janë vendosur masa administrative në vlerën 2,750,000 lekë dhe dënime

plotësuese me vlerë dëmi 1,034,800 lekë, nga të cilat janë arkëtuar gjopa në vlerën 860,000 lekë dhe vlerë dëmi 0 lekë. Nga 57 inspektime, janë në proces gjyqësor 15 prej tyre.

-Gjithashtu u konstatua se dokumentacioni që hidhet në sistem nuk lë gjurmë mbi datën e hedhjes së tyre, duke lejuar në këtë mënyrë hedhjen e tyre në çdo kohë.

Tabelë nr. 6 Inspektimet online dhe masat administrative sipas AdZM, periudha Shkurt 2023-30 shtator 2024 Në lekë

Nr.	AdZM	Plani	Fakt	Komente	Masa gjobës e	Vlera dëmit e	Ark/gjobjë	Paarkëtuar
1	AKZM Tiranë	8	8	Në 7 raste janë dhëna masa dëmit administrativ gjobë:6 ne proces gjyqësor dhe 1 rast s'ka informacion	420,000	-	-	420,000
2	Durrës	-	-	-	-	-	-	-
3	Berat	0	6	Në 3 raste dhënë demin administrativ me gjobë 1 rast Bllokim aktivitet, 2 raste pa shkelje, 1 rast në proces gjyq.	150,000	-	100,000	50,000
4	Elbasan	0	4	Në 4 raste dhënë masa administrative gjobë si dhe Pezullim aktivitetit deri në lidhje kontrate sipas përcaktimeve ligjore. 3 raste proces gjyq dhe 1 rast ne negocim për lidhje kontrate.	290,000	-	-	290,000
5	Fier	0	2	Në 2 raste dhënë masa administrative me gjobë. 1 rast proces gjyqësor.	50,000	105,000	0	155,000
6	Korçë	0	8	Në 2 raste dënim administrativ gjobë dhe në proces gjyq; dhe 6 raste pa shkelje.	80,000	70,000	0	150,000
7	Lezhë	0	3	Në 3 raste dhënë dënim kryesore me gjobë si dhe dënim plotësues me vlerë dëmi. 2 raste ankimime në gjykatë.	240,000	465,600	0	705,600
8	Kukës	0	5	Në 1 rast marrë masë administrative gjobë. 4 raste pa shkelje	80,000	9,000	0	89,000
9	Tiranë		9	Në 3 raste marrë masa administrative dënim kryesore gjobë. 6 raste pa shkelje.	80,000	0	80,000	0
10	Vlorë		12	Në 9 raste dhënë masa me dënim kryesore gjobë si dhe në 8 raste dënim plotësues vlerë dëmi sipas ligji 81/2017 per zonat e mbrojtura, datë 5/4/2017, nenit/neneve 67, 68. 3 raste pa shkelje.	1,360,000	385,200	680,000	1,065,200
11	Shkodër		0	-	-	-	-	-
12	Dibër		0	-	-	-	-	-
13	Gjirokastrë		0	-	-	-	-	-
	Total		57		2,750,000	1,034,800	860,000	2,924,800

Burimi i të dhënave: Sektori i Monitorimit, Menaxhimit në AKZM dhe Adzm-të (12 qarqe), përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

* Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit në sistemin unik e-Inspektim, rezultuan parregullsi, pasi nuk kishin bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e duhur ligjor si: Plan biznesi, relacion me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë si vlera e investimit të paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të subjektit të hartuar nga audituesi, si dhe vërtetim nga institucioni shtetëror përkatës për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira sipas nenit 7 të kontratës; mungesë shkresash përcjellëse drejtuar institucioneve përkatëse si IKMT-së, Policisë së qarkut përkatës, për raste të shkeljes ligjore etj., veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.201 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 45-48 dhe Ligjin nr.81/2017“Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar neni 67, 68, 69 si dhe Rregulloren e brendshme nr.51, datë 06.02.2024 “Miratimin e Rregulloreve të Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura” neni 37- Detyrat e AdZM, pika f, g, i, si dhe neni 39 - Detyrat e përgjegjësit të Sektorit të AKZM-së, konkretisht:

Për AdZM Berat:

1- Me procesverbal nr.AKZM-BR-2024-000007 - 1 datë: 29/07/2024, inspektuar subjekti me veprimtari “Dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore/kullosore”, objekti i inspektimit: Kontroll zbatimi i kushteve të Kontratës; në Listë Verifikimin për Inspektim në subjekte që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonë të mbrojtur, inspektuar nga z. P. D, z. S. H, z. A. M, citohet se subjekti ka plotësuar të gjitha kushtet e lejes, por në dokumentacion bashkëlidhur mungon:

-mandat arkëtimi i pagesës vjetore në kundërshtim me nenin 3 të kontratës informacione mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, në kundërshtim me nenin 7/h të kontratës.

2- Me procesverbal nr. AKZM-BR-2024-000007 - 1 datë: 29/07/224, objekti i inspektimit: Kontroll në veprimtarinë e dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore/kullosore; në listë verifikimin nr. AKZM-BR-2024-000011 - 2/1, datë 11/10/2024, nga grupi i inspektimit i përbërë

nga z. E. H, z. A. M, z. P. D është cituar se: subjekti plotëson kushtet e kontratës, por rezulton se:

-Mungon mandat arkëtimi i pagesës vjetore, përcaktuar në nenin 3 të kontratës.

-Nuk ka relacion me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë si vlera e investimit, e paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të subjektit të shoqëruara me relacion përkatës të hartuar nga audituesi, si dhe nuk është përcaktuar numri e të punësuarve, në kundërshtim me nenin 7/h të kontratës.

3-Me procesverbal Nr. AKZM-BR-2024-000008 - 1 datë: 30/08/2024 inspektimi i ushtruar në subjektin me veprimtari dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore/kullosore, në Vendim përfundimtar Nr. AKZM-BR-2024-000008 - 5 datë: 17/09/2024, nga inspektorët është cilësuar se subjekti i plotëson kushtet e kontratës, por nga verifikimi del se:

-Nuk ka relacion me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë si vlera e investimit, paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të subjektit të shoqëruara me relacion përkatës të hartuar nga audituesi, si dhe vërtetim nga institucioni shtetëror përkatës për numrin e të punësuarve, në kundërshtim me nenin 7/h të kontratës.

Për AdZM Kukës.

1-Me procesverbal Nr. AKZM-KU-2024-000003 - 2 datë: 26/07/2024, inspektimi i ushtruar nga z. E. M, z. P. S, në subjektin me veprimtari dhënie në përdorim të sipërfaqeve Hec Tërfoja, në proces verbal citohet se subjekti ka plotësuar kushtet e kontratës, por rezulton se mungon i gjithë dokumentacioni shoqërues.

Për AdZM Vlorë.

1-Me procesverbalin nr AKZM- VI-2024-000008-2 datë 25/07/2024, inspektimi i ushtruar, në subjektin “S.” me veprimtari “Për menaxhimin e territorit për qëllime pushimi dhe argëtimi”, në proces verbal citohet se subjekti ka plotësuar kushtet e kontratës, por rezulton se mungon: vërtetim nga DRT për pagesën e kontributeve të sig. shoqërore dhe shëndetësore.

Në lidhje me auditimin e procedurave të lidhjes së kontratave të qirasë për përdorimin dhe gëzimnt e shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore.

Referuar nenit 56, pika 1 të ligjit nr.81/2017 i ndryshuar: “Në zonat e mbrojtura mjedisore mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e parashikuar në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur ose planin e menaxhimit dhe që nuk ndalohej shprehimisht nga ky ligj”. Afati i përdorimit/gëzimit të shërbimeve të lejuara është deri në 10 vjet, me të drejtë rinovimi, me miratim nga ministria dhe rishikohet çdo 5 vjet nga AKZM dhe AdZM.

Sipas të dhënave nga AKZM, rezulton se, deri në 30.09.2024 janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje me vlerë të qirasë vjetore 56,369,293 lekë, nga të cilat 89 subjekte për ushtrim veprimtari ekonomike të ndryshme me vlerë qira vjetore 18,550,705 lekë dhe 16 HEC-e me vlerë të qirasë vjetore 37,818,588 lekë.

Tabelë nr.7 Përmbledhëse me kontratat e qirasë në numër dhe në vlerë si dhe detyrimet e pa paguara deri në 30.09.2024 Në lekë ,

AGJENËIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA														
Përmbledhje_Kontratat në ZM dhe detyrimet e pa paguara_(Kontrata për veprimtari të ndryshme ekonomike + HEË-e) deri në datë 30.09.2024)														
Nr.	AdZM	Te ardhura vjetore				Detyrimet e munguara								
		Kont rata total	Vlera vjetore	Kontrata		HEC formale		Subjekte informale	Vlera totale e detyrimit		Detyrime veprimtari te ndryshme ekonomike		Detyrime HEC	
		_A+B	A+B	A	B	A	B	A1+B1	A1+B1	A1	B1	A1	B1	
1	Kukes	9	7,841,942	7	1,727,942	2	6,114,000	10	108,118,215	1	345,118	9	107,773,097	
2	Dibër	3	17,485,846	-	-	3	17,485,846	7	91,412,763	-	-	7	91,412,763	
3	Tiranë	22	7,121,011	21	5,101,011	1	2,020,000	-	-	-	-	-	-	
4	Elbasan	5	1,932,083	2	6,932	3	1,925,151	8	103,929,697	2	1,527,520	6	102,402,177	
5	Berat	7	1,843,844	6	492,092	1	1,351,752	2	1,977,419	1	443,419	1	1,534,000	
6	Korçë	13	8,268,398	8	1,648,898	5	6,619,500	6	5,176,110	6	5,176,110	-	-	
7	Shkodër	22	6,087,994	21	3,785,655	1	2,302,339	-	-	-	-	-	-	
8	Gjirokastër	-	-	-	-	-	-	11	64,386,494	-	-	11	64,386,494	

9	Lezhe	2	148,650	2	148,650	-	-	-	-	-	-	-	-
10	Durrës	10	2,732,139	10	2732139	-	-	12	1,148,499	12	1,148,499	-	-
11	Fier	-	-	-	-	-	-	5	11,005,283	5	11,005,283	-	-
12	Vlora	12	2,907,386	12	2907386	-	-	2	9,859,500	2	9,859,500	-	-
		105	56,369,293	89	18,550,705	16	37,818,588	61	397,013,980	27	29,505,449	34	367,508,531

Burimi i të dhënave: AKZM dhe përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Numri më i lartë i kontratave të qirasë të lidhura është regjistruar nga AdZM Tiranë dhe AdZM Shkodër, me nga 22 kontrata secila, që përbëjnë 21% të numrit të përgjithshëm të kontratave të lidhura. Pasuar nga AdZM Korçë me 13 kontrata (12% e gjithsej kontratave të lidhura) dhe AdZM Vlorë me 12 kontrata (11% të numrit të përgjithshëm të kontratave). Ndërsa për nga vlera AdZM Dibër zë 31% të vlerës gjithsej të kontratave.

Nga 105 kontrata qiraje të lidhura gjithsej rezultojnë, me detyrime të papaguara 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë, të detajuara: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë dhe 26 HEC-e me detyrime të papaguara në vlerë 367,508,531 lekë. Të detajuara sipas subjekteve, deri në 30.09.2024. paraqiten në Aneksin nr.1 të këtij raporti. Peshën specifike më të lartë të detyrimit e zë AdZM Kukës me vlerë 108,118,215 lekë për 10 subjekte (1 me veprimtari ekonomike dhe 9 HEC-e), që përbën 27% të vlerës totale të detyrimit. Pasuar nga AdZM Elbasan, me një vlerë prej 103,929,697 lekë për 8 subjekte (2 me veprimtari ekonomike dhe 6 HEC-e), që përbën 26% të vlerës totale të detyrimit.

Nga 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrime të papaguara në vlerë 29,505,449 lekë (AdZM Elbasan 2; Berat 1; Kukës 1; Korçë 6; Durrës 12; Fier 3; Vlorë 2), 16 prej tyre janë në procese gjyqësore, 4 kallëzim penal dhe 7 janë në negociata për lidhje akt marrëveshje për shlyerje detyrimesh.

Detyrimet nga aktivitetet e HEC-ve.

✓ Gjithsej ndër vite, kanë ushtruar veprimtarinë në zonat e mbrojtura mjedisore 50 HEC-e, nga të cilat 16 prej tyre (me kontratë qiraje) vijojnë aktivitetin në 7 AdZM dhe 26 rezultojnë me detyrime të papaguara në vlerë 367,508,531 lekë dhe 8 HEC-e janë informale pa vlerë.

✓ Detyrimet e papaguara ndër vite për 26 hidrocentrale (HEC-e) me vlerë totale 367,508,531 lekë (dhe 8 HEC janë informale pa vlerë), janë të shpërndarë përkatësisht: AdZM Kukës (4); AdZM Dibër (7); AdZM Elbasan (4); AdZM Berat (1) dhe AdZM Gjirokastrë (10).

✓ Detyrimet e papaguara për 26 HEC-e në vlerën totale 367,508,531 lekë përbëhen nga: 19 HEC-e, për të cilat është ndërprerë kontrata me vlerë 229,220,496 lekë dhe 7 HEC-e, për të cilat kontratat janë përfunduar (pa rinovuar) me vlerë 124,548,502 lekë dhe 8 janë informale e pa vlerë detyrimi.

✓ Peshën specifike më të madhe për nga numri i HEC-ve me detyrime e zë AdZM Gjirokastrë me 10, Dibër me 7, ndërsa për nga vlera, peshën specifike më të lartë e zënë AdZM Kukës me 29% të vlerës gjithsej të detyrimit, pasuar nga AdZM Elbasan me 28% vlerës gjithsej të detyrimit.

✓ Nga 26 HEC-e me detyrime të papaguara, 25 prej tyre janë në proces gjyqësor, 1 rast kallëzim penal dhe 8 janë informale që nuk kanë pasur kontratë dhe rrjedhimisht as detyrim në vlerë. Të detajuara sipas qarqeve paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë nr. 8 Detyrimet e pa paguara për 34 HEC-e, deri në 30 shtator 2024

Subjektet HEC Formale dhe debitorë (Me kontrata të ndërprerë/përfunduar deri në datë 30.09.2024)												
Nr	AdZM	HEC formale		Komente	HEC me detyrime dhe kamate					Nr. Total	Vlera totale e detyrimit	Komente
		HEC me kontratë (aktivë)			HEC (me detyrime) me kontratë të ndërprerë		HEC me kontratë të Përfunduar/pa rinovuar		HEC Informale			
		Nr.	Vlera qera vjetore		Nr.	Vlera e detyrimit	Nr.	Vlera e detyrimit	Pa kontratë/pa vlerë			
1	Kukës	2	6,114,000	1 Marrëveshje mirëkuptimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me nr.262 prot per një periudhe 4 vjeçare per detyrimin.13739533	3	86,677,058	1	7,356,506	5	9	107,773,097	2 kontrata nuk kanë nisur punime; 2 janë ne proces gjyqësor; 5 nuk ka informacion per vlerën e munguar. Vlera e detyrimit është përcaktuar për 4 subjekte

				lek shume e cila do te paguhet me keste								
2	Dibër	3	17,485,846	1 Marrëveshjes së mirëkuptimit me nr.163 prot. per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura gjatë kontratës 5-vjeçare me keste për 5-vite. Zbritje e shumës prej 1.816.655 leke nga debia totale prej 33.753.422 dhe mbetja 31.936.767 lekë.	5	75,903,767	2	15,508,996		7	91,412,763	7 subjekte në proces gjyqësor
3	Tiranë	1	2,020,000									
4	Elbasan	3	1,925,151		1	2,253,177	3	100,149,000	2	6	102,402,177	6 subjekte në proces gjyqësor
5	Berat	1	1,351,752				1	1,534,000		1	1,534,000	1 subjekt me kallëzim penal
6	Korçë	5	6,619,500									
7	Shkodër	1	2,302,339									
8	Gjirokastrë	0	0		10	64,386,494	-	-	1	11	64,386,494	10 subjekte janë në proces gjyqësor 1 kontrate nuk ka informacion për vlerën e munguar. Vlera e detyrimit është përcaktuar për 10 subjekte.
Totali		16	37,818,588		19	229,220,496	7	124,548,502	8	34	367,508,531	

Burimi i të dhënave: AKZM dhe përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Në lidhje me subjektet informale brenda zonave të mbrojtura.

Spektori i Monitorimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe në Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM), kanë konstatuar se brenda zonave të mbrojtura ndodhen 784 ndërtime dhe aktivitete informale, të cilat janë krijuar kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), para se të ekzistonte një rregullim institucional i plotë dhe një strukturë që do të monitoronte dhe mbikëqyrte përdorimin e territorit zonë e mbrojtur, raste të cilat u janë përcjellë institucioneve ligj zbatuese për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore.

Tabelë nr. 9 Numri i subjekteve informale, deri në 30.09.2024

Regjistri i ndërtimeve informale në ZMM		
Nr	AdZM	Numri objekteve informale në ZM
1	Berat	11
2	Dibër	36
3	Durrës	8
4	Elbasan	10
5	Gjirokastrë	3
6	Fier	141
7	Korçë	2
8	Kukës	106
9	Lezhë	82
10	Shkodër	76
11	Tiranë	91
12	Vlorë	218
Totali		784

Burimi i të dhënave: AKZM dhe përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

AKZM çdo fillim viti, për të gjitha rastet e ndërtimeve informale, ka përcjellë zyrtarisht shkresat pranë institucioneve përkatëse, si Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Drejtorisë së Policisë dhe ASHK-së së rrethit përkatës, për dijeni dhe marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

Me rishikimin dhe ndryshimin e kufijve të zonave të mbrojtura, me VKM-të përkatëse, numri i këtyre ndërtimeve informale është në rënie, pasi referuar kufijve e rinj të ZM disa prej ndërtimeve mbeten jashtë zonës së mbrojtur.

Mbi auditimin e procedurave të lidhjes së kontratave të qirasë nga AdZM Berat, Kukës, Vlorë.
Nga auditimi me përzgjedhje i 11 dosjeve fizike për rregullshmërinë e dokumentacionit mbështetës dhe shoqërues për lidhjen e kontratave të qirasë, të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në zonat e mbrojtura, për subjektet nën auditim, AdZM Kukës, Berat dhe Vlorë, rezultuan parregullsi në dokumentacionin nevojshëm ligjor si nga subjekti kërkues ashtu edhe nga strukturat e AdZM-ve dhe AKZM gjatë procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave, në

kundërshtim me përcaktimet e kërkesave të pikës 6.8, 6.10 dhe 7 të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të MTM-së, “Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to”.

-Ka mospërputhje midis përshkrimit të objektit të veprimtarisë në kërkesat e subjekteve dhe dokumentacionit të vlerësuar nga Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe nga Sektori i Menaxhimit në AdZM-të dhe nuk është e shprehur specifikisht sipas klasifikimit për veprimtari ekonomike përcaktuar në pikën 3/c të VKM-së nr. 1156, datë 24.12.2020, “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”, ç’ka krijon paqartësi në klasifikimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e saktë të vlerës së qirasë vjetore.

Sipas pikës 3/c të VKM-së nr. 1156, datë 24.12.2020 përcaktohet:

- Vlera e sipërfaqes për dhënie në përdorim për veprimtari ekonomike:

- Objekte tregtie, bare, restorante, hotele: 500 lekë/m²/vit;

- Qendra ose komplekse pushimi, kurimi dhe turistike: 800 lekë/m²/vit.

-Në të gjitha rastet e përzgjedhura dhe pas ballafaqimit me këto struktura drejtuese, ka rezultuar se, për asnjë rast, nuk është zbatuar tarifa prej 800 lekë/m²/vit për dhënie në përdorim të sipërfaqeve për veprimtari turistike, megjithëse subjektet që ushtrojnë aktivitete në zona të mbrojtura gëzojnë sipërfaqe të konsiderueshme dhe ofrojnë disa lloje shërbimesh, gjë e cila krijon paqartësi në përcaktimin e vlerës së qirasë vjetore.

-Aktualisht, janë lidhur 15 kontrata qiraje me afat 10 vjeçar, nga të cilat 5 prej tyre janë miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), me shkresë nr. 651 prot., datë 25.05.2021, në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 1, datë 10.02.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të lidhjes së kontratave të qirasë për AdZM Berat, Kukës dhe Vlorë, ka rezultuar si më poshtë:

AdZM Berat deri në 30.09.2024, ka lidhur 7 kontrata qiraje me të ardhura totale të qirasë vjetore prej 1,843,844 lekë/vit, në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" (Kategoria II), shpallur me VKM nr.59, datë 26.01.2022 Aneksi 8, për të cilin ka Plan Menaxhimi miratuar me Urdhër nr.2027, datë 31.12.2014 të Ministrit të MTM-së. Nga këto, 6 kontrata për veprimtari të ndryshme me vlerë 492,092 lekë dhe 1 HEC me vlerë 1,351,752 lekë. Gjithashtu, AdZM ka zgjidhur 2 kontrata qiraje dhe ka përfunduar një kontratë tjetër. Sipas evidencës së debitorëve nga AKZM rezultojnë debitorë 2 subjekte në vlerë 1,977,419 lekë.

Nga auditimi me përzgjedhje i 5 procedurave të lidhjes së kontratave të qirasë, rezultoi se AdZM dhe AKZM nuk kanë përmbushur kërkesat dhe afatet e përcaktuara, në kundërshtim me pikën 6.8 (a, b, c, d, e, f, h) të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të Ministrit të MTM-së dhe VKM nr. 1156, datë 24.12.2020, konkretisht:

1. Subjekti “G.” me Nipt L.....V, person fizik, me kërkesë datë 08.11.2022 me objekt: “Marrje me qira sipërfaqe kullosore 2,000m² tek “Gjurma e Abaz Aliut” në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit”, miratuar me Urdhër nr.330, datë 15.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së znj. D.P me objekt: “Ambient shërbimi për agroturizëm, 1 kat”; Kontrata nr.103/5 prot., datë 22.09.2023, me afat 5-vjeçar (me detyrim konfirmimi çdo vit), sipërfaqe 2,000 m² dhe vlerë 47,153.5 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Berat z. F. N dhe subjektit z. G. Q, ku rezultoi se:

Kërkesa e datës 08.11.2022 është bërë për një sipërfaqe totale 2,000 m², përfshirë një lokal druri (63 m²) dhe verandë (10.5 m²).

-Ekstrakti historik rezulton të jetë bërë aktiv në datë 25.11.2022, pra 17 ditë më vonë se paraqitja e kërkesës.

Nipt (paraqitur i printuar nga sistemi elektronik me datë 28.03.2023-aktiv), pas rreth pesë muaj së paraqitjes së kërkesës.

-Vërtetimi i Gjykatës me datë 28.03.2023, pesë muaj pas paraqitjes së kërkesës.

-Leja e zhvillimit nga Bashkia Skrapar datë 02.09.2024, një vit pas lidhjes së kontratës.

-Vërtetimi nga DRT Berat datë 28.03.2023, rezulton me detyrim për kontributet shoqërore dhe shëndetësore prej 20,264 lekë.

-Plani i biznesit i paraqitur në mars 2023 nuk është i vërtetuar nga ekspertë të fushës dhe nuk është firmosur nga subjekti.

-Relacioni arkitektonik i paraqitur nuk ka firmën dixhitale të inxhinierit arkitekt dhe nuk ka licencë bashkëngjitur.

-Nuk është kërkuar miratim paraprak për ushtrimin e veprimtarisë nga organet shtetërore përgjegjëse.

-Studimi nga AdZM për aktivitetin ekonomik si njësi ushqimi *tendë*, (studimi AdZM) është miratuar, duke specifikuar një sipërfaqe prej 2,000 m². Memo e datës 15.09.2023 rekomandon miratimin e kërkesës, me një total prej 1,900 m² për ndërtim, verandë, parkim dhe kënd lojërash dhe me një vlerë prej 47,153.5 lekë/vit, ndryshe nga raporti teknik që përcakton sip, 2,000 m².

-Raporti teknik ka vërtetuar koordinatat e sipërfaqes prej 2,000 m² dhe vlerën 47,153.5 lekë. Procesverbali i dorëzimit të territorit është i pa firmosur nga një anëtar i grupit të punës (nga specialisti menaxhimi z. D. G).

-Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 2, 7.1, 7/h dhe 8.

2. Subjekti "B." sh.p.k me Nipt K.....M, me objekt: "Dhënie në përdorim të sipërfaqes 1,351.752 m² në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorit", miratuar me Urdhër nr.82, datë 27.02.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së. Kontratë nr.2 prot., datë 01.03.2024 me afat 5-vjeçar (me detyrim konfirmimi çdo vit) dhe vlerë 1,351,752 lekë lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Berat z. F. N dhe znj. D. D, rezultoi se:

HEC-i Ujanik është ndërtuar në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorit" (Kategoria II), sipas VKM nr. 59, datë 26.01.2022. Ky HEC ka marrë një kontratë koncesionare të formës ROT me shoqërinë italiane "E." s. r. l., që më pas kaloi tek "B." sh.p.k, e cila realizoi rehabilitimin dhe vënien në punë të tij. Pasi AdZM ka kryer matje në terren për sipërfaqen e strukturave të HEC-it, është konstatuar një sipërfaqe prej 1,351.752 m², e cila është vlerësuar me tarifë 1,000 lekë/m²/vit, me vlerë qira vjetore prej 1,351.752 lekë, ku rezultoi se:

-Mungon urdhri i drejtorit AdZM për ngritjen e komisionit të vlerësimit të kërkesave;

-Mungon hartimi i studimit, harta ku të përcaktohen qartë kufijtë dhe koordinatat gjeografike, metrike të sip. së kërkuar në zonë të mbrojtur dhe aprovimi i studimit nga AKZM.

-Raporti teknik i AdZM përcakton shtrirjen e tubacionit në parcelat pyjore nr. 52 dhe nr. 48.b, dhe në parcelën kullimore nr. 16, me sipërfaqe 1,351.752 m² dhe vlerë 1,351,752 lekë/vit.

-Subjekti ka shkelur detyrime kontraktuale të përcaktuara në nenin 7, 8.

3. Subjekti "B." me Nipt M.....G, person fizik, me kërkesë datë 15.05.2024 me objekt: "Bujtinë shërbimi, akomodim dhe rekreacion në Parkun Kombëtar Mali i Tomorit", miratuar me Urdhër nr.263, datë 05.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM, sipas së cilës lidhur Kontratë nr. 151/8 prot., datë 10.07.2024 me afat 5-vjeçar (me detyrim konfirmimi çdo vit), sipërfaqe 1334 m² dhe vlerë 32,769 lekë/vit, midis drejtorit të AdZM Berat z. F. N dhe znj. B. B, rezultoi se:

-Fusha e veprimtarisë e regjistruar në QKB: (shërbime marketingu, organizim eventesh të ndryshme), nuk përputhet me aktivitetin që kërkohet të ushtrohet.

-Subjekti ka paraqitur një sipërfaqe të kërkuar prej 1334 m², e cila është në kontradiktë me atë që është shfaqur në planin e biznesit dhe relacionin arkitektonik për 1793 m².

-Studimi nga AdZM, Shtojca A përcakton se lloji i veprimtarisë është: marrje në përdorim për aktivitet ekonomik, lokal shërbimi, akomodim, rekreacion, Shtojca B sipërfaqe pyjore/kullimore 1334 m², miratuar nga drejtori i AdZM; ZPT/Q zona Ujanik dhe Raporti teknik përcakton sipërfaqe gjithsej 1334 m² (nga e cila sip. ndërtimi 400 m²) dhe vlerë 32,769 lekë/vit.

-Nuk ka Memo nga Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit të AKZM drejtuar drejtorit të përgjithshëm të AKZM-së për miratimin e kërkesës së AdZM.

-Mungon detajimi i planit të rehabilitimit dhe masat për kthimin e sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, e cila mund të ndikojë edhe në përlllogaritjen e vlerës së garancisë së kontratës.

-Nuk është kërkuar miratim paraprak për ushtrim veprimtarie nga organi brenda fushës së përgjegjësishë shtetërore ku ushtrohet veprimtaria, në mos respektim të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të MTM-së pika 6.8 gërma “g”.

-Nuk është paraqitur certifikata e klasifikimit për lejimin e ushtrimit të aktivitetit akomodues, në kundërshtim me përcaktimin e nenit 3/b, c, neni 4 të VKM 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”;

- Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 2, 7, 7/1 i kontratës së qirasë.

4. Subjekti “O.” shpk me Nipt L.....S, me kërkesë datë 01.03.2023.me objekt: “Shfrytëzim të rezervës ujore nga burimet nëntokësore të “Tomorit” në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar “Mali i Tomorit”, miratuar me Urdhër nr.386 prot., datë 08.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM, Kontratë datë 22.09.2023 me afat 5-vjeçar, sipërfaqe 240,15m² dhe vlerë 204,384 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Berat z. F. N dhe z. administratorit të shoqërisë z. Sh. M, rezultoi se:

–Kërkesa 01.03.2023 drejtuar AdZM Berat, pasi burimi ujqor ndodhet në zonë të mbrojtur dhe pronësia private.

-Kërkesa është bërë për burim ujqor në zonë të mbrojtur, por mungon miratimi paraprak nga autoritetet përkatëse, pasi Leja për përdorimin e burimeve ujore nga Këshilli i Basenit Ujqor Seman me Vendim nr. 514/1, datë 03.05.2018 ka qenë me periudhë e vlefshmërisë deri në 12.04.2023, ndërsa kontrata lidhur në datë 10.07.2024.

-Projekti teknik pa firmë dixhitale të inxhinierit D.T.

-Plani i Rehabilitimit pa firmë dixhitale të inxhinieres A. M (nuk paraqitet certifikate) dhe pa detaje të nevojshme.

-Vërtetim nga DRT Berat, datë 28.07.2023, për pagesën për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore vetëm për administratorin, jo për punonjësit e tjerë, si dhe paraqitur 5 muaj pas kërkesës.

- Procesverbali i dorëzimit të terrenit datë 15.11.2023, rreth katër muaj pas datës së lidhjes së kontratës.

- Nuk ka raportim të detajuar mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, për investimet dhe pagat e punonjësve.

- Kontrata është lidhur 38 ditë para daljes së Urdhrit të Drejtorit të AKZM-së AKZM, dhe procesverbali i dorëzimit të terrenit është dorëzuar me vonesë.

Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 2, 7, i kontratës së qirasë.

5. Kontratë e zgjidhur: Subjekti “E.” person fizik me Nipt M.....V me kërkesë datë 01.03.2023.me objekt: “Qendër rekreacioni, pushime, argëtim, shëndetësore për zhvillimin e turizmit pa cënuar vlerat natyrore të parkut” në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar “Mali i, Tomorit”, miratuar me Urdhër nr.231 datë 15.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM z. Z. D, me afat 10 vjet, me të drejtë rinovimi çdo vit, sipas së cilës lidhur Kontratë nr. 108/5 prot., datë 21.10.2021 me afat 10-vjeçar, sipërfaqe 30.000 m² në zonën e mbrojtur PK “Mali i Tomorit” dhe vlerë 443,419.1 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Berat z. F. N dhe z. E. K, rezultoi se:

Subjekti nuk ka filluar aktivitetin sipas kontratës brenda vitit të parë, duke kërkuar rinovimin e saj.

-Nuk ka miratim nga MTM, për lidhje të kontratës me afat 10 vjeçar, në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 1, datë 10.02.2021.

- Ekstrakti historik i regjistrimit në QKB - Punime të ndryshme në fushën e ndërtimit (punime çatie) nuk përputhet me objektin e veprimtarisë së kërkuar.

- Të dhënat mbi kufizimet e ngastrës dhe koordinatat e objektit të përcaktuara në procesverbalin e dorëzimit të ngastrës nuk janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 1 në objektin e kontratës.

-Vlera e detyrimit të qirasë është 443,419 lekë për periudhën 2023-2024.

- Subjektit edhe pse me detyrim të papaguar nuk i është zgjidhur kontrata, në mosrespektim me nenin 10 - Zgjidhja e kontratës, pika 10.3 “Kontrata zgjidhet dhe për shkak të mosrespektimit të kushteve kontraktore, të moskryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar,”; pika 10.3 “Njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes së saj”.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi z. F. N me detyrë drejtor i AdZM Berat; z. E. K p/sektori menaxhimit; z. S. Xh me detyrë p/sektori menaxhimit në AKZM; znj. A. S, z. M. C, z. Sh. L - grupi punës për hartimin e Raportit teknik; z. E K dhe z. P. D spec. Monitorimi;

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni datë 06.12.2024, protokolluar në KLSH me nr.1125/12 datë 11.12.2024, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar

1.Subjekti “G.” ka paraqitur me vonesë: dokumentacionin për marrje në përdorim të sip. zonë e mbrojtur; pagesën për kontribute të sig.shoq dhe se ndryshimi i sipërfaqes është lapsus nga hartuesit e memos, por llogaritja dhe kontrata janë bërë me sip, e duhur sipas projektit teknik. Bashkëlidhur p.v dorëzimit të territorit, datë 12.09.2024t dhe firmosur nga grupi, mandat pagesa e bankës për likuidimin e qirasë së vitit 2024.

2.Subjekti “B.” sh.p.k ka kontratë të formës ROT për Hec-in, ndërtuar para vitit 1990, i është kërkuar harta me prerjet tërthore në diametër për llogaritjen e sip. që zë tubacioni. Dokumentacioni nuk ka plan rehabilitimi, pasi në përfundim sip. do t’i kthehet shtetit. Bashkëlidhur urdhri nr. 5 datë 11.03.2024 i drejtorit të AdZM për ndjekjen e kontratës; p.v dorëzimit të territorit, datë 12.09.2024 dhe firmosur nga grupi i punës dhe njoftimi drejtuar subjektit datë 22.10.2024 për pagesën e sigurimi të objektit, referuar detyrimit të përcaktuar në nenin 7/1 të kontratës.

3. Subjekti “B.” ka përditësuar fushën e veprimtarisë në QKB, më vonë se periudha e dorëzimit së kërkesës për marrje në përdorim sip, zonë e mbrojtur. Llogaritja e vlerës së qirasë vjetore është bërë pas përditësimit të projektit teknik, hartës dhe plan vendosjes së paraqitur nga subjekti. Bashkëlidhur ekstrakti historik datë 22.10.2024 dhe njoftimi datë 18.11.2024 drejtuar subjektit për pagesën e sigurimit të objektit, referuar detyrimit të përcaktuar në nenin 7/1 të kontratës.

4. Data e lidhjes së Kontratës së qirasë me subjektin “O.” është lapsus (Kontratë është me nr.52/7 datë 10.11.2023) dhe kjo vërtetuar me librin e protokollit të AdZM-së dhe me nenin 3 të saj, ku shprehet se vlera e kontratës paguhet brenda datës 10.11. të çdo viti kalendarik. Subjektit i është kërkuar rinovimi me Basenin Seman dhe bashkëlidhur vërtetimi nga DRT Berat, datë 28.07.2023 që nuk ka detyrime.

5. Kontrata me subjektin “E.” është zgjidhur, pasi subjekti nuk ka filluar punimet sipas projektit dhe plan biznesit, edhe pas kërkesës për rinovim nga ana e saj. Pas kësaj finalizohet zgjidhja e kontratës me njoftimin nr. 251/1 prot., datë 31.01.2024. Bashkëlidhur procesverbali i marrjes në dorëzim të sipërfaqes, datë 15.02.2024 dhe kërkesë padi në Gjykatën Administrative Lushnjë datë 05.11.2024 për vlerën e detyrimit të papaguar në shumën 588,021.6 lekë, vlerë e cila do të rishikohet edhe një herë me drejtorinë e financës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

Kërkesat për dokumentacionin që duhet të plotësojë personi fizik/juridik dhe procedura e shqyrtimit e vlerësimi i tyre nga AdZM dhe AKZM janë të përcaktuara në Udhëzimin nr.1, datë 10.02.2021.

1. Për subjektin “G.”, procesverbali i dorëzimit të territorit i dokumentuar në dosjen fizike rezultoi se është i pa firmosur nga një anëtar i grupit të punës (nga specialisti menaxhimi z. D. G), ndryshe nga ai i bashkëlidhur dhe paraqitur nga ana juaj, për këtë arsye pretendimi i subjektit

nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ndërsa merret në konsideratë pagesa e qirasë për vitin 2024.

2. Për subjektin “B.” shpk, përveç procesverbalit të dorëzimit të territorit datë 12.03.2024, nuk është paraqitur dokument tjetër që të vërtetojë pretendimet, për këtë arsye pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Për subjektin “B.” nuk është paraqitur dokument tjetër që të vërtetojë pretendimet, dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4. Për subjektin “O.” nuk është paraqitur dokument tjetër që të vërtetojë pretendimet, (kopje e librit të protokollit, vërtetimi nga DRT për pagesën e kontributeve për sig. shoq për punonjësit e punësuar, njoftimi i AdZM-së drejtuar subjektit për marrjen e lejes nga Baseni Seman etj), për këtë arsye pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

5. Për subjektin “E.” nuk është paraqitur dokument tjetër që të vërtetojë pretendimet, për këtë arsye pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

AdZM Kukës, ka lidhur gjithsej 9 kontrata me të ardhura nga qiratë në vlerë totale 7,841,942 lekë/vit përkatësisht: 7 kontrata me veprimtari ekonomike me vlerë qira vjetore 1,727,942 lekë dhe 2 HEC-e me vlerë qira vjetore 6.114,000 lekë. Kontratat e lidhura janë në zonë të mbrojtur mjedisore në Parkun Natyror “Korab-Koritnik”, ku 5 prej tyre janë shpallur me VKM paraprake në vitin 2011 dhe me VKM nr.60, datë 26.01.2022 Aneksi 2, Kategoria IV dhe ka Plan Menaxhimi të miratuar me Urdhër nr. 2029, datë 31.12.2014 të Ministrit të MTM-së dhe në PK “Alpet e Shqipërisë” ZM shpallur me VKM paraprake në vitin 1996 dhe me VKM nr.59, datë 26.01.2022 Aneksi 1, Kategoria II Park Kombëtar për të cilin është hartuar draft Plan Menaxhimi në vitin 2015, por pa finalizuar në plan menaxhimi.

Rezultoni 1 kontratë e përfunduar dhe 3 kontrata të zgjidhura, ku sipas evidencës për debitorët nga kontratat e qirasë (nga drejtoria financës) detyrimi është për 10 subjekte në vlerën 108,118,215 lekë.

6. Subjekti “H.” shpk me Nipt K.....H, me kërkesë datë 25.03.2022 me objekt: Kërkesë për rinovim me të njëjtat kushte “Dhënia në përdorim i territoreve me sipërfaqe 1865 m²” parcela nr.11a,14b,36c,38b, 39b, 43a, 5b, 6b, 6c, të ekonomisë pyjore “Bushtricë” brenda Parkut Natyror “Korab-Koritnik”, miratuar me Urdhër nr.897/1 prot., datë 01.03.2024 të Drejtorit të AKZM-së, sipas së cilës ka lidhur Kontratë me nr.111 prot., datë 13.3.2024 me afat 5-vjeçar me të drejtë rinovimi çdo vit, për sipërfaqen 1.865m² dhe vlerë 1,865,000 lekë/vit (me të njëjtat ngastra si në kontratën e mëparshme), lidhur midis drejtorit të AdZM Kukës z. L. Gj dhe administratorit të shoqërisë z. B. Gj, ku rezultoi:

-Kërkesë nga subjekti “F.” sh.p.k me shkresë nr.183 prot., datë 25.03.2022 për rinovim kontrate (Kontrata e mëparshme me nr.166 datë 28.03.2017 me sipërfaqe 0.821 ha, me afat 5 vjeçar (deri 27.03.2022) dhe vlerë 340,750 lekë/vit dhe Amendim Kontrate nr.169 prot., datë 31.08.2021, për ndryshim të tarifave vjetore në zbatim të VKM-së nr.1156, datë 24.12.2020, me investitor shoq. “HEC Tërfoja” sh.p.k, sipërmarrës shoq. “F.” sh.p.k dhe “B.” sh.p.k. *Subjekti nuk ka respektuar nenin 3 të kontratës ku palët njoftojnë të paktën 3 muaj para përfundimit të afatit.*

-Ekstrakti historik nga QKB nga subjekti “F.” shpk, administrator B. Gj. është paraqitur me periudhën 21.10.2024, nuk përkon me periudhën e kërkesës, mars 2022.

-Projekti teknik i zbatimit i HEC Tërfoja ka ndryshime në zërat e punimeve dhe nuk është përditësuar me një plan të ri rehabilitimi për sipërfaqen e kërkuar.

-Nuk është e konfirmuar Urdhër pagesa për janar 2024 për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për tatimin e mbajtur në burim.

-Plan Biznesi dhe analizë financiare, pa përcaktuar numrin e punonjësve, ndërsa në kontratën e mëparshme parashikuar minimalisht 5 punonjës;

-Mungon studimi nga AdZM.

-Mungon Memo nga Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit nga AKZM.

-Raporti tekniko-ekonomik, i rishikuar përmban ndryshime në sipërfaqen dhe përmasat e tubacionit, me sip.1865 m² dhe vlerë 1,865,000 lekë/vit, i cili kalon në disa parcela pyjore të ekonomisë pyjore Bushtricë. Matja e tubacionit në hyrje të godinës HEC tregon një diametër prej 1 m, por nuk janë paraqitur matjet e reja nga AdZM.

-Nga Akti i verifikimit nr. 74 prot., datë 16.02.2024, për 1865 m², nga grupi i punës AdZM deklarohet se janë kryer matje me GPS të gjatësisë së tubacionit, por nuk ka të dhëna për matjet e reja që vërtetojnë ndryshimet në gjatësi. Për më tepër, fletët 1 dhe 2 të Aktit të verifikimit kanë ndryshime në shkrim.

-Sipërfaqja 8510 m² ka të pasqyruar gjatësinë e tubacionit 2.95 km dhe sipërfaqen e godinës HEC, sipërfaqe e veprës së marrjes nr.1 dhe veprës së marrjes nr.2. Në raportin tekniko-ekonomik të rivlerësuar, nuk janë përfshirë veprat e marrjes dhe sipërfaqja e godinës si dhe ndryshimet në përmasat e tubacionit nga 2950 mlx1.2m² në 1865ml x1m²); për të cilat nuk janë paraqitur matjet reale të bëra nga grupi i AdZM (me GPS) dhe planimetria e rishikuar me koordinata gjeografike.

-Shkresa nr. 269/1 prot., datë 18.01.2024, e drejtorit të AKZM drejtuar drejtorit të AdZM, njofton miratimin në parim të raportit tekniko-ekonomik për HEC Tërfoja, me vlerë kontrate 8,210,000 lekë dhe kërkon që subjekti të plotësojë dokumentacionin sipas pikës 6.8 të Udhëzimit nr. 1, datë 10.02.2021. Në fakt, miratimi përfundimtar është bërë me Urdhër nr. 897/1 prot., datë 01.03.2024, nga Drejtori i AKZM-së, për sipërfaqen 1,865 m² dhe vlerën 1,865,000 lekë/vit (me të njëjtat ngastra si në kontratën e mëparshme).

- Proces verbal i dorëzimit të sipërfaqes zonë e mbrojtur datë 14.03.2024, e nënshkruar nga 2 prej 4 anëtarëve të përcaktuar në Urdhër nr.1, datë 09.01.2024 të drejtorit të AdZM-së (A.K dhe A. Xh) dhe 2 muaj para lidhjes së kontratës (datë 13.03.2024).

-Mungojnë Plan vendosja dhe koordinatat e ndryshuar nga ana e subjektit dhe koordinatat e matjes nga AdZM Kukës.

- Kontrata e mëparshme ka përfunduar më 27.03.2022, ndërsa kontrata pasuese ka hyrë në fuqi më 13.03.2024, duke lënë një periudhë shkëputjeje një vjeçare, pa informacion mbi bazën ligjore të funksionimit të subjektit gjatë kësaj periudhe.

7. Subjekti “S.” sh.pk. me Nipt J.....N, me kërkesë pa datë të subjektit kërkues, me protokoll nr.70 prot., datë 29.03.2021 të AdZM-së, për truall në Valbonë për ndërtimin e një strukture druri miratuar me Urdhër nr.116 datë 31.05.2021 të Drejtorit të AKZM, z. Z. D me objekt: “Agroturizëm” si qendër rekreacioni, pushime, argëtim shëndetësore dhe panairove për zhvillimin e turizmit pa çenuar vlerat natyrore të parkut” për sipërfaqen 2.2 ha, në zonën e mbrojtur PK “Lugina e Valbonës” pjesë e PK “Alpet e Shqipërisë”, ekonomia pyjore “Valbonë – Dragobi” parcela 50d, afati 10 vjet (miratuar nga MTM) me të drejtë rinovimi çdo vit.

Kontratë nr.124 prot., datë 12.06.2021 me afat 10-vjeçar (01.03.2022-28.02.2032) me të drejtë rinovimi me objekt: “Për përdorim sipërfaqen 2.2 ha fond pyjor publik, në zonë të mbrojtur PK “Lugina e Valbonës” Kategoria II, parcela 50d (nuk ka zonim)” dhe vlerë 220,000 lekë/vit, (llogaritur me VKM nr.391, datë 21.06.2021) lidhur midis drejtorit të AdZM Kukës z. D. S dhe administratorit të shoqërisë z. H. B.

-Amendim Kontrate nr.134 prot., datë 09.05.2022, i cili ka ndryshuar vlerën e qirasë në 416,280 lekë si pasojë e ndryshimeve ligjore të tarifave në VKM nr.1156 datë 24.12.2020 nënshkruar midis drejtorit të AdZM Kukës z. L. Gj. dhe administratorit z. H. B. Pagesa për shtator-dhjetor 2021 do jetë 258,226 lekë. Tabela e ri llogaritjes për sip. ndërtimi 640m²x500_llekë/m²/vit+sip objekte tregtie 21,360m²x6.5 lekë/m²/vit=416,120 lekë/vit.

-Ekstrakti i QKB paraqitet deri në tetor 2017. Sipas verifikimit në datë 02.02.2022, fusha e aktivitetit të kërkuar në QKB, pas afro një viti nga kërkesa e bërë në AdZM.

-Projekti teknik dhe planimetria nuk janë me firmë dixhitale të inxhinierit K. Xh.

-Ekonomia pyjore "Valbonë-Dragobi", ngastra 50/d, përfshin një kamping me sipërfaqe totale 2.22 ha, ku janë parashikuar ndërtime si shtëpi druri dhe bar-restorant. Projekti përfshin gjithashtu aktivitete si kënde lojërash dhe mbjellje fidanësh autoktonë, por nuk ka parashikuar vlera të specifikuar për rehabilitimin e terrenit.

-Plani për rehabilitimin e terrenit, i paraqitur nga ing. A H, pa firmë dixhitale dhe nuk është paraqitur licenca.

- Nuk janë administruar lejet e nevojshme nga organet përgjegjëse, të kërkuara nga AKZM (konfirmimin nga bashkia që aktiviteti është në përputhje me planin vendor të zhvillimit të territorit; leja e ndërtimit nga bashkia; mënyra e trajtimit të ujërave të ndotura dhe kanalizimit me rrjetin kryesor të zonës), si dhe plotësimi i dokumentacionit për plan vendosjen, projektin zhvillimor.

-Sipas Projektit teknik: Sip. ndërtimi 1200 m² dhe kënde lojërash etj., 20,800 m², të cilat të llogaritura me tarifat e përcaktuara në VKM nr. 1156, datë 20.12.2020, Lidhja nr.1 pika 3b/c del se vlera e qirasë vjetore është 735,200 lekë/vit (sipërfaqe ndërtimi 1200m²x500 lekë/m²/vit + sipërfaqe kënde lojërash etj., 20,800 m²x6.5 lekë/m²/vit).

Sipas kësaj llogaritje del se diferenca për t'u paguar për 4 vjet është 1,471,640 lekë (2,940,000 lekë-1,468,360 lekë që ka likuiduar).

-Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 2, 7, 7/1 i kontratës së qirasë.

8. Subjekti "Xh." person fizik me Nipt L.....T, me kërkesë datë 11.03.2022 me objekt: "Marrje në përdorim të një sipërfaqe zonë e mbrojtur brenda Parkut Natyror "Korab-Koritnik", Kontrata nr.157 prot., datë 01.06.2022 me afat 10 për sipërfaqe 0.25 ha lidhur midis drejtorit të AdZM Kukës z. L. Gj dhe znj. Xh. B. Më pas është bërë rishikimi i kontratës për shkak të gabimit në zonim, për të njëjtën sipërfaqe në vlerën 229.442 lekë miratuar me Urdhër nr.80, datë 08.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së dhe Kontratës nr.94 prot., datë 20.03.2023 (dhe fillon nga dita e lidhjes së kontratës së parë me nr. 157 datë 01.06.2022), ku rezultoi se:

-Nuk ka miratim nga MTM për lidhje kontratë qiraje me afat 10 vjet.

-Kërkesa e subjektit datë 09.12.2023 për spostimin dhe reflektimin në kontratë të koordinatave për objektin "Stani i Hoxhës".

-Raporti tekniko-ekonomik hartuar e miratuar nga AdZM: shpreh një gabimi teknik me zonimin e brendshëm, ku një pjesë e projektit pika 2,3,4,5 bien në ZQ (ndërsa në kontratë janë nënzona të përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm ZPT/Q) dhe pjesa tjetër në ZR, prandaj kërkohet rishikimi i zonimit të sip.

Janë bërë ndryshimet nga subjekti në raportin teknik, projektin, relacion arkitektonik, plan biznes, plan rehabilitim duke zhvendosur kufirin e sip. dhe të strukturave ndërtimore, jashtë nënzonës qëndrore dhe miratuar nga AdZM dhe AKZM, sipas matjes me GPS dhe është përdorur harta topografike e ortofotos viti 2015 për përcaktimin e koordinatave të reja.

-Plani i rehabilitimit, në projektin e studimit është paraqitur pa vlerë, ç'ka ndikon në përlllogaritjen e vlerës së qirasë vjetore.

-Plani i biznesit është gjithashtu i paraqitur jo nga një ekspert i fushës, gjë që i shton paqartësinë në lidhje me qëndrueshmërinë dhe planin e zhvillimit të veprimtarisë.

-Plani i vendosjes së strukturave është miratuar nga Bashkia Kukës.

-Nuk është kërkuar miratim paraprak për ushtrim veprimtarie nga organi brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore ku ushtrohet veprimtaria, në mos respektim të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të MTM-së pika 6.8 gërma "g".

-Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 2, 6/b, 7, 7/1,7/c, 9 të kontratës së qirasë.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi L. Gj Drejtor, znj.A. K me detyrë përgjegjëse e sektorit të menaxhimit nga data 22.10.2021 e në vazhdim.

AdZM Vlorë ka lidhur gjithsej 12 kontrata qiraje me të ardhura 2,907,386 lekë/vit për dhënie sipërfaqe të ndodhura në zonë të mbrojtur mjedisore “Syri i Kaltër” shpallur me VKM paraprake në vitin 1996 dhe me VKM nr.60, datë 26.01.2022 Aneksi 6, të detajuara: Kategoria IV Park Natyror për të cilin nuk ka Plan Menaxhimi (6 subjekte); në zonë të mbrojtur mjedisore RNM Karaburun shpallur me VKM paraprake viti 1977 dhe VKM nr.60, datë 26.01.2022 Aneksi 15, Kategoria IV Park Natyror (4 subjekte), për të cilin nuk ka Plan Menaxhimi; në zonë të mbrojtur mjedisore PK Butrint shpallur me VKM paraprake viti 2005, 2013 dhe VKM nr.59, datë 26.01.2022 Aneksi 3, Kategoria I Park Kombëtar (1 subjekt); në zonë të mbrojtur mjedisore PM Pishë Poro - Nartë Kategoria V shpallur me VKM paraprake viti 2004 dhe Vendim nr.596, datë 25.9.2024, Kategoria V Peizazh i Mbrojtur (1 subjekt) për të cilin nuk ka Plan Menaxhimi. Janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme 2 kontrata të cilat rezultojnë debitorë në vlerë 9,859,500 lekë dhe ndodhen në proces gjyqësor dhe ka përfunduar 1 kontratë.

Nga auditimi me përzgjedhje i 3 procedurave të lidhjes së kontratave të qirasë, rezultoi se nga ana e AdZM dhe AKZM nuk janë përmbushur kërkesat e specifikuara dhe afatet kohore përkatëse të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të MTM-së dhe të VKM-së nr.1156, datë 24.12.2020, konkretisht:

9. Subjekti “S.” person fizik me Nipt L.....K, me kërkesë, pa datë dhe me nr.2687 prot., datë 02.08.2023 të AdZM-së, me objekt: Kërkesë për rinovim kontrate “Për qëllime pushimi dhe argëtimi”, miratuar me Urdhër nr.21, datë 19.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së, me objekt: “Për menaxhimin e territorit për qëllime pushimi dhe argëtimi” për sipërfaqe 1500 m² me afat 10 vjeçar (me detyrim konfirmim çdo vit) në zonë të mbrojtur PM “Pishë-Poro Nartë”. Kontrata nr. 80/2 prot., datë 29.02.2024 me afat 10 vjeçar (2024-2034) dhe fillon nga data e dorëzimit të territorit me procesverbal për sipërfaqe 1500m² dhe vlerë 152,865 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Vlorë z. E. B dhe znj. S. S ku rezultoi se:

-Nuk ka miratim nga MTM, për lidhjen e kontratës me afat 10 vjeçar, në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021.

- Nga verifikimi i ekstraktit në QKB-së rezulton se aktiviteti ishte i pezulluar për periudhën nga 23.08.2023 deri më 16.10.2024, periudhë gjatë të cilit është bërë kërkesa e subjektit.

-Nuk ka vërtetim nga DRT për pagesën e kontributeve të sig. shoqërore dhe shëndetësore.

-Mungon studimi nga AdZM për zonën e mbrojtur, në kundërshtim me pikën 6.4 të Udhëzimit nr.1/2021, ku jepet përshkrim i hollësishëm i sipërfaqes së kërkuar, shoqëruar me informacion mbi bimësinë ekzistuese, si dhe me sipërfaqen ku do vendoset strukturat sipas aktiviteteve të paraqitura në projektin teknik, nga subjekti.

-Nuk ka konfirmim nga AKM nëse subjekti është objekt për pajisjen me leje mjedisi, por ka dorëzuar raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis nga ing. licencuar.

-Mungon miratimi paraprak për ushtrimin e veprimtarisë nga organi brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të cilët është veprimtaria.

-Mungon procesverbali i dorëzimit të territorit nga AdZM, në kundërshtim me nenin 6/a të kontratës.

-Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme, neni 6/a.7/a, 6/b, , 7/c, 7/1 dhe 9 të kontratës së qirasë.

10. Subjekti “F.” person fizik me Nipt K.....T, me kërkesë, pa datë të subjektit kërkuar dhe me nr.3690 prot., datë 30.10.2023 të AdZM me objekt: “Marrje në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur në Parkun Natyror “Syri i Kaltër” me sip. 750 m²”, miratuar me Urdhër nr.14, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM, znj. D. P nr. 207/1 prot., datë 12.01.2024, me afat 5 vjet dhe objekt: “Pikë shërbimesh turistike “Syri i Kaltër”.

Kontrata nr.536/1 prot., datë 18.01.2024 me afat 5vjeçar, me objekt: “Dhënia në përdorim e territoreve me sip 750m² në pasuritë me nr. 475,477, zona kadastral nr.2895 e ndodhur në PN Syri i Kaltër, sipas hartës, Aneksi A që i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj”. Afati fillon me datën e procesverbalit të marrjes në dorëzim të sipërfaqes 750m², fond pyjor

publik, dhe vlerë 234,352.5 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Vlorë z. E.B dhe administratorit të shoqërisë z. F. Gj.

-Relacioni teknik nga ing të licencuar përshkruan: Projekt zhvillimi në fshatin Krongj, Njësia Administrative Mesopotam, Bashkia Finiq, ka një sipërfaqe totale prej 750 m² dhe i ndarë në komponentë aktiviteti. Çështje e pazgjidhur është pozicionimi i sipërfaqes me status juridik shtetëror dhe privat, pa përcaktim të qartë në hartë. Mungon dokumentacioni për pronësinë, si certifikata e pronësisë, e cila është e domosdoshme për të konfirmuar ligjshmërinë e pronës dhe zhvillimin e projektit.

-Plani i rehabilitimit nuk ka analizën e grumbullimit të mbeturinave dhe prurjeve të ngurta dhe hidrike.

-Mungon Studimi nga AdZM, Shtojca A dhe B.

-Raporti teknik i miratuar nga drejtori i AdZM ku përcaktohen koordinatat sipas ndarjes së sipërfaqes, me vlerë të qirasë vjetore 234,352.5 lekë.

-Nuk ka konfirmim nga AKM nëse subjekti është objekt për pajisjen me leje mjedisi, por ka dorëzuar raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis nga ing. licencuar.

-Nuk ka miratim paraprak për ushtrimin e veprimtarisë nga organi brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore ku ushtrohet veprimtaria.

-Subjekti ka shkelur disa detyrime kontraktuale të rëndësishme 6/b, 7/1 dhe 9 të kontratës së qirasë.

11. Subjekti “K.” person fizik me Nipt L.....V, me kërkesë nr.218 prot., datë 25.06.2020 me objekt: “Për rehabilitimin e sipërfaqes së degraduar nëpërmjet mbjelljeve”, me afat 5 vjet në zonën e mbrojtur PK “Butrinti” i quajtur “Qafa e Mërtesë”, parcela nr.144 ekonomi pyjore “Bregdet”, Zona Kadastrale nr.2297. Urdhër nr. 131, datë 23.7.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm z. Z. D për miratimin e kontratës “Rehabilitim i sipërfaqes së degraduar nëpërmjet mbjelljeve dhe zhvillimin e veprimtarisë Agropylltari” në sipërfaqen 7 ha në zonën e mbrojtur PK “Butrinti” ekonomi pyjore “Bregdet”, parcela nr.144, afat 5 vjet me të drejtë rinovimi çdo vit.

Kontrata nr.273 prot., datë 27.7.2020 për sip. 70.000 m² (7ha), ngastra nr.144 zonimi.B. ekonomi pyjore “Bregdet” me objekt: “Për rehabilitim të sipërfaqes së degraduar nëpërmjet mbjelljeve” me afat 5 vjeçar, periudha nga 27.7.2020-27.07.2025, me të drejtë rinovimi dhe vlerë 91,000 lekë/vit, lidhur midis drejtorit të AdZM Vlorë znj. L. L dhe z. K. M.

Amendim Nr.1 për Kontratën nr.273 prot., datë 27.7.2020 për ndryshimin e vlerës së qirasë vjetore nga 91,000 lekë në 210,000 lekë/vit, si efekt i ndryshimit të tarifave me VKM nr.1156 datë 24.12.2020.

-Ekstrakti i regjistrimit në QKB - fusha e veprimtarisë: Restorant, bar kafe, akomodim shtëpi druri., nuk përputhet me aktivitetin që do të zhvillojë.

- Plan biznesi “Për rigjenerimin e zonave të degraduara dhe kthimin e tyre në zona të përshtatshme “Agropylltari” ku parashikohen shpenzime në vlerë 2,384,510 lekë nga kontabilist i miratuar A. Rumani (pa firmë dixhitale, pa paraqitur licenca).

- Raport tekniko-ekonomik për sip. e kërkuar 7 ha, ngastra nr.144 ekonomi pyjore “Bregdet” në ZM tek “PK Butrint” në ZR(B), ku jepen koordinatat bazuar në hartën dixhitale të gjeoreferuar SH1:10000 dhe kufijtë e përcaktuar, vlera 91,000 lekë (bimësi pyjore, in produktive 7 ha x 13,000 lekë/ha/vit) i miratuar nga drejtori i AdZM znj. L. L. Plan vendosje me koordinata ku shtrihet sip. e kërkuar SH1:10000.

- Shkresë nr. 219 prot., Urdhër nr.5 datë 25.06.2020 i drejtorit të AdZM-së për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesës.

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Sarandë shprehur se zona e kërkuar bën pjesë në Njësinë Strukturore KS.B.152 (Ksamil Bujqësor), ku përdorimi i tokës është Tokë Bujqësore dhe është i ndaluar ndërtimi, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim nr.3, datë 16.10.2017.

-Ndërsa ASHK Sarandë shprehet se, pasuria në ZK 2297- Pasuria 1/363 pyll me sip. 26822 m² është pronësi shtet; Pasuria nr.1/361 sip. rrugë 2304m², pasuria nr.1/315 pyll me sip 22189m²), e cila është marrë në konsideratë nga AdZM Vlorë për procedurën e lidhjes së kontratës së qirasë me subjektin kërkues.

- Memo datë 23.7.2020 nga drejtores e Drejtorisë Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit nga znj. A. P drejtuar drejtorit të AKZM z. Z. .D, ku shprehet se dokumentacioni është i plotë dhe jepet miratim për dhënie në përdorim të sip. 7 ha.

- Nuk është bërë rinovimi çdo vit i kontratës për zbatimin e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në urdhrin e drejtorit të përgjithshëm.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. L L ish/Drejtor nga datë 01.05.2015-12.09.2022, z. E. B ish/Drejtor, datë 06.10.2023-05.07.2024.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni datë 24.02.2025 protokolluar në KLSH me nr.1125/16 datë 26.02.2025, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar

1.Subjekti “S.” ka pasur kontratë të mëparshme; nuk ka ndryshuar koordinata dhe sip. është dorëzuar njëherë me pv. dorëzimi, datë 10.07.2013. Procedurat e rinovimit kanë filluar para emërimit tim në detyrë dhe si drejtues kam përcjellë dokumentacionin në AKZM dhe nënshkruar kontratën, pas urdhrin të drejtorit të përgjithshëm.

2.Subjekti “F.” ka pasur miratimin e studimit, i cili është kryer prej fillimit të vitit për dy subjekte që kanë lidhur kontratë tek “Syri i Kaltër”, ndërsa kontrata e mëparshme është lidhur nga paraardhësi. Si drejtues kam nënshkruar kontratën, pas urdhrin të drejtorit të përgjithshëm. Bashkëlidhur shkresa nr.2962 prot., datë 31.08.2023 të drejtorit të përgjithshëm për dorëzimin e dokumentacionit të subjektit dhe për vijimin e hartimit të raportit teknik dhe llogaritjes së vlerës së qirasë vjetore sipas akteve nënligjore; Urdhri nr.20, datë 05.09.2023 i drejtorit rajonal për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesës së subjektit; p.v i dorëzimit të sip. datë 10.07.2013 dhe MP e bankës për pagesën e qirasë vjetore 2024.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

1.Kontrata nr. 80/2 prot., datë 29.02.2024 me afat 10 vjeçar (2024-2034), për subjektin “S.”, fillon nga data e dorëzimit të territorit me procesverbal për sipërfaqen 1500 m², kështu që p.v. i dorëzimit jo vetëm është detyrim ligjor, por edhe kushtëzohet në kontratën e nënshkruar nga ana juaj. Dokumentacioni shqyrtohet dhe vlerësohet në drejtorinë rajonale, sipas pikës 6.8 të Udhëzimit nr.1 datë 10.2.2021 të Ministrisë të Mjedisit dhe më pas i përcillet drejtorisë së përgjithshme, prandaj kjo nuk ju shkarkon nga përgjegjësia si drejtues rajonal. Për këtë arsye nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Kontrata nr.536/1 prot., datë 18.01.2024, për subjektin “F.”, përpara nënshkrimit nga ana juaj, duhej të kishit verifikuar saktësinë e dokumentacionit të duhur ligjor sipas kërkesave të Udhëzimit nr.1 datë 10.2.2021 të Ministrisë të Mjedisit. Merret në konsideratë vetëm paraqitja e mandat pagesës së bankës, për vlerën e qirasë vjetore të vitit 2024 dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni datë 24.02.2025 protokolluar në KLSH me nr.1125/25 datë 13.03.2025, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar

-Urdhri nr.131 datë 23.07.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm z. Z. D për miratimin e kontratës “Rehabilitim i sipërfaqes së degraduar nëpërmjet mbjelljeve dhe zhvillimin e veprimtarisë Agropylltari” subjekti “ K.” në sipërfaqen 7 ha në zonën e mbrojtur PK “Butrinti” ekonomi pyjore “Bregdet”, parcela nr.144, afat 1 vit me të drejtë rinovimi deri në 5 vite është lapsus dhe

një kopje kontrate është depozituar në AKZM dhe procedura tekniko-ligjore parashikon përdorimin e sip. për 5 vjet dhe kontratë nuk shpreh rinovim çdo vit dhe se periudha 2020 është audituar nga KLSH

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

Rregullat dhe procedurat për shqyrtimin, vlerësimin e dokumentacionit, nënshkrimin e kontratës dhe zbatimin e saj janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 10.02.2021 dhe në VKM-në nr. 1156, datë 24.12.2020 të MTM-së. Auditimi nga ana jonë është realizuar në përputhje me këto akte ligjore, duke u mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana juaj.

Në lidhje rinovimin çdo vit të kontratës, shprehur nga ana jonë, i jemi referuar Urdhrit nr.131 datë 23.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm z. Z D, të cilin ju e cilësoni lapsus, i cili duhej të ishte rishikuar nga ana juaj para lidhjes së saj. Po ashtu, nga përzgjedhja për auditimin e rregullshmërisë së lidhjes së kontratave të qirasë, është përzgjedhur kjo kontratë, e cila ka afat nga 23.07.2020 deri 23.07.2025 dhe mbulon periudhën e auditimit nga grupi i auditimit të KLSH-së. Nuk është paraqitur dokument tjetër që të vërtetojë pretendimet, për këtë arsye pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë dhe do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni datë 24.02.2025 protokolluar në KLSH me nr.1125/14 datë 23.12.2024, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar

Subjekti "S." ka paraqitur kërkesë për rinovim me nr.2687 prot., datë 02.08.2023.

Nga drejtoria e menaxhimit në qendër nuk ka pasur kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Pas miratimit nga AdZM Vlorë dhe me shkresë nr.2962 prot., datë 31.08.2023 të AKZM-së është vijuar me lidhjen e kontratës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

Kontrata e rinovuar bëhet sipas kushteve përkatëse të përcaktuar në vet kontratën tip, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së, prandaj konstatimet do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raportin Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacioni datë 24.02.2025 protokolluar në KLSH me nr.1125/19 datë 10.03.2025, për të cilin japim sqarimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit të audituar

Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur citimet nga Projekt Raporti si dhe Urdhrin e titullarit për fillim marrje masash në lidhje me rekomandimet e lëna në këtë fazë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se:

Dokumentacioni shoqërues është i njëjti me atë të sjellë në fazën e Projekt Raportit të Auditimit. Nuk janë paraqitur dokumente të tjerë vërtetuese që të kundërshtojnë problematikat e konstatuara, prandaj do të paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.4. Mbi auditimin e procedurave të prokurimit të fondeve publike.

Programi i nevojave për përgatitjen e regjistrit të prokurimeve, nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo plani të investimeve të parashikuara për vitet 2021-2024. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, për punën, shërbime, mallra etj., të cilat janë të miratuara nga Titullari i institucionit sipas viteve përkatëse.

Gjatë verifikimit të shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së pasi u njoh me bazën ligjore në të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në

metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës edhe ato elektronike marrë nga sistemi i SPE u konstatuan shkelje të akteve ligjore nënligjore të ligjit të prokurimit publik. Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (regjistri i parashikimit dhe realizimit), që janë dorëzuar në APP, brenda afateve të përcaktuara në ligjin e prokurimit publik dhe miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Për periudhën e auditimit 01.04.2021-30.09.2024, janë kryer;

- 18 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit 396,467,122 lekë pa t.v.sh dhe realizuar në vlerën 359,363,616 lekë pa t.v.sh ose me diferencë të fondit limit 37,103, 475 lekë ose realizuar 90% e fondit limit. Për vitin 2024 nga 6 procedura prokurimi 2 prej tyre kanë përfunduar pas periudhës së auditimit (30 shtator 2024).

Tabela nr.1 Prokurimet publike me vlerë të lartë për periudhën 01,04,2021-30,09,2024 në lekë

Nr	Viti	Nr.procedurë prokurimi	Fondi limit pa t.v.sh	Realizimi pa t.v.sh	Dif fond limit -realizim	Në%
1	01,04,2021-31,12,2021	2	35,931,593	32,786,839	3,144,754	91
2	2022	6	106,747,095	92,556,590	14,190,505	87
3	2023	4	145,288,434	139,230,355	6,058,078	96
4	Janr -30,09,2024	6	108,500,000	94,789,832	13,710,138	87
	Gjithsej	18	396,467,122	359,363,616	37,103,475	90

Burimi i të dhënave AKZM punuar grupi i auditimit KLSH.

Për periudhën 01.04.2021-31.12.2021, janë realizuar në total **2** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit **35,931,593.93** lekë pa t.v.sh dhe realizuar në vlerë **32,786,839** lekë pa t.v.sh, me një diferencë në vlerën **3,144,754** lekë pa t.v.sh ose **8.76%**, e fondit limit.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë realizuar në total **6** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit **106,747,095** lekë pa t.v.sh dhe vlerë **92,556,589** lekë pa t.v.sh, me një diferencë në vlerën **14,190,505.46** lekë pa t.v.sh ose **13.3%**.

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, janë realizuar në total **4** procedura prokurimi me vlerë të mëdha, me fond limit **145,288,433.7** lekë pa t.v.sh dhe vlerë kontrate **139,230,355.34** lekë pa t.v.sh, me një diferencë në vlerën **6,058,078.36** lekë pa t.v.sh ose **4.17 %**.

Për periudhën 01.01.2024-30.09.2024, janë realizuar në total **6** procedura prokurimi me vlerë të mëdha, me fond limit **108,500,000** lekë pa t.v.sh dhe vlerë kontrate **94,789,832.05** lekë pa t.v.sh, me një diferencë në vlerën **13,710,137.95** lekë pa t.v.sh ose **13%**.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën gjithsej **8** proceduara nga të cilat **6** mbi kufirin e lartë monetar dhe **2** procedura nën kufirin monetar, nga të cilat rezultoi si më poshtë:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje Fidanësh”**, realizuar në vitin 2021, u konstatuan disa parregullsi si vijon:

Nga auditimi i kësaj procedure u evidentua se nga AK, ka përdorur procedurën e prokurimit **“Mallra”**, me fond limit **12,500,000** lekë pa T.V.SH, vënë në dispozicion Buxheti i Shtetit, shpallur fitues Operatori Ekonomik **“A.”** Shpk, me ofertën **9,375,000** lekë pa T.v.sh.

Të dhënat e përmbledhura të procedurës:

Procedura me objekt: “Blerje fidanësh“ viti 2021		
1.Urdhër Prokurimi	2. Njësia e Prokurimit:	3.Komisioni Vlerësimit të Ofertave:
Urdhër nr. 226, datë 13	1.G. C (Juriste) 2.N. H (Inxhinier) 3.S. Xh (Inxhinier)	Urdhër nr. 227, date 15.10.2021 1.V. D (Kryetar) 2.D. S. (Anëtar) 3.S. B. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur Punë”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 12,500,000 (dymbëdhjetë milion pesëqind mijë) lekë pa T.V.SH.	6.Oferta fituese: “A.” Vlera 9,375,000 lekë pa T.v.sh	7.Diferenca me fondin limit 3,125,000 lekë (pa T.v.sh)

8. Data e hapjes së tenderit: 04.11.2021 ora 12:00	9. Burimi Financimit: Të ardhurat Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) S'kualifikuar : 1 c) Kualifikuar; 2 OE
11. Ankimime AK. S'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK. S'ka	Autoriteti Kontraktor AKZM Titullar Ish Drejtor Z. D

a. Në lidhje me llogaritjen e fondit limit;

Sa i përket llogaritjes së fondit limit u evidentua se për procedurën objekt prokurimi, është ngritur grupi i punës me urdhër nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, nr. 165 datë 07.09.2021, Komisioni i përbërë nga I. V, F. N dhe N. H. Nga Grupi i ngritur për justifikimin e fondit limit për specifikimet teknike financiare u morën në konsideratë ofertat nga tre subjekte. Nga llogaritja e mesatares së ofertave të paraqitura u evidentuan shumat e fondit limit si në tabelë, por të pa detajuara.

Emri i Ofertuesit	Vlera e Ofertës
Gj.	12,500,000
Gj.	12,502,500 (E Pavlefshme)
A.	12,494,500
Totali dhe mesatarja ofertave	37,497,000 / 3 = 12,500,000

Nga verifikimi i ofertave rezulton se subjekti P.F “Gj.”, nuk ka fushën e veprimtarisë së objektit të prokuruar, por ka në objekt veprimtarie: *“Tregti me pakice të artikujve të ndryshëm kancelarie, detergjente, elektrike, pajisje zyrash, bojëra printerësh dhe pajisjeve hidraulike. Mirëmbajtje faqe interneti. Tregti me pakicë të pjesëve hidraulike, elektrike, organizime eventesh, fletëpalosje. Tregti me pakicë të vajrave, gomave dhe bateri për automjete. Sigurim makinash, objektesh dhe shëndeti. katering, salla eventesh me qira, bileta avioni, shërbim transporti, detergjente pastrimi dhe fikse zjarri”*. Pra referuar ekstraktit në QKB, konstatohet se nuk tregton mallrat objekt prokurimi dhe rrjedhimisht hartimi i fondit limit është i pasaktë dhe i pavlefshëm. Veprime në kundërshtim me nenin 35, të Ligjit nr.162 /2020 të *“Prokurimit Publik”*, i ndryshuar dhe nenit 76 *“Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”* të VKM 285, datë 19.5.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, ç’ka ngarkon me përgjegjësi grupin e përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga I. V, F. N dhe N. H.

b. Hartimi i Dokumenteve Standarde të tenderit.

Në zbatim të nenit Neni 77, të VKM-së, 285, datë 19.5.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ish Drejtori i Përgjithshëm Z. D, është hartuar Urdhri i prokurimit nr.226, datë 15.10.202, duke përcaktuar; objektin e prokurimit; *“B.”* me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh. Njësia e prokurimit e përbërë nga G. C, N. H dhe S. Xh. Nga Njësia e Prokurimit u konstatua se në kërkesat teknike në DST ka vendosur kriteret të pa argumentuara mjaftueshëm ligjrisht dhe teknikisht. Në pikën **2.3.3** të DT, kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, *duhet të këtë pjesë të stafit teknik në licencë të shoqërisë dhe të punësuar për një periudhë Qershor 2020 (ndryshuar me shtojcë Qershor 2021) deri në Shtator 2021, 1 (një) Agronom dhe 1 (një) Inxhinier pyjesh.* Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Kontratat e punës, Diploma. *Sa më sipër konstatohet se ky kriter kualifikues (2.3.3), nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit (Blerje Mallrash), duke larguar në mënyrë të padrejtë nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomike tregtare dhe duke favorizuar drejtpërdrejtë OE që disponojnë licencë shoqërie për punime ndërtimi apo jo të përcaktuara sipas DT.*

Kufizimi gjithashtu vazhdon në pjesën ku citohet se të punësuar për një periudhë *Qershor 2021 - deri në Shtator 2021*, pasi në respektim të parimeve të LPP, nuk është kërkuar as marrëveshje punësimi apo kontraktimi në mënyrë që të nxitej konkurrenca.

Sa konstatuar më sipër, me kriteret të cilat kanë zvogëluar në mënyrë shumë të ndjeshme konkurrencën, bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, **neni 2** ku përcaktohet: *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën*

ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; Neni 3 pika 2 e LPP "Parime të përgjithshme" ku citohet: "Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar". Në kundërshtim me VKM 285, datë 19.5.2021, neni 78 pika 1 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet: "Dokumentet e tenderit hartohen nga njëسيا e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njëسيا e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës". Për shkeljet të dispozitave ligjore mban përgjegjësi njëسيا e prokurimit e përbërë nga G. C, N. H dhe S. Xh.

c. Vlerësimi i ofertave

Nga verifikimi në sistemin e APP rezultuan operatorët me oferta ekonomike si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta pa t.v.sh
1	A.	9,375,000
2	Xh.	11,097,000
3	B.	0

KVO e përbërë nga tre anëtarë, në përfundim të procesit të shqyrtimit në sistem, të dokumentacionit tekniko ligjor pas vlerësimit në sistem më datë 19.10.2021, ka hartuar procesverbalin mbi klasifikimin e operatorëve duke kualifikuar operatorët ekonomik të suksesshëm si më poshtë;

- "A." Shpk me ofertë ekonomike 9,375,000 lekë pa t.v.sh.
- "Xh." me ofertë ekonomike 11,097,000 lekë pa t.v.sh.
- Të s'kualifikojë Operatorin Ekonomik "B." shpk me ofertë ekonomike 0 lekë pa t.v.sh, për arsye se nuk rezulton të ketë dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve asnjë nga dokumentet e kërkuara në DST. KVO ka kualifikuar OE "A." shpk dhe "Xh." shpk, ku ka shpallur të suksesshme me çmim më të ulët "A." Shpk, me vlerë 9,375,000 lekë pa t.v.sh. Për procesin e vlerësimit nuk ka pasur ankimime dhe nga AK, janë respektuar afatet ligjore të ankimimit. Nga auditimi i dosjes së prokurimit rezulton se për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankimime ndaj AK dhe as ndaj KPP. Nga auditimi i dokumenteve të OE të shpallur fitues "A." shpk, konstatohet se nuk disponon asnjë licencë të stafit teknik siç kërkohet në DT. Ndërsa OE i kualifikuar "Xh." shpk konstatohet se ka hedhur në SPE formularët e vetë deklaramit dhe ofertën ekonomike dhe asnjë kërkesë tjetër të kërkuar në Dokumentet e Tenderit. Sa më sipër sipas ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1 përcakton se "Autoriteti ose enti Kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme". Pika 2. "Autoriteti ose enti Kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti Kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të s'kualifikohet". Së dyti, sipas neni 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 përcakton se "....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit". Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 75 "Komisioni i Vlerësimit të Ofertave"; pika 4, citohet se

“Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Për shkeljet të dispozitave ligjore mban përgjegjësi KVO e përbërë nga V. D., D. S dhe S. B.

Konkluzion: Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit me objekt “Blerje Fidanësh” konstatohet se në lidhje me llogaritjen e fondit limit, grupi i ngritur ka marrë oferta financiare nga tre subjekte duke mesatarizuar ato. Nga verifikimi i ofertave rezulton se, subjekti P.F “Gj.”, nuk ka fushën e veprimtarisë së objektit të prokuruar, por ka në objekt veprimtarie; “Tregti me pakicë të artikujve të ndryshëm kancelarie, detergjente, elektrike, pajisje zyresh, bojëra printerësh dhe pajisjeve hidraulike. Mirëmbajtje faqe interneti. Tregti me pakicë të pjesëve hidraulike, elektrike, organizime eventesh, fletëpalosje. Tregti me pakicë të vajrave, gomave dhe bateri për automjete. Sigurim makinash, objektesh dhe shëndeti. Katering, salla eventesh me qira, bileta avioni, shërbim transporti, detergjente pastrimi dhe fikse zjarri”. Pra referuar ekstraktit të këtij personi fizik në QKB, konstatohet se nuk tregton mallrat e objekt prokurimit dhe rrjedhimisht hartimi i fondit limit është i pasaktë dhe i pavlefshëm. Veprime në kundërshtim me nenin 35, të Ligjit nr.162 /2020 të “Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe nenit 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” të VKM 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Njësia e Prokurimit: u konstatua se në kërkesat teknike në DST ka vendosur kriteret të pa argumentuara mjaftueshëm ligjorisht dhe teknikisht. Në pikën 2.3.3 të DT, kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë pjesë të stafit teknik në licence të shoqërisë dhe të punësuar për një periudhë Qershor 2020 (ndryshuar me shtojcë Qershor 2021) deri në Shtator 2021 1 (një) Agronom dhe 1 (një) Inxhinier pyjesh. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Kontratat e punës, Diploma. Sa më sipër konstatohet se ky kriter kualifikues (2.3.3), nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit (Blerje Mallrash), duke larguar në mënyrë të padrejtë nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomike tregtare. Kufizimi gjithashtu vazhdon në pjesën ku citohet se të punësuar për një periudhë Qershor 2021 deri në Shtator 2021, pasi në respektim të parimeve të LPP, nuk është kërkuar as marrëveshje punësimi apo kontraktimi në mënyrë që të nxitej konkurrenca. Sa konstatuar më sipër, me kriteret të cilat kanë zvogëluar në mënyrë shumë të ndjeshme konkurrencën, bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 2 dhe në kundërshtim me VKM 285, datë 19.5.2021, neni 78 pika 1 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

- Në lidhje me vlerësim e ofertave KVO ka kualifikuar OE “A.” shpk dhe “Xh.” shpk, ku ka shpallur të suksesshme me çmim më të ulët “A.” Shpk, me vlerë 9,375,000 lekë pa t.v.sh. Nga auditimi i dokumenteve të OE të shpallur fitues “A.” shpk, konstatohet se nuk disponon asnjë licencë të stafit teknik siç kërkohet në DT. Ndërsa OE i kualifikuar “X.” shpk konstatohet se ka hedhur në SPE formularët e vetë deklaramit dhe ofertën ekonomike dhe asnjë kërkesë tjetër të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Procedura me objekt: “Hartime Plane të Integruara të Menaxhimit, ndarë në lote si vijon”:

2.1. Loti I Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh; REF-05203-05-17-2024;

2.2 Loti II Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8”, me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh, REF-05223-05-17-2024;

Procedura me objekt: Loti I Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022,		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 183, datë 03.05.2024	2.Njësia e Prokurimit:	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave:

Grupi i hartimit të termave referencës Nr. 1540/1 prot., datë 25.04.2024 H. C. S. B. K. U. Grupi i hartimit të fondit limit Nr. 1540/2 prot., datë 25.04.2024 Y. P. S. B. F. K.	1. A. M., Jurist 2. G. C., Juriste 3. F. K., specialist menaxh.	1.J. S.(Kryetar) 2.S. Xh. (Anetar) 3.A. C.(Anetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur – Shërbim”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh)	6.Oferta fituese:	7.Diferenca me fondin limit
Loti I Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh.	Vlera 11,200,000 lek pa T.v.sh “I.” shpk	1,300,000 lekë (pa T.v.sh)
8. Data e hapjes së tenderit: 04.06.2024 ora 10:00	9. Burimi Financimit: Të ardhurat	10.Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës në tender:2 b)S’kualifikuar : 1 c) Kualifikuar; 1
11. Ankimime AK. S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK. Ska	Titullari I AK D. P.

a. Hartimi i fondit limit,

Sa i përket llogaritjes së fondit limit u evidentua se, për procedurën objekt prokurimi, nga Grupi i ngritur për justifikimin e fondit limit për Hartim Plane të Integruara të Menaxhimit, ndarë në lote, nuk është kërkuar në ofertat e tregut me analizë të koston për këtë shërbim. Ndërkohë që duke iu referuar Termave të Referencës zërat e koston janë të përbëra nga Kosto ekspertësh, kosto administrative dhe kosto aktivitetesh. Titullari i AK i komanduar D. P, për përllogaritjen e fondit limit u ka kërkuar ofertë ekonomike për të dy lotet operatorëve ekonomikë si më poshtë:

Me shkresën nr. 1591 prot., datë 30.04.2024, OE “I.” Shpk; Me shkresën nr. 1591/1 prot., datë 30.04.2024, OE “F.” Shpk; Me shkresën nr. 1591/2 prot., datë 30.04.2024, OE “E.” Shpk;

- Operatori “I.” Shpk me shkresë nr. 1591/3 prot. datë 02.05.2024 jep ofertën e tij si më poshtë; **Loti I** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, me vlerë 12,000,000 lekë pa t.v.sh; **Loti II** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8”, me vlerë 12,000,000 lekë pa t.v.sh.

- Operatori “F.” Shpk me shkresë nr. 1591/4 prot. datë 02.05.2024 jep ofertën e tij si më poshtë; **Loti I** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, me vlerë 13,500,000 lekë pa t.v.sh; **Loti II** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8”, me vlerë 13,500,000 lekë pa t.v.sh.

- Operatori “E.” Shpk me shkresë nr. 1591/5 prot. Datë 02.05.2024 jep ofertën e tij si më poshtë; **Loti I** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, me vlerë 12,000,000 lekë pa t.v.sh; **Loti II** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8”, me vlerë 12,000,000 lekë pa t.v.sh.

Me procesverbal nr. 1591/6 datë prot., datë 02.05.2024, grupi i përllogaritjes së fondit limit ka realizuar mesataren e ofertave bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76 pika1/b. Nga verifikimi i ekstrakteve në QKB, konstatohet se asnjë nga këta ofertues, kanë fushën e veprimtarisë kryesisht për projekte inxhinierie dhe mbikëqyrje kolaudime dhe nuk disponojnë në kohën e studimit të tregut, ekspertët për hartimin e ofertave të sakta për përllogaritjen e fondit limit. Me Urdhrin e Prokurimi të titullarit AK D. P Nr. 183, date 03.05.2024, urdhërohet të realizohen procedurat për 2 lotet dhe lloji i procedurës është përcaktuar “Procedurë e Hapur - shërbime” bazuar në nenin 47 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

b. Hartimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit DST (Njëjtë për të dy Lotet).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nga Titullari i Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me urdhër nr.170 datë 25.04.2024, është ngritur grupi i punës “Për hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit” KHD, im cili ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën.

- **Loti I** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh.

- **Loti II** Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit sipas VKM-së nr.59, datë 26.01.2022 referuar nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Termat e Referencës për Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, janë hartuar nga subjekti i kontraktuar; BOE: “I.” sh.p.k & “K.” dhe të aprovuara nga Titullari i AK. Grupi i punës së KHD, për vendosjen e kërkesave për stafin e kualifikuar është referuar dhe bazuar në kërkesat e pikës 4.1. Profilet e Ekspertëve, kushtet dhe detyrimet, të termave të referencës, hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 41, pika 4. Procedura është përcaktuar “E hapur” dhe në zbatim të pikës 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit në DST është përcaktuar sa më poshtë vijon:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto, Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	50
2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë	pikët	10
3. Metodologjia e propozuar	pikët	20
4. Eksperienca e Stafit Teknik te Propozuar	pikët	20
Udhëheqësi i grupit (Planifikues Urban)	pikët	6
Ekspert Biolog	pikët	3
<u>Ekspert Inxhinier Pyjesh</u>	<u>pikët</u>	<u>2</u>
<u>Ekspert Turizmi</u>	<u>pikët</u>	<u>2</u>
Ekspert Sociolog	pikët	1
Ekonomist	pikët	1
Inxhinier/ Ekspert Mjedisor	pikët	1
Ekspert GIS	pikët	1
<u>Ekspert Ligjor</u>	<u>pikët</u>	<u>1</u>
Ekspert Agronom	pikët	1
Hidrogeolog	pikët	1

Ky nen kriter (4), garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit kontratës nga kontraktori, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme në të cilat ka qenë angazhuar stafi kyç i propozuar nga kompania demonstron aftësinë teknike dhe profesionale të personave që do të angazhohen gjatë zbatimit të shërbimit dhe garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktorin nuk e vë përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik për t’u vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyç të propozuar. Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8 (Kriteret e përgjithshme dhe veçanta kualifikuese), pika 2.3.2. Nga AK përcaktohet se Kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, peshat e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. **Pika 1. Çmimi [0-50] pikë.**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij. Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = V \min k1 \times P \max k1 / Ok1$

Referuar kushteve të veçanta kualifikuese pika 2.3.2, ku kërkohet “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, ose të kontraktuar për objektin e procedurës”.

A. Stafi kryesor

Ekspertët e stafit kryesor duhet të ushtrojnë detyrat si në vijim:

Udhëheqësi i Grupit (Planifikues Urban)

Duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive: Diploma Master Shkencor në Arkitekturë/Planifikim territori/Urbanist. Licencë profesionale/certifikate në planifikim (ose dokumente të tjera të ngjashme sipas vendit të origjinës). Të paktën 5 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme: eksperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Evropian; CV, në të cilën të theksohet eksperiencia në projekte të ngjashme. Roli i Koordinatorit të Projektit mund të mbulohet edhe nga një prej anëtarëve të propozuar të Stafit Kryesor. Vlerësimi i Koordinatorit të Projektit do të bëhet bazuar në aftësitë e tij menaxheriale si dhe në eksperiencat e tij e mëparshme në menaxhim.

Ekspert Biolog

Diploma Master Shkencor në Biologji Mjedis. Të paktën 3 vite eksperiencë pune në studime/projekte. Eksperiencë lokale, eksperiencë rajonale ose në vendet e Bashkimit Evropian; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert Inxhinier Pyjesh

Diploma Master Shkencor në Inxhinieri Pyjesh, Licencë profesionale/certifikatë në fushën e pyjeve dhe kullotave. Të paktën 3 vite eksperiencë pune në studime/projekte. Eksperiencë lokale, eksperiencë rajonale ose në vendet e Bashkimit Evropian; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert Turizmi

Diploma Master Shkencor në Shkenca shoqërore/Marketing/Turizëm;

Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet të lidhura me turizmin; eksperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Evropian. CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert Sociolog

Diploma Master Shkencor në Sociologji; Certifikatë (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës); Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekonomist

Diploma Master Shkencor në Ekonomi (profili urban/planifikim i para pëlqyeshëm). Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në çështje të lidhura me planifikimin/ekonominë; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Inxhinier/ Ekspert Mjedisor

Diploma Master Shkencor në fusha të lidhura me mjedisin; licencë profesionale/certifikate për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore. Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në çështje të lidhura me mjedisin; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert GIS

Diploma Master Shkencor në fusha të lidhura me sistemin GIS; Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në çështje të lidhura me mbledhjen e grumbullimin e të dhënave dhe përditësimin e informacioneve; CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

B. Stafi mbështetës

Për të siguruar një produkt që plotëson kërkesat e Termave të Referencë, përveç ekspertëve të stafit kryesor, duhet të përfshihen në ekipin e Ofruesit të shërbimit edhe ekspertët e mëposhtëm:

Ekspert Ligjor

Diplomë / licencë profesionale; Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në drejtimin ligjor. CV, në të cilën të theksohen projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert Agronom

Diplomë / licencë profesionale; Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme, CV, në të cilën të theksohen projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Hidrogeolog

Diplomë/licencë profesionale; Të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme. CV, në të cilën të theksohen projekte apo përgjegjësi të ngjashme. Konsulentët duhet të dinë se identifikimi i stafit mbështetës përmes CV, diplomave, licencimeve dhe dokumenteve të tjera relevante, do të ndikojë në vlerësimin e Operatorit Ekonomik fitues. Në çdo rast, në nënshkrimin e kontratës, Ofruesi i shërbimit duhet të ketë identifikuar të gjithë anëtarët e ekipit. Përmbledhja e stafit duhet të jap të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të jenë të angazhuar për të kryer secilën detyrë dhe kohën që secili prej tyre do të shpenzojë në hartimin e planit të integruar të menaxhimit relevante, do të ndikojë në vlerësimin e Operatorit Ekonomik. Në çdo rast, në nënshkrimin e kontratës, Operatori Ekonomik duhet të ketë identifikuar të gjithë anëtarët e ekipit.

Kriteri 2.3.2 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DT.

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë sipas pikës 4.4 në Njoftimin e Kontratës, operatorët të ngarkojnë në SPE dokumentacionin: CV, diploma, licencime dhe dokumenteve të tjera relevante.

C1.1 Mbi vlerësimin e ofertave (Për të dy Lotet)

Me procesverbalin nr.1 nr.1815/1 prot., datë 04.06.2024 të KVO, konstatohen ofertat ekonomike si më poshtë;

1. Për Lotin I Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për “Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh; REF-05203-05-17-2024;

1. “I.” shpk, me vlerë 11,200,000 lekë pa T.v.sh,
2. BOE “T.” & “A.” me vlerë 10,600,000 lekë pa T.v.sh

Me procesverbalin nr. 2 nr. 1815/3 prot., datë 06.06.2024 të KVO, shqyrtohen dhe vlerësohen ofertat ekonomike si më poshtë:

Nga KVO s’kualifikohet Operatori Ekonomik, BOE “T.” & “A.”, pasi nuk përmbush pikën 2.3, të Kriteve të veçanta në DST, për arsye se:

Për stafin kryesor:

a- Për Ekspertin Inxhinier Pyjesh Dh. P, mungon CV e tij, në të cilin të theksohen eksperiencat në projekte apo përgjegjësi të ngjashme. Për këtë arsye është i pa evidentueshëm numri i viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar.

b- Për Ekspertin e Turizmit, A. G mungon dokumenti i njohjes dhe njësimit e kualifikimit akademik nga Ministria e Arsimit Shqiptar, pasi ka depozituar vetëm dokumentin (fotokopje) të Master of Arts (in Tourism Menagement), si dhe nga CV nuk përmbush kriterin e viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar;

c- Për ekspertin Ligjor E. A, nuk përmbush kriterin e viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar, sipas CV së paraqitur. KVO kualifikon vetëm operatorin ekonomik “I.” shpk dhe vazhdon vlerësimin me pikë sipas kërkesave të pikës **4.4** “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të DST, i cili përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në kërkesat për kualifikim.

Vlerësimet teknike të KVO, paraqiten si në tabelën vijon:

OE infratech shpk	Sasia e pikëve mesatare	Argumentimi nga anetaret e KVO
Eksperiencia te ngjashme	10	Për pikëzimin e eksperiencave të ngjashme të operatorit ekonomik prioritet do t'i jepet kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit edhe studime në fushën e Operatori ekonomik I..... ka dorëzuar dokumentacion që tregon për përvoja pune të ngjashme të suksesshme duke e plotësuar këtë kriter. OE ka dorëzuar disa projekte të realizuara kryesisht me institucione Qendrore Shtetërore, disa prej të cilave konsistojnë në projektme dhe studime urbane, dhe vetëm kontrata me objekt: "Studim i lagunave", është kontratë e ngjashme me objektin e prokurimit. Për arsye se nuk ka patur OE tjetër të suksesshëm për këtë procedurë prokurimi bie poshtë llogaritja e pikëve sipas metodologjisë/formulës të përcaktuar në DST.
Metodologjia e propozuar	15	Metodologjia e propozuar nga operatori ekonomik I.....në të përgjithshmen i është përmbajtur kërkesave dhe detyrave të paraqitura në TOR, duke përshkruar secilin nga pikat që duhet të përmbajë një dokument plan menaxhimi. Gjithashtu në metodologjinë e propozuar janë përshkruar aktivitetet që do të ndërmerren
Stafi teknik	18	Operatori Ekonomik ka përshkruar strukturën dhe përmbajtjen e stafit kryesor të propozuar dhe stafin mbështetës, sipas kriterëve të kërkuara. Nga vlerësimi i stafit kryesor dhe atij mbështetës rezulton se OE ka kualifikimet e nevojshme për të realizuar shërbimin e kërkuar objekt kontrate.
Totali Pikëve	43	

Nga Vlerësimi i kryer nga KVO, rezulton që për përshkrim të vlerësimit për eksperiencat e ngjashme etj, është dhënë maksimumi i pikëve kjo; *Për arsye se nuk ka patur OE tjetër të suksesshëm për këtë procedurë prokurimi bie poshtë llogaritja e pikëve sipas metodologjisë/formulës të përcaktuar në DST.* Kriteret e përzgjedhjes së fituesit "I." shpk, me pikë dhe vlerësimi përkatës jepen në tabelën që vijon:

Nr	Sipas kërkesave në Kriteret e DST	Pikët Maksimale	Vlerësimi i Kryer me pikë
1	Çmimi	50	50
2	Eksperiencia e ngjashme e kompanisë	10	10
3	Metodologjia e propozuar	20	15
4	Eksperiencia e Stafit Teknik te Propozuar	20	18
	Total	100	93

Ofertat ekonomike janë paraqitur si më poshtë vijon;

Për arsyet të s'kualifikimit së subjektit B.O.E "A." sh.p.k & "T." sh.p.k, nga KVO është propozuar pranë Titullarit të AK, fituesi për objektin e tenderit **Loti I** "Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për "Parku Natyror Liqeni i Shkodrës, VKM nr. 60, duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, O.E "I." shpk, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **11,200,000 lekë pa T.V.SH** totali i pikëve të marra 93 pikë, është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit. Njoftimi i formularit paraprak të fituesit është realizuar me nr. 2088/1 prot., datë 10.06.2024 dhe formulari i fituesit është me nr. 2088/2 prot., datë 18.06.2024. Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është me nr. 2172 prot., datë 19.06.2024.

Sa më sipër nga auditimi i fakteve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet:

Së pari; S'kualifikimi i BOE "A." sh.p.k & "T." sh.p.k, është i padrejtë, pasi referuar DT Kriteri 2.3.2 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DT. BOE "A." sh.p.k & "T. H." sh.p.k, kanë plotësuar formularin e vetë deklarimit referuar nenit 77 "Kërkesat për kualifikim" të LPP. Në nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetë deklarimit" pika 1 citon: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik". Neni 92/3 i LPP përcakton se "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji". Sipas VKM nr. 285 datë 19.05.2021 neni 26 pika 1 "Formulari përmbledhës i vete deklarimit" citon "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti Kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vete deklarimit,

sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”. Referuar arsyeve të s’kualifikimit të BOE “A.” sh.p.k & “T.” sh.p.k, konstatohet se nuk janë në frymën e Dokumenteve të tenderit **në vlerësim me pikë**, pasi minimalisht nga KVO duhej të kualifikohej ky operator për shkak të formularit të vetë deklarimit dhe të vlerësohet sipas kritereve të pikëzimit të përcaktuar në DT. Pra KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe DT,

Së dyti; OE “I.” shpk (i cili është ftuar nga AK edhe për përllogaritjen e fondit limit), konstatohet se në ngjashmëri me BOE e s’kualifikuar, nuk plotëson kriteret kualifikuese siç përcaktohet në DT. Eksperti i turizmit deklaruar nga “I.” shpk, G. B ka diplomë dhe përfunduar studimet për Administrim Biznes *me profil Marketing* (ku plotëson pikën e parë të kërkuar, e cila është e paqartë dhe konfuzë ku eksperti i turizmit kërkohet me diplomë Master Shkencor në Shkenca shoqërore/Marketing/Turizëm), por nuk plotëson **të paktën 3 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet te lidhura me turizmin**. Nga verifikimi i CV e vetmja eksperiencë në turizëm është *“Trajnim EBRD për ndërmarrjet mikro turistike në marketing dixhital dhe promovim online (Mars - Maj 2021)”*. Pra, G. B nuk disponon asnjë Diplomë në fushën e Menaxhimit të Turizmit dhe në analogji me BOE e s’kualifikuar edhe “I.” shpk duhej të s’kualifikohej. Ekspertët Hidrogeolog, Biologji, Agronom, Sociologji etj, janë të kontraktuar nga kjo shoqëri më datë 22.05.2024 (pas publikimit të procedurës) dhe oferta e dhënë prej tij në studimin e tregut me shkresë nr. 1591/3 prot. Datë 02.05.2024, është e pasaktë dhe e pa analizuar në përllogaritje të fondit limit. **Së treti;** Oferta ekonomike e BOE “A.” sh.p.k & “T.” sh.p.k ishte me çmim ekonomikisht më të favorshëm dhe nëse KVO do të vlerësonte sipas Dokumenteve të Tenderit dhe kritereve vlerësuese, ky operator do të merrte **50 pikë** si më i mirë dhe situata do të tjetërsohej plotësisht.

Nr	Sipas kërkesave në Kriteret e DST	BOE “A.” & “T.”	OE “I.”
1	Çmimi	50	47.3
2	Eksperiencia e ngjashme e kompanise	10	10
3	Metodologjia e propozuar	15	15
4	Eksperiencia e Stafit Teknik te Propozuar	16	18
	Total	91	90.3

Referuar formulës së çmimit $Pk1 = Vmin k1 \times P \max k1 / Ok1$

Pk1 Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Pikët e “I.” shpk = $10,600,000 \text{ lekë (Oferta BOE)} \times 50 \text{ pikë} / 11,200,000 \text{ lekë (oferta OE)} = 47.3 \text{ pikë}$.

Sa më sipër, nga Shqyrtimi dhe Vlerësimi i KVO arrihet në konkluzion;

Së pari, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka kryer veprime të pajustificuara, të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 3, pika 1 *“Parime të përgjithshme”* ku citohet se *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Së dyti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja për një ofertë *(me një vlerë shumë më të ulët se ajo e sipërcituar dhe e shpallur fituese)* ka kryer s’kualifikimin, në vijim, në kundërshtim me frymën, qëllimin dhe dispozitat e përcaktuara në LPP. Referuar nenit 2 të tij, qëllimi i ligjit Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* a) është të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) **të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në**

procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton dukshëm i theksuar fakti që në veprimtarinë-vendimmarrjen e tij AK duhet të ketë si qëllim parësor mirë përdorim apo mirë administrimin e fondeve publike. Dispozitat e LPP nuk janë opsionale për t'u zbatuar nga KVO-ja, por detyruese, brenda kornizave dhe përcaktimeve ligjore, në funksion të qëllimit të ligjit të përcaktuar në nenin 2 të tij.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se nga njëra anë nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në rastin konkret, veprimet e KVO-së, përveçse **nuk** sigurojnë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik duke ndikuar **negativisht** në mirë përdorimin e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e shërbimit me një vlerë më të lartë ekonomike, e cila përbën Efekt Negativ Financiar dhe jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Efektivitetit dhe Eficencës. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga BOE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të jetë kërkuar asnjë sqarim nga ofertuesi apo NJP për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre. Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar nenit 2 të ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", me qëllim rritjen e eficencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirë përdorimin e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është "*Çmimi më i leverdisshëm*", për të bërë të mundur minimalisht shmangien e kryerjes së punimeve me një vlerë të konsiderueshme me të lartë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit, përkatësisht:

- Nga kualifikimi "I." shpk dhe s'kualifikimit të padrejtë të BOE "A." sh.p.k & "T." sh.p.k, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor këtij të fundit në vlerën **600,000 lekë (11,200,000 – 10,600,000)** si diferenca midis ofertave të BOE në klasifikimin e cila përbën Efekt Negativ Financiar për Buxhetin e Shtetit dhe jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficencës dhe Efektivitetit.

Veprimet në kundërshtim me ligjit Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" neni 2, a) është të rrisë eficencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; janë veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO-së. Në përfundim për sa konstatuar më sipër, veprimet e KVO-së bien në kundërshtim me ligjin Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar. Neni 87 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*", Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën *ekonomikisht më të favorshme*. Neni 92 të ligjit 162/2020 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 përcakton se "*Autoriteti ose enti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*". Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO, të përbërë nga J. S, S. Xh, A. C dhe titullari i AK D. P.

C2.2 Mbi vlerësimin e ofertave

2.2 Loti II Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për "*Parku Kombëtar Mali i Tomorrit*" VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneks 8", me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh, REF-05223-05-17-2024.

Me procesverbalin nr.1 nr.1815/1 prot., datë 04.06.2024 të KVO, konstatohen ofertat ekonomike si më poshtë;

- | |
|--|
| 1. "I." shpk, me vlerë 11,200,000 lekë pa T.v.sh |
| 2. BOE "T." & "A." me vlerë 10,400,000 lekë pa T.v.sh |

3. "L." me vlerë **9,828,600** lekë pa T.v.sh

Me procesverbalin nr. 2 nr. 1815/3 prot., datë 06.06.2024 të KVO, shqyrtohen dhe vlerësohen ofertat ekonomike si më poshtë:

1. Nga KVO s'kualifikohet Operatori Ekonomik, BOE "T." & "A.", pasi nuk përmbush pikën 2.3, të Kriteve të veçanta në DST, për arsye se:

a- Për Ekspertin Inxhinier Pyjesh Dh. P, mungon CV e tij, në të cilin theksohen eksperiencat në projekte apo përgjegjësi të ngjashme. Për këtë arsye është i pa evidentueshëm numri i viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar.

b- Për Ekspertin e Turizmit, A. G mungon dokumenti i njohjes dhe njësimit e kualifikimit akademik nga Ministria e Arsimit Shqiptar, pasi ka depozituar vetëm dokumentin (fotokopje) të Master of Arts (in Tourism Menagement), si dhe nga CV nuk përmbush kriterin e viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar;

c- Për ekspertin Ligjor E. A, nuk përmbush kriterin e viteve të eksperiencës në fushën e kërkuar, sipas CV së paraqitur.

2. Nga KVO s'kualifikohet Operatori Ekonomik, OE "L." shpk, pasi nuk përmbush pikën 2.3.4, të Kriteve të veçanta në DST, për arsye se:

- Nuk plotëson pikën 2.3.4, të kriteve të veçanta sipas të cilit duhet të ketë në stafin e tij të paktën 12 punonjës, për muajin e fundit të deklaruar. Në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër me nr. T10718952, datë, 03.06.2024 rezulton se për muajin Maj ky operator ka të deklaruar 14 punonjës ndërkohë që nga ky vërtetim rezulton se ky subjekt ka detyrim për të paguar gjithsej 94,613 lekë detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Gjithashtu referuar po këtij vërtetimi rezulton se për muajin Prill 2024 operatori ekonomik ka të deklaruar 5 punonjës, për të cilët rezulton se ka paguar të gjitha detyrimet konform ligjit. Pra numri i punonjësve të deklaruar për muajin Prill (i cili është muaji i fundit që nuk ka detyrime) bie ndesh me pikën 2.3.4 të DST, pasi nuk përmbushet numri 12 i punonjësve të kërkuar. Kjo vjen në kundërshtim me pikën dh, të shtojcës 8 të Kriteve të Përgjithshme të përzgjedhjes ku citohet se:

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në pikën 76/2.

- KVO kualifikon vetëm operatorin ekonomik "I." shpk, duke i dhënë në total 93 pikë. OE "L." shpk, ka paraqitur ankesë pranë AK dhe KPP dhe me urdhrin e titullarit nr. 240 datë 19.06.2024, ngrihet komisioni i shqyrtimit të ankesave e përbërë nga F. K, M. C dhe E. Z. Me vendimin e KSHA nr. 2159/3 prot., datë 20.06.2024, nuk pranon ankesën e operatorit ekonomik, duke mbajtur të njëjtin qëndrim të KVO. Me Vendimin e KPP Nr. **835/2024** me nr. 1599/6 prot., datë 09.07.2024, vendos të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "L." SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-05223-05-17-2024, me objekt: Loti II "Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për 'Parku Kombëtar Mali i Tomorrit VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneksi 8', zhvilluar më datë 04.06.2024, nga autoriteti Kontraktor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Vendimi i KPP bazohet kriterit në pikën 2.3.4 përcaktohet se "Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 12 punonjës për muajin e fundit të deklaruar, të vërtetuar me: a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar; b) Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar". Gjithashtu, në këtë kriter përcaktohet se "*Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetë deklarimit sipas shtojcës nr.9, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar. Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse*". Gjithashtu, në "*Kriteret e përgjithshme të kualifikimit*", të cilat përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit të

operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, në pikën 1/dh përcaktohet se “Ofertuesi deklaron se: “dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;”. Me vendimin e KPP nr. 894/2024 datë 17.07.2024, citohet se AK ka zbatuar Vendimin e KPP nr. 835/2024 datë 09.07.2024 dhe lejohet AK të vazhdojë hapat e mëtejshëm të procedurës. Me procesverbalin e KVO nr. 1815/4 prot., datë 16.07.2024, shqyrtohet dhe vlerësohet ofertat e operatorëve të kualifikuar, ku OE “Lirimi” shpk merr 91 pikë dhe “I.” merr 83.95 pikë. Me procesverbalin e KVO nr. 1815/5 prot., datë 18.07.2024, verifikohet dokumentacioni fizik i sjellë nga OE “L.” shpk, ku citohet se në bazë të dokumentacionit të sjellë rezultoi se ka mospërputhje midis numrit të punonjësve të deklaruar për muajin Prill 2024 dhe kriterit të DST ku kërkohet që OE të ketë 12 punonjës. Për muajin Prill OE ka deklaruar 5 Punonjës dhe mungon listë pagesa e muajit Prill dhe vendos përsëri të s’kualifikojë këtë operator. Me procesverbalin nr. 2517/1 prot., datë 19.07.2024 shqyrtohet dhe vlerësohet ofertat e operatorit “I.” shpk, ku deklarohet se plotëson dokumentacionin e kërkuar sipas DST.

Sa më sipër nga KVO konstatohen veprime në kundërshtim me LPP, pasi referuar DT, nga KVO nuk është konstatuar pika 2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t’i jepen ofertuesit:

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Operatori ekonomik “I.” shpk në të dyja Lotet ka hedhur në SPE të njëjtat dokumente ekonomike dhe teknike, me të gjithë stafin e kërkuar. Përsëri OE “L.” shpk ka paraqitur ankesë pranë AK me nr. 2453/3 prot., datë 26.07.2024 dhe KPP dhe me urdhrin e titullarit nr. 283 datë 26.07.2024, ngrihet e njëjta KSHA e përbërë nga F. K, M. C dhe E. Z, ku përsëri mbahet i njëjti qëndrim i KVO.

- Me Vendimin e KPP Nr. **1286/2024** me nr. 2082/9 prot., datë 19.09.2024, vendos të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “L.” Shpk. Vendimi i KPP bazohet së datën 20.05.2024, është publikuar në SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”. Në datën 04.06.2024, autoriteti Kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit. AK me datë 16.07.2024 i ka kërkuar operatorit ekonomik “L.” SHPK, të paraqesë dokumentacionin provues. Si përfundim KPP citon dhe argumenton si më poshtë: Operatori ekonomik “L.” Shpk, për përmbushjen e kriterit 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, gjithsej 21 faqe në brendësi të të cilit gjenden:

Vërtetim “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin-E-SIG 02/a) nr. T10718952 datë 03.06.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër ku periudha e fundit tatimore rezultoi maji 2024, me numër të kontributeve 14, me 0 lekë pagesë; Vërtetim “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin-E-SIG 02/a) nr. T10771469 datë 06.06.2024 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër ku periudha e fundit tatimore rezultoi maji 2024, me numër të kontributeve 14, me 94,613 lekë pagesë; Vërtetim “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin-ESIG 02/a) nr. T11012332 datë 13.07.2024 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër; Listë pagesat e sigurimeve shoqërore për muajit Maj-Qershor 2024 me numër prej 14 punonjësish; vërtetim “Për pagim detyrimesh” me nr. T 10656742, datë 25.05.2024 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër; formularin përmbledhës të vetë deklaramit ku në sesionin përkatës ka deklaruar se ka në listë pagesën e muajit të fundit 14 punonjës. Duke marrë shkas nga arsyeja

e s'kualifikimit të ankimesit, kriteri i hartuar nga autoriteti Kontraktor, i cili ka kërkuar vërtetimin e pagesës së tatimeve dhe të sigurimeve shoqërore për numrin e punonjësve për muajin e fundit të deklaruar, dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ankimesi si dhe dokumentacioni fizik i paraqitur nga ky i fundit në autoritetin Kontraktor për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumenteve të tenderit, KPP gjykon se vendimi i autoritetit Kontraktor për s'kualifikimin e tij është *i padrejtë dhe pretendimi i operatorit ekonomik ankimes gëndron.*

- Me procesverbalin e KVO nr. 1815/6 prot., datë 25.2024, rishqyrtohet dhe rivlerësohet ofertat e operatorëve të kualifikuar, ku OE "L." shpk merr përsëri 91 pikë dhe "I." merr 83.95 pikë. Me formularin e njoftimit paraprak nr. 9330 prot., datë 04.10.2024, njoftohet OE lirimi si fitues paraprak i procedurës. Me vendimin e KPP nr. 1370/2024 datë 01.10.2024, lejohet AK të vazhdojë hapat e tjerë të procedurës prokuruese.

Sa më sipër, nga Shqyrtimi dhe Vlerësimi i KVO arrihet në konkluzion se nga AK ka vepruar në kundërshtim me ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 2, a) është të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

3. Procedura me objekt; "Studim mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave, duke përfshirë statusin e mbrojtjes në varësi të rëndësisë, si dhe nën zonimin përkatës": viti 2023.

Të dhënat e përgjithshme për procedurën e prokurimit;

Procedura me objekt: Studim mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave, duke përfshirë statusin e mbrojtjes në varësi të rëndësisë, si dhe nënzonimin përkatës		
1.Urdhër Prokurimi F....	2.Njësia e prokurimit:	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 328, datë 15.09.2023	1.A. M. 2.G. C. 3. F. K.	Urdhër nr. 261, date 17.07.2023 1.S. Xh. (Kryetar) 2.H. P. (Anëtar) 3.A. C. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Shërbim konsulentë me mjete elektronike "		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 13,816,666.7 lekë pa t.v.sh	6.Oferta fituese: Vlera 13.816.600 pa t.v.sh	7.Diferenca me fondin limit 66.7 lekë (pa T.v.sh)
8. Data e hapjes së tenderit: 04.10.2023 ora 12:00	9. Burimi Financimit: Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.	10.Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës në tender: 2 c) Kualifikuar; 1
11. Ankimime AK. S'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK.S'ka	Titullar i AK znj. D.P.

a. Hartimi i fondit limit

Me urdhrin e titullarit AK nr. 256, datë 07.07.2023, ngrihet grupi i përllogaritjes së fondit limit dhe kriterëve kualifikuese të përbërë nga A. M, G. C dhe F. K. Titullari i AK i komanduar D. P, për përllogaritjen e fondit limit u ka kërkuar ofertë ekonomike për të dy lotet operatorëve ekonomikë si më poshtë:

- Me shkresën nr. 2415/3 prot., datë 07.07.2023, OE "I." Shpk; Me shkresën nr. 2415/2 prot., datë 07.07.2023, OE "Gj." Shpk; Me shkresën nr. 2415/1 prot., datë 07.07.2023, OE "T." Shpk; Operatori "T." Sh.p.k me shkresë nr. 2415/4 prot., datë 12.07.2024 jep ofertën e tij me vlerë 13,791,666 lekë pa t.v.sh; Operatori "Gj." Shpk me shkresë nr. 2415/5 prot. datë 12.07.2024 jep ofertën e tij me vlerë 13,916,666 lekë pa t.v.sh; Operatori "I." Shpk me shkresë nr. 2415/6 prot. datë 12.07.2024 jep ofertën e tij me vlerë 13,741,666 lekë pa t.v.sh. Me procesverbalin nr. 2415/7 datë prot., datë 14.07.2024, grupi i përllogaritjes së fondit limit ka realizuar mesataren e ofertave

bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76 pika1/b. Nga verifikimi i ekstrakteve në QKB, konstatohet se, asnjë nga këta ofertues, kanë fushën e veprimtarisë kryesisht për projektme inxhinierie dhe mbikëqyrje kolaudime dhe nuk disponojnë në kohën e studimit të tregut, ekspertët për hartimin e ofertave të sakta për përlllogaritjen e fondit limit. Përlllogaritja e fondit limit u evidentua se për procedurën objekt prokurimi, nga Grupi i ngritur për justifikimin e fondit limit për Studim mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave, duke përfshirë statusin e mbrojtjes në varësi të rëndësisë, si dhe nën zonimin përkatës”, nuk është kërkuar në ofertat e tregut me analizë të koston për këtë shërbim. Ndërkohë që duke iu referuar Termave të Referencës dhe llojit të shërbimit, zërat e koston janë të përbërë nga kosto ekspertësh, kosto administrative dhe kosto aktiviteteve. Me Urdhër Prokurimi të titullarit AK D. P Nr. 262, datë 17.07.2023, urdhërohet të realizohen procedurat dhe lloji i procedurës është përcaktuar “Shërbim Konsulence” bazuar në nenin 54 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar dhe 50 të LPP, ku konstatohet se, procedura e përzgjedhur në vitin 2023 është në përputhje me LPP.

b. Hartimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit DST

Hartimi i Dokumenteve të tenderit është hartuar bazuar në kriteret e shërbimit të Konsulencës, duke përcaktuar Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto (Me vlerësim me Pikë).

A. Çmimi dhe Propozimi teknik “0” Pikë

B. Kriteret e Vlerësimit teknik	Pikët
(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]
(ii) Metodologjia e Propozuar (Përjasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)	[20-30]
(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	[20-50]
(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohej)	[10]

Sa më sipër, konstatohen veprime të paargumentuara dhe pajustificuara në kundërshtim me frymën LPP neni 1, neni 2, VKM mbi rregullat e prokurimit, DST, etj, duke mos vlerësuar çmimin me pikë, duke mos i dhënë rëndësi ofertës ekonomike, por vetëm kapaciteteve teknike në mënyrë subjektive, ç’ka ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.

C1. Mbi vlerësimin e ofertave

- Me procesverbalin e hapjes së ofertave nga KVO nr.1 me nr. 2798 prot., datë 11.08.2023, u konstatua se nuk u paraqit asnjë ofertë dhe formulari i anulimit u realizua me nr. 2798/1 prot., datë 15.08.2023. Me procesverbalin nr. 2798/2 prot., datë 16.08.2023, njësia e prokurimit analizon shkakun e mospjesëmarrjes nuk e përbëjnë kriteret kualifikuese.

- Me Urdhrin e Ri përsëritjes së Prokurimit të titullarit AK-së D. P Nr. 286, datë 07.08.2023, urdhërohet të realizohen procedurat me fond limit 13,816,666 lekë pa T.v.sh dhe lloji i procedurës është përcaktuar “Shërbim Konsulence”. Kriteret e Përgjithshme dhe të veçanta kanë ngelur identike ku në pikën 2.3.2 kërkohej që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- 3 (tre) Eksperte Biologë, ku njeri duhet te jete edhe Koordinator i këtij studimi:

Koordinator Projekti - Ekspert Biolog

Ekspert Biolog – për florën

Ekspert Biolog – për faunën

- 1 (një) Ekspert Peshkimi

- 1 (një) Ekspert Turizmi

- 1 (një) Ekspert Sociolog

- 1 (një) Hidrogeolog

- 1 (një) Inxhinier/ Ekspert Mjedisor (i pajisur me Licencat profesionale/certifikata)

- 1 (një) Ekspert GIS (i pajisur me Licencat profesionale/certifikata)

C2. Mbi vlerësimin e ofertave

- Me procesverbalin e hapjes së ofertave nga KVO nr.1 me nr. 3011 prot., datë 04.09.2023, u konstatua se, nuk u paraqit asnjë ofertë dhe formulari i anulimit u realizua me nr. 3011/1 prot., datë 04.09.2023. Me procesverbalin nr. 3011/2 prot., datë 04.09.2023, njësia e prokurimit analizon shkakun e mospjesëmarrjes nuk e përbëjnë kriteret kualifikuese. Me Urdhrin e ri përsëritjes së Prokurimit të titullarit AK D. P Nr. 328, datë 15.09.2023, urdhërohet të realizohen procedurat me fond limit 13,816,666 lekë pa T.v.sh dhe lloji i procedurës është përcaktuar “Shërbim Konsulencë”. Kriteret e Përgjithshme dhe të veçanta janë identike me procedurat më parë.

3. Mbi vlerësimin e ofertave

- Me procesverbalin e hapjes së ofertave nga KVO nr.1 me nr. 3208/1 prot., datë 04.10.2023, u konstatua se janë paraqitur 2 (dy) operatorë ekonomikë dhe përkatësisht:

1. “T.” Shpk

2. “I.” Shpk

- Me procesverbalin nr. 2 nr. 3208/2 prot., datë 10.10.2023, verifikohet dokumentacioni fizik për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulencë”, me objekt “*Studim mbi rëndësinë e ekosistemeve të lagunave*”, nga Vlerësimi i fazës së parë **s’kualifikohet OE “T.” shpk për arsye:** Bazuar në DST, në të cilën citohet se, për stafin e deklaruar OE duhet të paraqesë: Kontratat individuale të punës, licencat profesionale/certifikata/diploma dhe CV (në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme) nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se:

1. Znj. L. X, ka lidhur kontratë me OE për ekspert biolog - për faunën. Referuar diplomës së saj (Agronomi) dhe faktit që *nuk ka paraqitur eksperiencia të ngjashme të punës me faunën nuk plotëson kriteret si ekspert për faunën.*

2. Znj. I. P, ka lidhur kontratë me OE për ekspert peshkimi. Referuar diplomës së saj (Hortikulturë dhe Mbrojtje Bimësh) dhe faktit që në CV e saj *nuk ka asnjë eksperiencë pune apo studimi në fushën e akuakulturës, ajo nuk plotëson kriteret si ekspert për peshkimin.*

- Përsa më sipër, nga KVO për mos përmbushje të kriterëve të përcaktuara në DST, OE “T.” shpk nuk kualifikohet në fazën tjetër. Nga Vlerësimi i fazës së parë është kualifikuar vetëm OE “I.” Shpk. Me ftesën për propozim nr. 3578 prot., datë 18.10.2023, ftohet në fazën tjetër vetëm operatori i kualifikuar “I.” shpk. Me procesverbalin nr. 3 nr. 3208/3 prot., datë 03.11.2023, nga KVO vlerësohet propozimi i OE “I.” shpk. *Tabela e vlerësimit është si më poshtë vijon:*

Nr	Sipas kërkesave në Kriteret e DST	S.Xh.	H.C.	A.C.	Pikët total (Mes KVO)
1	Eksperiencia e ngjashme e kompanisë	7	7	8	7.33
2	Metodologjia e propozuar	23	21	22	22
3	Eksperiencia e Stafit Teknik te Propozuar	46	45	47	46
	Total	76	73	77	75.33

Nga KVO për kriterin e stafit Kryesor të propozuar (vlerësuar me 46 pikë) citohet:

Operatori është vlerësuar me 46 pikë pasi ka numër stafi teknik më shumë se sa ai i kërkuar, shumica e stafit disponon kualifikimet akademike mbi minimumin e kërkuar në kriteret e veçanta, disponon eksperiencën në vite pune dhe në shërbime të ngjashme me kontratën e prokurimit. *Disa nga ekspertët e propozuar nuk kanë kualifikimet akademike apo eksperiencën e kërkuar.*

Formulari i njoftimit të fituesit është realizuar me nr. 3840 prot., datë 07.11.2023. Raporti përmbledhës miratohet nga titullari i AK D. P me nr. 3208/5 prot., datë 07.11.2023 dhe kontrata e shërbimit nënshkruhet me nr. 3967 prot., datë 21.11.2023.

Sa më sipër konstatohet veprime në favorizim të drejtpërdrejtë të OE “I.” shpk pasi;

Së pari; KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht që në fazën e I, OE “T.” shpk për mangësi të cilat nuk përbëjnë shkak për mos kalimin e fazës së II të propozimit teknik.

Së dyti; Vetë KVO konstaton se OE i shpallur fitues ka të njëjta mangësi si OE "T." shpk. Nga Shqyrtimi dhe Vlerësimi i KVO arrihet në konkluzion se nga AK ka shpallur fitues, në kundërshtim me ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 2, a) është të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt: "**Ndërtim i Hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur "Syri i Kaltër"**", realizuar në vitin 2022, u konstatuan disa parregullsi si vijon:

A. Të dhëna mbi objektin

a. Zbatimi i Kontratës Punimeve		
14. Lidhja e kontratës bazë Nr. 665 prot., datë 28.04.2022 midis AKZM dhe sipërmarrësit OE "F." sh.p.k.	15. Vlera e kontratës (me t.v.sh) 33,999,593 lekë.	16. Leje ndërtimi për punimet e objektit. .Po Nr .1004 prot, datë 22.04.2022 nga Bashkia Finiq
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi N/A	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar: 2 muaj. Fillimi punimeve: 28.04.2022 Përfundimi punimeve: 28.06.2022 (Brenda afateve kontraktuale)	Projekti është hartuar nga shoqëria "T." shpk sh.p.k
20. Mbikëqyrësi i punimeve Mbikëqyrësi OE "T." shpk,	Licenca Nr: MK. 0672/8	Kontrata Shërbime nr. 394 prot., datë 15.03.2022
21. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AKZM-së dhe kolaudatorit OE "E." shpk	Licenca Nr: MK 3459/2	SH/Shërbime nr. 1467 prot., datë 28.07.2022
22.Akt Kolaudimi Datë 30.07.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 12.08.2022	

a. Mbi zbatimin e punimeve të objektit.

I. Nga verifikimi i projektit fillestar, preventiv ofertës, dhe preventivit të ndryshuar, është konstatuar se janë hequr dhe janë shtuar volume zëra punimesh gjatë zbatimit të objektit urdhra ndryshimi. Projekti parashikon ndërtimin e sheshit të parkimit të automjeteve në zonën e mbrojtur të "Syrit të Kaltër", si dhe aksesimin e tyre në zonë. Preventivi parashikon punime dheu, punime për sistemimin e kanalit, punime për shtresat e parkimit, punime në ujërat e bardha, elektrike dhe sinjalistikë.

- Objekti i kontratës "**Ndërtim i Hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur "Syri i Kaltër"**", është kryer sipas kontratës për punë publike 665 prot., datë 28.04.2022 midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar L. A B dhe sipërmarrësit OE "F." sh.p.k, përfaqësuar nga administratori Sh. F. Vlera e kontratës është 33,999,593 lekë me T.V.SH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 2 muaj nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 394 prot., datë 15.03.2022, të lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. D dhe sipërmarrësit OE "T." sh.p.k, përfaqësuar nga administratori J. K licencë MK. 0672/8.

- Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim 1467 prot., datë 28.07.2022, të lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, përfaqësuar nga Drejtori i

Përgjithshëm D. P dhe sipërmarrësit OE “E.” sh.p.k, përfaqësuar nga administratori A. G me licencë MK 3459/2.

- Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, akti i piketimit janë realizuar nga palët më datë 28.04.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me pa prot. datë 28.04.2022. Me kërkesën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 810/1 prot., datë 18.05.2022, kërkohet miratim i ndryshimeve në projektin e zbatimit. Bashkëlidhur propozimit për ndryshim të projektit ndodhen tabela e rakordimeve të volumeve, preventivi i ripunuar, vizatimet e ripunuara, relacion nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi për ndryshimet. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se miratimet dhe ndryshimet, preventivi i ripunuar dhe Urdhër ndryshimi nuk janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm D. P. Referuar Urdhër ndryshimit nr. 1 datë 18.05.2022, konstatohen ndryshimet e projekt zbatimit si më poshtë: Urdhër ndryshimi është përgatitur në bazë të kërkesës së kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve, me qëllim përmirësimin e treguesve teknikë të projektit. Ndryshimet kanë ardhur si pasojë e diferencave të kuotave të terrenit projekt-fakt nga mospërputhjet e projekt-preventivit, bazuar në nenin 26 të kontratës së zbatimit “Modifikimi i kontratës si dhe pika 3.4 të Udhëzimit të KM nr. 2 datë 13.05.2005. Disa nga problematikat citohen se:

- Nga azhurnimi faktit janë konstatuar diferenca e kuotës së rrugës dhe kuotës së parkimit që shkojnë **deri në 1.5 m**. Kjo ka ardhur për arsye se në momentin e hartimit të projektit ende nuk ishte përfunduar rruga që akseson parkimin. Duke ulur kuotën e parkimit, dhënien e pjerrësisë janë stabilizuar ujërat e shiut dhe janë evidentuar sasi të mëdha të mbushjes për nivelim dhe arritjen e kuotës përfundimtare.

- Nisur nga profili tip i projektit është evidentuar që mungon një shtresë çakëll 20 cm siç e kërkon shtresat e parkimit (2x20 cm). Është realizuar rishikim i paketës së shtresave të parkimit për të eliminuar sasinë e lartë të betonit dhe shtohet e gjithë sipërfaqja me gjeograf e cila realizon unifikimin e shtresave në të njëjtat kuota. Nga rakordimet e volumeve është vlerësuar të hiqen punimet e ndriçimit në zonë me arsyen se parkimi ka më shumë fluks gjatë ditës së natës.

Sa më sipër kërkesave për ndryshim konstatohet:

- Projekti fillestar ka parashikuar 2 shtresa çakëll (2 x 20 cm), ndërsa preventivi fillestar ka parashikuar vetëm 1 shtresë çakëll (1x 20 cm). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se kuotat e tokës të realizuara nga sipërmarrësi i punimeve, nuk ekziston nevoja e gërmimeve pasi edhe vetë nga sipërmarrësi në urdhër ndryshimi konstatohet se ekziston thellësi deri në **1.5 m**. Arsyeja e heqjes së punimeve të ndriçimit, nuk është arsyetim që i takon kontraktorit të propozojë por vetë AK, pasi tjetërsohet një pjesë e rëndësishme e projektit. Nga dokumentacioni fotografik i dosjes së zbatimit nuk vërtetohet se janë realizuar 2 shtresa çakëll nga sipërmarrësi i punimeve. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi me nr. 1165 prot., datë 28.06.2022, ku deklarohet përfundimi i punimeve sipas kontratës. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është më datë 12.08.2022 dhe Akti i kolaudimit të punimeve është realizuar më datë 30.07.2022.

II. Nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit, tabelës së lëvizjes së volumeve dhe situacionit përfundimtar, u konstatua disa pasaktësi në përlllogaritjen e punimeve të miratuara nga Ing. B. L, të cilat rezultojnë të paguara në situacion përkatësisht për:

Zëri 1 nr. 3,104/b “Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m3, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet”, është paguar në situacion në sasinë 3,577 m³. Në librezën e masave volumi shtresë betoni është pasqyruar 3,577 m³. Nga verifikimi i projektit të rishikuar, librezës së masave, konstatohet se sipërfaqja për parkimit, sipërfaqet e gërmimit janë si më poshtë:

Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m3, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet							
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sipërfaqe	Sipërfaqe mesatare	Gjatësi	Numër (lartësi)	Vëllimi (m3)
1		m3	19.52				

2	Sez.1	m3	44.25	31.885	15	1	478.28
3	Sez.2	m3	52.12	48.185	31	1	1,493.74
4	Sez.3	m3	68	60.06	29	1	1,741.74
5	1. Sipërf që zbritet	m3	0.3	30		-14	-126.00
6	2. Sipërf që zbritet	m3	0.3	13.00		-1	-3.90
7	3. Sipërf që zbritet	m3	0.3	9.7		-1	-2.91
8	4. Sipërf që zbritet	m3	0.3	11.65		-1	-3.50
	Volumi total						3,577.45

Ndërkohë, deklarohet i realizuar edhe zëri “Mbushje me çakëll e gur gurorë në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri” me një lartësi 8 cm ose 0.087 m në gjithë sipërfaqen e parkimit prej 5,388 m², në volum prej 468.8 m³ mbushje. Referuar Urdhër ndryshimit, projektit azhurnuar dhe librezës së masave, sipërmarrësi ka shtuar edhe shtresën e dytë të çakëll t=20 cm, duke realizuar në total 5,388 m² sip parkimit x 2 shtresa = 10,776 m². Referuar përllogaritjeve të realizuar nga sipërmarrësi, projektit azhurnuar, kuotave të tokës, argumentimit në kërkesën për ndryshim ku citohet se, ekziston thellësi deri në **1.5 m**, rezulton se zëri nr. 1 “Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet”, në sasinë prej 3,577 m³, rezulton i pasaktë, i paargumentuar dhe i përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 450 lekë/m³, rezulton vlera prej 1,609,650 lekë e përfutur padrejtësisht. Gjithashtu, **Zëri 3 nr. 2.37/5a “transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5 km”**, është përllogaritur të njëjtën sasi të gërmimit të dherave prej 3,577 m³ për transportin e tyre e cila përsëri është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 250 lekë/m³, rezulton vlera prej 808,200 lekë e përfutur padrejtësisht.

- Si përfundim sipërmarrësi OE “F.” sh.p.k, ka përfutur më tepër vlerën **2,417,850 lekë pa t.v.sh** (1,609,650 lekë + 808,200 lekë) ose **2,901,420 lekë me t.v.sh**, për punime të pakryera, në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, i ndryshuar dhe Nenin 7 dhe 12 të Ligjit Nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve B. L.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike me objekt: “Ndërtim i Hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur “Syri i Kaltër” sipas kontratës për punë publike 665 prot., datë 28.04.2022 midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, dhe sipërmarrësit “F.” sh.p.k, me vlerë të kontratës është 33,999,593 lekë me T.V.SH, u konstatuan disa pasaktësi në përfitim të padrejtë të sipërmarrësit të punimeve. Nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit, tabelës së lëvizjes së volumeve dhe situacionit përfundimtar, u konstatuan disa pasaktësi në përllogaritjen e punimeve, të cilat rezultojnë të paguara në situacion përkatësish për zërin 1 nr. 3,104/b “Gërmim dheu me eskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet”, është paguar në situacion në sasinë 3,577 m³. Ndërkohë, deklarohet i realizuar edhe zëri “Mbushje me çakëll e gur gurorë në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri” me një lartësi 8 cm ose 0.087 m në gjithë sipërfaqen e parkimit prej 5,388 m², në volum prej 468.8 m³ mbushje. Referuar Urdhër ndryshimit, projektit azhurnuar dhe librezës së masave, sipërmarrësi ka shtuar edhe shtresën e dytë të çakëll t=20 cm, duke realizuar në total 5,388 m² sip parkimit x 2 shtresa = 10,776 m². Referuar përllogaritjeve të realizuar nga sipërmarrësi, projektit azhurnuar, kuotave të tokës, argumentimit në kërkesën për ndryshim citohet se ekziston thellësi deri në 1.5 m, dhe rezulton se zëri nr. 1 “Gërmim dheu me eskalator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet”, në sasinë prej 3,577 m³, rezulton i pasaktë, i paargumentuar dhe i përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 450 lekë/m³, rezulton vlera prej 1,609,650 lekë e përfutur padrejtësisht. Gjithashtu, Zëri 3 nr. 2.37/5a “transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5 km”, është përllogaritur në të njëjtën sasi të gërmimit të dherave prej 3,577 m³ për transportin e gërmimeve, e cila përsëri është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 250 lekë/m³, rezulton vlera prej 808,200 lekë e përfutur padrejtësisht. Si përfundim sipërmarrësi OE “F.”

sh.p.k, ka përfituar më tepër vlerën 2,417,850 lekë pa t.v.sh (1,609,650 lekë + 808,200 lekë) ose **2,901,420 lekë me t.v.sh**, për punime të pakryera, në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” i ndryshuar dhe Nenin 7 dhe 12 të Ligjit Nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

5. Procedura e prokurimit me objekt; “Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim plane menaxhimi”, ndarë në 9 (nëntë) lote.

Nga auditimi i kësaj procedure rezultoi se AK ka përzgjedhur procedurën e prokurimit “Procedurë kufirin e ulët monetarë”, me fond limit 8,100,000 lekë pa t.v.sh. Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar në 9 lote dhe është shpallur fitues Operatori Ekonomik BOE: “I.” sh.p.k & “K.”, me ofertën 4,866,222 lekë pa t.v.sh, diferenca me fondin limit në shumën 3,344,778 lekë.

Të dhënat të procedurës me objekt “Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim plane menaxhimi”:

2. Procedura me objekt: Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim plane menaxhimi		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 202 datë 19.09.2022	2.Njësia e Prokurimit: Hartimi I fondit limit urdh nr.188 datë 08.09.2022 1.A. M. (Jurist) 2.D. S. (specialist Pyjesh) 3.S. Xh. (Specialist Pyjesh)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.203 datë 19.09.2022 1.J. S. (Kryetar) 2.E. Z.(anëtar) 3.G. C. (anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kufirin e ulët monetarë ”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 8,100,000 lekë pa T.v.sh për 9 lote	6.Oferta fituese: “BOE: “I.” sh.p.k & “K.” sh.p.k, Vlera 4,866,222 lek pa T.v.sh	7.Diferenca me fondin limit 3,344,778 lekë (pa T.v.sh)
8. Data e hapjes së tenderit: 30.09.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit: Të ardhurat	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender:2 b)S’kualifikuar:1 c) Kualifikuar; 1
11. Ankimime AK. S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK. S’ka	Titullari i AK ZNJ. D P

a. Hartimi i fondit limit.

Me urdhër nr. 188 prot., datë 08.09.202, të Titullarit të AK-së, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit për hartimin termave të referencës për hartimin planeve të menaxhimit, i cili ka kërkuar oferta financiare nga tre subjekte:

Tabelë nr. Ofertë ekonomike të paraqitura për procedurën me objekt “Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim plane menaxhimi”:

Emërtimi i Subjektit	Vlera e Ofertës Financiare pa t.v.sh (Lekë)	Shkresë Nr. Datë nga AKZM
E.	1,000,000	Nr.1863, datë 12.09.2022
T.	800,000	Nr. 1863/1, datë 12.09.2022
A.	900,000	Nr.1863/2, datë 12.09.2022

b. Hartimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në zbatim të nenit Neni 77, të VKM-së, VKM 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Drejtori i Përgjithshëm ka hartuar Urdhër Prokurimi Nr. 202, datë 19.09.2022, duke përcaktuar objektin e prokurimit me limitet e buxhetit si më poshtë vijon;

Nr	Loti / Objekti	Fond Limit Leke pa t.v.sh
1	Loti I: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit “Parku Kombëtar Alpet e Shqipërisë	900,000
2	Loti II: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Zonë e mbrojtur detare – bregdetare e ekosistemit natyror detar-bregdetar të gjirit Porto Palermo”, VKM nr. 558, datë 29.07.2022.	900,000
3	VIII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Syri i Kaltër”	900,000

4	Loti VII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Mali me Gropa -Bizë -Martanesh",	900,000
5	Loti VIII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Syri i Kaltër	900,000
6	Loti V: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Liqeni i Shkodrës	900,000
7	Loti IX: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Kombëtar _Bredhi i Hotovës – Dangëlli", VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneksi 2 (Monumente natyre Brenda PK: Pylli i Ropushës, Bokërrimat e Dangëllisë, Gështenja e Teqesë – Frashër, Perëndi e Borockës (kanioni, Guri i Bletës), Kanioni i Kamenikut (kamenckes), Ujërat Termale të Bënjës, Shpella e Pëllumbave dhe Kanioni i Lengaricës, VKM nr.676 datë 20.12.2002. Ne qytetin e Permetit: Bredhi i Petranit, Cirku i Nemërçkës, Gropa e Kazanit, Grumbulli pyjor i Polmenit, Guri i Atos, Guri i Petranit, Guri i Qytetit, Horizonte vihtëse dhe olistolitet e Çarshovës, Pusi i Nemerçkës, Pylli i Gërhotit, Selvia e Kishës në Leusë, Ujëvara e Sopotit.	900,000
8	Loti III: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Kombëtar Llogara"	900,000
9	Loti VI: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Kune-Vain-Patok-Fushë Kuqe-Ishëm	900,000
	Total	8,100,000

Burimi i të dhënave: AKZM, përpunuar nga G.A. KLSH.

Grupi i punës i ngritur për hartimin e DST, ka mbajtur paraprakisht procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim si dhe në vijim janë hartuar DST për publikim në sistemin e APP-së, në përputhje me pikën 4 nenit 77 të LPP, në VKM 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar në VKM, 710, datë 24.11.2021 Neni 41, pika 2, "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve".

Konkluzion: Nga shqyrtimi i procesverbalit të llogaritjes së fondit limit rezultoi se llogaritja është bërë mbi mesataren e tre ofertave të paraqitura nga OE dhe jo e llogaritur për çdo zë sipas termave të referencës.

Auditimi mbi procesin e vlerësimit të procedurës.

Me Urdhër nr.273 prot., datë 10.11.2022 është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem (SPE) rezultoi se janë paraqitur 2 operatorë BOE: "I." sh.p.k & "K." dhe "Xh." Shpk Operatori "Xh." shpk është s'kualifikuar, pasi nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, për plotësimin e kritereve të përgjithshme si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit sipas shtojcës 8 e konkretisht: kritere të veçantë të kualifikimit- kapacitetet teknike pika 2.3. 2 dhe pika 2.3.3 nuk rezultojnë të këtë numrin e punonjësve të kërkuar dhe të deklaruar në listë pagesën e Sig. Shoq Qershor-Korrik 2022, si dhe nuk i ka deklaruar në formularin e vetë deklarimit, si rrjedhim është kualifikuar operatori ekonomik BOE: "I." sh.p.k & "K.", i cili i përmbush kushtet e kualifikimit.

Nga Vlerësimi i kryer KVO sipa ofertës fituese OE për 9 lotet si më poshtë:

Nr	Loti / Objekti	Subjekti i shpallur fitues	Vlera e Ofertes pa t.v.sh
1	Loti I: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Kombëtar Alpet e Shqipërisë	"BOE: "I. sh.p.k & "K." sh.p.k	540,714
2	Loti II: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Zonë e mbrojtur detare – bregdetare e ekosistemit natyror detar-bregdetar të gjirit Porto Palermo", VKM nr. 558, datë 29.07.2022.	"BOE: "I." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,672
3	VIII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Syri i Kaltër"	"I." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,696
4	Loti VII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Mali me Gropa -Bizë -Martanesh",	"BOE: "I. & S." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,702
5	Loti VIII: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Syri i Kaltër	"BOE: "I. & S." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,696
6	Loti V: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Liqeni i Shkodrës	"BOE: "I." & S." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,678
7	Loti IX: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Kombëtar _Bredhi i Hotovës – Dangëlli", VKM nr. 59, datë 26.01.2022, Aneksi 2 (Monumente natyre Brenda PK: Pylli i Ropushës, Bokërrimat e Dangëllisë, Gështenja e Teqesë – Frashër, Perëndi e Borockës (kanioni,	"BOE: "I. & S." sh.p.k & "K." sh.p.k	540,708

	Guri i Bletës), Kanioni i Kamenikut (kamenckes), Ujërat Termale të Bënjës, Shpella e Pëllumbave dhe Kanioni i Lengaricës_VKM nr.676 datë 20.12.2002. Ne qytetin e Permetit: Bredhi i Petranit, Cirku i Nemërçkës, Gropa e Kazanit, Grumbulli pyjor i Polmenit, Guri i Atos, Guri i Petranit, Guri i Qytetit, Horizonte vithsëse dhe olistolitet e Çarshovës, Pusi i Nemerçkës, Pylli i Gërhotit, Selvia e Kishës në Leusë, Ujëvara e Sopotit.		
8	Loti III: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Kombëtar Llogara"	"BOE: "I. & S." sh.p.k & "K....."	540,690
9	Loti VI: Hartimin e termave të referencës për hartimin e planit të menaxhimit "Parku Natyror, Kune-Vain-Patok-Fushë Kuqe-Ishëm	"BOE: "I. & S." sh.p.k & "K."	540,666
	Total		4,866,222

Burimi i të dhënave: AKZM, përpunuar nga G.A. KLSH.

Mbikqyrja dhe zbatimi i kontratës:

-Me Urdhër nr.2482, datë 10.11.2022 të Titullarit të AK-së është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të termave të referencës, me përbërje: A. A, F. K dhe S. B, në zbatim të nenit 107 të VKM 285 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, - Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratave.

-Procesverbal nr. 273 prot., datë 10.11.2022, mbi marrjen në dorëzim mbi zbatimin e termave të referencës.

6. Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi", ndarë në 6 lote.

Nga auditimi i kësaj procedure u evidentua se nga AK, ka përzgjedhur procedurën e prokurimit "Procedurë me kufirin e ulët monetar", me fond limit 5,400,000 lekë pa T.v.sh. Kanë marrë pjesë 2 OE dhe janë kualifikuar të dy OE dhe shpallur fitues: Operatori Ekonomik "G." shpk për Lotin 2, me vlerë 900,000 lekë pa t.v.sh dhe Operatori Ekonomik "A." për 4 lotet e tjera, me vlerë totale 1,841,250 lekë pa t.v.sh. Pra në total realizuar 2,741,250 lekë, me diferencë nga fondi limit në vlerë 2,658,750lekë.

Të dhënat e përmbledhura të procedurës "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi", ndarë në 6 lote si vijon:

Procedura me objekt: Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi, ndarë në 6 lote		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 234, datë 10.10.2022 Procedurë kufiri i ulët monetare "	2.Njësia e Prokurimit: 1. A. M. (Juriste) 2. S. B. specialist 3. F. K. specialist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 233 datë 17.10.2022 1.S. Xh. (Kryetar) 2.G.C.(anëtar) 3.D. S.(anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 5,400,000 lekë pa T.v.sh për 6 lote.	6.Oferta fituese: 1.A. me vlerë 1,841,250 lek pa T.v.sh. 2. G. me vlerë 900,000 lekë pa t.v.sh.	7.Diferenca me fondin limit 2,658,750 lekë (pa T.v.sh)
8. Data e hapjes së tenderit: 21.10.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit: Të ardhurat	10.Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës në tender:5 OE Për çdo lot b)S'kualifikuar: 0 c)Kualifikuar 5 OE, për çdo lot
11. Ankimime AK. S'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK. S'ka	Titullari i AK Znj. D. P.

a. Në lidhje me llogaritjen e fondit limit;

Sa i përket llogaritjes së fondit limit u evidentua se për procedurën objekt prokurimi, është ngritur grupi i punës me urdhër nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, me nr.2136/2, datë 10.10.2022,për hartimin termave të referencës për hartim plane menaxhimi, ka kërkuar oferta financiare nga tre subjekte. **Fondi limit nuk është detajuar por është marrë në vlerë totale, veprime jo në përputhje me VKM nr. 285** datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nga llogaritja e mesatares së ofertave të paraqitura u evidentuan shumat e fondit limit si në tabelën vijon;

Me shkresë nr.2135/2, datë 07.10.2022 drejtuar operatorit T.

Me shkresë nr. 2135/3, datë 07.10.2022 drejtuar operatorit A.

Me shkresë nr.2135/4, datë 07.10.2022, drejtuar operatorit E....

Nr	Loti / Objekti	Fond Lekë	Limit pa t.v.sh
1	Loti I Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit “Shtigjet në rrjetin e zonave të mbrojtura: Studimi, përmirësimi, mirëmbajtja, markimi dhe hapja e shtigjeve të reja, përgatitja e aplikacioneve, për aksesin e tyre online”.		900,000
2	Loti II Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Monument natyre: Ujërat Termale të Bënjës, Shpella e Pëllumbave dhe Kanioni i Lengaricës_VKM nr.676 datë 15.01.2002		900,000
3	Loti III Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Monument natyre: Syri i kaltër i Kapresë, Pragu i Kapreit, Vaskat e lumit Kapresë Shkoder_VKM nr.676 datë 15.01.2002		900,000
4	Loti IV Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Liqeni Kallabakut në Parkun Natyror “Korab-Koritnik”		900,000
5	Loti V Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Destinacioni turistik: "Steblevë dhe Liqeni Fushë-Studen në Parkun Kombëtar Shebenik”.		900,000
6	Loti VI Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e një segmenti nga Çezma e Tarikos – Ujëvara e Sotirës		900,000
	Total		5,400,000

b. Hartimi i DST

Nga Autoriteti Kontraktor AKZM, me urdhër nr.234, datë 10.10.2022, është ngritur grupi i punës për hartimin e DST. Nga grupi i punës për hartimin e DST-ve. në datë 15.11.2022 është mbajtur paraprakisht procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe në vijim janë hartuar dhe aprovuar nga Titullari i AK, DST për publikim në sistemin e APP.

Në lidhje me plotësimin e DST për të gjitha lotet u konstatua se, është respektuar pjesërisht pika 3/c. e nenit 15, VKM 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” ku informacioni specifik që kërkohet të plotësohet nga AK është si në pikën poshtë vijon:

Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

a) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- **termat e referencës;**
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

Për sa më sipër, u konstatua që në lidhje me plotësimin e kërkesës së parë të pikës 3/c, a) **Termat e Referencës**, në DST, nuk kishte të plotësuar dokument ku të specifikonte të detajuar: *Përshkrim të përgjithshëm, qëllimin, duke dhënë një analizë të situatës dhe pozicionin gjeografik për secilin lot, bazën ligjore mbi të cilën do të zhvillohej detyra, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare që duhen ndjekur e mbajtur parasys, detyrat dhe nen detyrat që duhet të realizojë, rreziqet dhe menaxhimi i tyre, mënyra e monitorimit të raportimit dhe aprovimit, kërkesat për personelin dhe kualifikimet e tyre.*

Nga grupi i punës për hartimin e DST, në shtojcën 7 e cila është detyrim nga AK për tu plotësuar, u evidentua plotësimi si më poshtë vijon:

Shtojca 7 ”Termat e Referencës”.

Detyrat:

Hartimi i termave të referencës do të kryhet **për secilin lot konform legjislacionit në fuqi.**

Çdo operator ekonomik fitues në çdo lot duhet të dorëzojë pranë AK, materialet e përgatitura në hard cope në dy kopje dhe një kopje CD në format të editueshëm.

Çdo operator ekonomik fitues në çdo lot duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- **Hartimi i Termave të Referencës.**

Për sa më sipër, specifikojmë në lidhje me kërkesën e parë të shtojcës 7 në DST; **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve**, plotësimi është bërë pjesërisht duke dhënë vetëm informacion për objektin në lidhje me qëllimin për secilin lot ”Hartim terma Reference” objekti i Termave ka tipologji të ndryshme. Pa përshkrim të qëllimit nga AK, Ofertuesi merr qartësi jo të plotë së çfarë duhet të arrijë dhe si duhet të ndërtojë objektiva të përgjithshme dhe specifike në përmbushje të **qëllimit**

të shërbimit kur vetë qëllimi i shërbimit është jo shumë i plotë. **Pra jepet objekti dhe qëllimi** jo shumë i detajuar.

Nisur nga konstatimi i mësipërm plotësimi i shtojcës 7, të DST nuk është bërë në përputhje me pikën 1, të Neni 41, të VKM 285, datë 19.5.2021, “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” ku citohet: **Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti Kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike**

Mosplotësimi sipas kërkesës ligjore pjesërisht të mësipërme ka sjell paqartësi në vendosjen e kërkesave të veçanta të DST ku sipas pikës 2.3 **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Numri mesatar i punonjësve të siguruar (punonjës dhe staf drejtues) duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) për periudhën Qershor 2022 – Gusht 2022. Për këtë të paraqiten në listë pagesën e shoqërisë për muajt e sipërcituar, ku të figurojnë të regjistruar.

Për stafin e sipërcituar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës/shërbimit, diplomat, CV.

Argumentimi i numrit minimal prej 5 punonjësish si dhe llojit të profesionit nuk ka një **argument teknik** i cili të justifikojë sipas loteve dhe natyrave të ndryshme të TOR. Kërkesa është e njëjtë për çdo lot. Kjo nuk përmbush kërkesën e pikës 3, të nenit Neni 42 të VKM 285, datë 19.5.2021, “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, ku citohet: **Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti Kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e lotit.**

Për veprimet dhe mosveprimet sipas kërkesave të nenit 42, të VKM 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mbajnë përgjegjësi Komisioni i Hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit të urdhëruar sipas Urdhrit nr. 234, datë 10.10.2022.

Auditimi mbi vlerësimin e procedurës.

Për **Loti I** Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit “**Shtigjet në rrjetin** e zonave të mbrojtura: **Studimi, përmirësimi, mirëmbajtja, markimi dhe hapja e shtigjeve të reja**, përgatitja e aplikacioneve, për aksesin e tyre online”, kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 subjekte të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST. OE, kanë dorëzuar ofertat financiare si më poshtë vijon:

Operatorët Ekonomik	Ofertat financiare
G.	450.000
A.	455.000
K.	550.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 1 OE “**G.**” me ofertë ekonomike 450,000 lekë pa t.v.sh.

Loti II Hartimin e termave të referencës *për hartimin e projektit të zbatimit Monument Natyre: Ujërat Termale të Bënjës, Shpella e Pëllumbave dhe Kanioni i Lengaricës- VKM nr.676 datë 15.01.2002.* Kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 OE të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST.OE, kanë dorëzuar ofertat financiare si më poshtë vijon:

Operatorët Ekonomik	Ofertat Financiare
A.	454.200
G.	500.000
K.	540.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 2 **OE A. shpk**, me ofertë ekonomike 454.200 lekë pa t.v.sh.

Loti III Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Monument Natyre: Syri i Kaltër i Kapresë, Pragu i Kapreit, Vaskat e Lumit Kapresë-Shkodër-VKM nr.676, datë 15.01.2002. Kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 OE, të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST. OE, me ofertat financiare si më poshtë vijon:

Operatorët Ekonomik	Ofertat Financiare
K.	450,500
A.	540,000
G.	651.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 3, **K. shpk**, me ofertë ekonomike 450.500 lekë pa t.v.sh.

Loti IV Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Liqeni Kallabakut në Parkun Natyror “Korab-Koritnik”. Kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 OE, të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST. OE, me ofertat financiare si më poshtë vijon:

Operatorët Ekonomik	Ofertat Financiare
A.	465.250
G.	490.000
K.	540.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 4, OE A. shpk, me ofertë ekonomike 465.250 lekë pa t.v.sh.

Loti V Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Destinacioni turistik: "Stëblevë dhe Liqeni Fushë-Studen në Parkun Kombëtar Shebenik". Kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 OE, të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST. OE, me ofertat financiare si më poshtë vijon;

Operatorët Ekonomik	Ofertat Financiare
A.	459.000
K.	560.000
G.	652.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 5, OE A. shpk, me ofertë ekonomike 459.000 lekë pa t.v.sh.

Loti VI Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e një segmenti nga Çezma e Tarikos – Ujëvara e Sotirës. Kanë dorëzuar në SPE ofertat 5 OE, të cilat janë pranuar dhe kualifikuar sipas kërkesave të DST. OE, me ofertat financiare si më poshtë vijon:

Operatorët Ekonomik	Ofertat Financiare
A.	462.300
G.	550.000
K.	550.000
S.	660.000
I.	870.000

Nga KVO, është propozuar si fituese për Lotin 5, **OE A. shpk**, me ofertë ekonomike 462.300 lekë pa t.v.sh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezultoi që vlerësimi është kryer në përputhje me kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të DST.

Nga AK janë nënshkruar dhe lidhur kontratat sipas loteve si në tabelën më poshtë vijon;

Nr	Loti / Objekti	Subjekti i Kontraktuar	Vlera e Kontratës pa t.v.sh
1	Loti I Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit "Shtigjet në rrjetin e zonave të mbrojtura: Studimi, përmirësimi, mirëmbajtja, markimi dhe hapja e shtigjeve të reja, përgatitja e aplikacioneve, për aksesin e tyre online",	G.	450.000
2	Loti II Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Monument natyre: Ujërat Termale të Bënjës, Shpella e Pëllumbave dhe Kanioni i Lengaricës_VKM nr.676 datë 15.01.2002	G.	450.500 454.200
3	Loti III Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Monument natyre: Syri i kaltër i Kapresë, Pragu i Kapreit, Vaskat e lumit Kapresë_Shkoder_VKM nr.676 datë 15.01.2002	A.	450.500
4	Loti IV Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Liqeni Kallabakut në Parkun Natyror "Korab-Koritnik"	A.	465.250
5	Loti V Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit Destinacioni turistik: "Steblevë dhe Liqeni Fushë-Studen në Parkun Kombëtar Shebenik",	A.	459.000
6	Loti VI Hartimin e termave të referencës për hartimin e projektit të zbatimit për ndërtimin e një segmenti nga Çezma e Tarikos – Ujëvara e Sotirës	A.	462.300
	Total		

Për veprimet dhe mosveprimet sipas kërkesave të Neni 41, pikës 3, të nenit 42, të VKM 285, datë 19.5.2021, "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, mbajnë përgjegjësi Komisioni i Hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit të urdhëruar sipas Urdhrit nr. 234, datë 10.10.2022. A. M, S.B. dhe F. K.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në Raport Përfundimtar Auditimi është paraqitur observacioni datë 10,03,2025 protokolluar në KLSH me nr.1125/19 datë 10,03,2023, për të cilin japim sqarimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit të audituar

Subjekti audituar ka sjellë dokumentacion mbi rekomandimet e lënë në Projekt-Raport, si dhe urdhrat e ngritur nga titullari për fillim e marrjes së masave dhe përmirësimin e gjendjes së subjektit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se: Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi i mori në konsideratë pjesërisht dhe u reflektuan në Raport Përfundimtar të Auditimit.

7. Procedura me objekt: "Punime zbatimi- ndërhyrje në shtegun ish-rezervat Liqeni Bovillës". Nga auditimi i kësaj procedure u evidentua se AK, ka përdorur procedurën e prokurimit "punë", me fond limit 25.000.000 (njëzetë e pesë milion) lekë pa T.V.SH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, shpallur fitues Operatori Ekonomik K. Shpk, me ofertën 19,456,362 lekë pa T.v.sh, diferenca me fondin limit në shumën 5,543,638 lekë (pa T.v.sh).

Të dhënat e përgjithshme për procedurën e prokurimit:

Procedura me objekt: Punime zbatimi- ndërhyrje në shtegun ish-rezervat Liqeni Bovillës		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 191, datë 20.05.2024	2.Njësia e prokurimit: 1.A. M. 2.G.C. 3. F. K.	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave: Urdhër nr. 198 datë 28,05,2024 1.S. Xh. (Kryetar) 2.K. U. (anëtar) 3.S. B. (anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Punë"		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 25,000,000 (njëzetë e pesë milion) lekë pa T.V.SH	6.Oferta fituese: K. shpk 19,456,362 (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh	7.Diferenca me fondin limit 5,543,638 lekë (pa T.v.sh)
	9. Burimi Financimit:	10.Operatorët Ekonomikë

8. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2024ora 10:00	Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit	a)Pjesëmarrës në tender:6 c) Kualifikuar; 3
11. Ankimime AK. S'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK. S'ka	Titullar i AK

a. Hartimi i fondit limit

Në zbatim të nenit 77, të VKM-së, VKM 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në vitin 2023 është kryer hartimi i projektit të zbatimit “Shtigje në rrjetin e zonave të mbrojtura”. Pas përfundimit dhe dorëzimit të projektit është hartuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Urdhri i prokurimit nr.191, datë 26.05.2024 duke përcaktuar objektin e prokurimit me limitet e buxhetit dhe njësinë e prokurimit. Grupi i punës i ngritur për hartimin e DST, ka mbajtur paraprkasht procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe në vijim janë hartuar DST për publikim në sistemin e APP.

b. Hartimi i Dokumenteve Standarde

Lidhur me kriteret e vendosura për kualifikim, nga analizimi i kërkesave të vendosura u konstatua që në kërkesën e vendosur në DST:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik ndërtimi
- 1 (një) Teknik gjeometër
- 1 (një) Teknik mekanik
- 1 (një) Elektricist
- 1 (një) Montues Konstruksione
- 1 (një) Punonjës karpentier
- 1 (një) Saldator
- 1 (një) Punonjës auto makinistë

Elektricisti, rezulton se nga lloji i punimeve të kryera nuk ka qenë i domosdoshëm. Si rrjedhim kërkesa e vendosur nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, ku citohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti Kontraktor kërkon një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës”.

b. Procedurat e Vlerësimit nga KVO

Nga hapja elektronike në sistemin e APP rezultuan të ishin emrat e operatorëve me oferta ekonomike si më poshtë:

Nr	Operatorët Ekonomik	Oferta financiare
1	2.	24,250,350.6 lekë pa t.v.sh
2	K.	19,456,362 lekë pa t.v.sh
3	A.	23,804,505.6 lekë pa t.v.sh
4	A. shpk	19,656,170 lekë pa t.v.sh
5	L. shpk	21,065,053 lekë pa t.v.sh
6	Xh. shpk	20,682,318.9 lekë pa t.v.sh

KVO e përbërë nga tre anëtarët ka vendosur të s’kualifikojë tre OE, si më poshtë vijon;

1. OE ASI INVEST SHPK

OE nuk përmbush pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta të DST, pasi bilancet vjetore të shoqërisë A. nuk janë shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël;

B.O.E nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik sa i takon kontratave të ngjashme, pasi për kontratën e lidhur me A. dhe T., nuk ka paraqitur faturën tatimore përkatëse. Gjithashtu për kontratën e nën kontraktimit, lidhur mes D. shpk dhe A. nuk është paraqitur kontrata bazë midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

B.O.E nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik pasi shoqëria A. shpk nuk ka kategorinë N.P 12 A-Punime të inxhinierisë së mjedisit;

B.O.E nuk përmbush pikën 2.3.4, e cila kërkon 1 inxhinier ndërtimi strukturat dhe 1 inxhinier ndërtimi Gjeoteknik, në total 2 Inxhinierë. O.E ka deklaruar të njëjtin Inxhinier L. B për të dy profilet e kërkuara, gjë që bie në kundërshtim me pikën 2.3.4 të DST;

BOE nuk përmbush pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të DST, pasi në DST janë kërkuar 2 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton. Në shtojcën për vetë deklaram shoqëria A. ka deklaruar 1 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton, me targë AA861YT dhe Riviera ka deklaruar vetëm 1 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 – 20 ton, me targë AB 733 HT L. Gjë që bien në kundërshtim me kriterin e vendosur ne DST, pasi nuk përmbushet nr. 2 i automjeteve të kërkuara.

O.E nuk përmbush pikën 2.3.11 të DST, pasi shoqëria A. nuk ka licencë kodi III.2.B.

2. OE LIS KONSTRUKSION shpk.

BOE nuk përmbush pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të DST, pasi në DST janë kërkuar 3 Autobot Uji, 5 Minieskavatorë. Në shtojcën për vetë deklaram shoqëria LIS Konstruksion ka deklaruar 1 autobot uji dhe 4 Minieskavatorë. Gjë që bien në kundërshtim me kriterin e vendosur ne DST, pasi nuk përmbushet nr. i mjeteve të kërkuara.

O.E nuk përmbush pikën 2.3.11 të DST, pasi shoqëria M. nuk ka licencë kodi III.2.B aktive.

Referuar kontratës se bashkëpunimit është përcaktuar që OE M... do të realizojë 6.6% të punimeve OE M.

referuar preventivit të paraqitur bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit ka deklaruar që do të realizojë punimet sipas zërave 10-27 në vlerën 1 333 216,5000 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë pikë pesë mijë) lekë. Oferta e paraqitur nga BOE L. & M. është në vlerën 21 065 053,1146 lekë pa T.V.SH (njëzetë e një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e tre presje njëmijë e njëqind e dyzetë e gjashtë) lekë pa T.v.sh. Ndërsa 6.6% e punimeve të deklaruar nga OE M. që merr përsipër, përbëjnë vlerën 1,390,293.5056, e cila nuk përputhet me vlerën e preventivit të deklaruar në kontratën e bashkëpunimit, e cila është 1,333 216,5 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë, pikë pesë).

3. OE XH. SHPK

OE, Nuk përmbush piken 2.3.1 të kapacitetit teknik sa i takon kontratave të ngjashme, nuk përmbushet kriteri i vlerës së kërkuar. Gjithashtu për kontratën e nën kontraktimit, lidhur Bashkinë Tiranë nuk është paraqitur kontrata bazë mes kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, gjithashtu nuk ka miratim nga Autoriteti Kontraktor si nënkontraktor, si dhe nuk është paraqitur Akti i kolaudimit si dhe situacionit përfundimtar.

OE, Nuk përmbushte pikën 2.3.2 të DST pasi për licencën profesionale të shoqërisë nuk ka kategoritë N.P-9A, N.P 12 A dhe N.S 8A;

OE, Nuk përmbush pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 të DST pasi nuk ka deklaruar stafin Inxhinierie dhe Stafin teknik, konkretisht:

1 Inxhinier ndërtimi, profili transport;

1 Inxhinier ndërtimi, profili Strukturist;

1 Inxhinier ndërtimi, profili Gjeoteknik;

1 Inxhinier Elektrik;

1 Inxhinier Mekanik;

1 Inxhinier Mjedisi;

Për stafin teknik ka deklaruar vetëm punonjësin karpentier, pjesën tjetër të stafit nuk e ka, gjë që bie në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DST.

O.E nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik të DST pasi nuk disponon numrin minimal të fuqisë punëtorë prej 60 punonjësve për periudhën Mars-Maj 2024;

O.E nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka dorëzuar Planin e organizimit të punimeve në kantier dhe planin e sigurisë në kantier;

O.E nuk përmbush pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta të DST, pasi në shtojcën 8 ka deklaruar vetëm:

Jelekë 15 copë Faturë Tatimore Nr. 1227/ Dt.11.05.2023 - Në pronësi

Jelekë 40 copë Faturë Tatimore Nr. 1134 / Dt.13.11.2023 - Në pronësi

Doreza punëtorësh mbi 30 copë Faturë Tatimore Nr. 1134 / Dt.13.11.2023 - Në pronësi

Kuti e Ndihmës së shpejtë 1 copë Faturë Tatimore Nr. 19778/ Dt. 30.04.2024 - Në pronësi Minieskavatorë 1 copë.

Pjesën tjetër të mjeteve të kërkuara sipas DST nuk e disponon.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik të APP nuk u evidentuan konstatime të ndryshme nga ato që ka evidentuar KVO.

Në lidhje me këtë procedurë prokurim evidentohen mospërputhje me kriteret dhe kërkesat 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, Si rrjedhim kërkesa e vendosur nuk është në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4;

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi personat e lart përmendur në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura rezultoi se: nuk janë dërguar Kërkesat Buxhetore PBA-së 2021-2023, PBA-së 2022-2024 dhe PBA-së 2023-2025 në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, veprim në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me pikën 7 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave me Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

- Kërkesat buxhetore për PBA-së 2024-2026 nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) dhe sipas formatit standard të miratuar në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026".

-Për vitin 2023 dhe 2024 nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të mjaftueshme nevojat për shtesë fondi për shpenzime operative dhe kapitale.

-Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues nuk janë dërguar në MTM raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të vitit 2021 dhe raportet e monitorimit 4 dhe 8 mujor të vitit 2022 veprime në kundërshtim me paragrafin 41.2 dhe 42 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 10 deri 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa të hartojë Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetur në shqyrtimin e shpenzimeve të mëparshme dhe në përcaktimin e nevojave për të ardhmen në bazë të aktivitetit të planifikuar.

-Të identifikojë prioritetet kryesore për shpenzimet operative dhe kapitale, bazuar në një analizë të detajuar, për të siguruar që ato të jenë të përshtatshme dhe të qëndrueshme në shërbim të aktivitetit të institucionit. Gjithashtu, të dërgojë çdo 4-mujor raportet e monitorimit të vitit buxhetor.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, mbi pasqyrat financiare rezultoi se, nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për regjistrimin e sistemeve në kartelat kontabël, të cilat pasqyrojnë veprimet e kryera sipas dokumenteve vërtetuese, ditari i magazinës, veprime që janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 17 deri 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të mbahet dokumentacioni kontabël përkatës, për të siguruar informacion të saktë financiar.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit për vitin 2023 rezultoi se, kjo procedurë është formale dhe e pa plotë, pasi në fletët e inventarit mungon krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike të aktiveve. Për këtë arsye edhe raporti i komisionit të inventarizimit, i dalë mbi bazën e këtij inventari, i cili shpreh se nuk ka diferenca, nuk është real. Këtë pasaktësi e tregon mos rakordimi i gjendjes së llog. 218 “Inventar ekonomik”, i cili në raportin e inventarizimit paraqitet më pak për 769,197 lekë krahasuar me bilancin dhe e llog. 327 “Inventar i imët” i cili paraqitet më pak për 1,807,339 lekë krahasuar me bilancin, veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30.

-Njësia nuk dispononte një regjistër analitik aktivesh ku përfshihet: data e hyrjes, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të kryera, vlera e akumuluar e amortizimit, etj, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 në faqen 25 deri 26 dhe në faqen 30 deri 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Komisioni i inventarizimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa që procesi i inventarizimit të kryhet sipas fletë inventarit ku bëhet krahasimi gjendjes fizike me gjendjen kontabël të aktiveve si dhe të mbajë një regjistër analitik të aktiveve konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarive të klasës 4 rezultoi se:

-Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi se, kjo llogari në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 3,528,693 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërsa në pasqyrën nr. 5 “Shënime shpjeguese për periudhën raportuese të bilancit” paraqitet në vlerën 148,426,101 lekë.

Nga Drejtoria e Financës nuk u paraqit analizë se kujt i përkasin detyrimet e vitit 2022 dhe mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël e ligjor për heqjen e tyre në fund të vitit 2023. Ndërsa nga auditimi, rezultoi se vlera e detyrimeve të papaguara e të pa kontabilizuara nga kontratat e qirasë, deri në 30.09.2024 është në vlerë të konsiderueshme, në total 397,013,980 lekë.

- Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 11,550,321 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundër parti 468 në aktiv të bilancit, e cila paraqitet me 0 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë

09.03.2018, Aneksi 1 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 në faqet 19, 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të marrë masa për kryerjen e veprimeve korigjuese kontabël në lidhje me pasqyrimin dhe evidentimin e të drejtave dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në pasqyrën e pozicionit financiar.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarive të klasës 2 rezultoi se:

- Gjendja e llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 3,146,500 lekë, për të cilën nuk ka analizë nga se përbëhet, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kap.2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, pika 11.

- Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 32,907,276 lekë, për të cilën është llogaritur norma e amortizimit 10%, ndërkohë që norma e lejuar është 20%, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, Kreu III, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqen 21 deri 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar llogarinë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme” duke specifikuar përbërjen e saj, si dhe të kryejë sistemimet kontabël, pasi të bëjë ri përlllogaritjen e amortizimit me normën 20% të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar” rezultoi se, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në shumën prej 1,084,595,950 lekë. Në Formatin nr. 4 (Pasqyra e Ndryshimeve të aktiveve neto), teprica në çelje e fondeve neto është pasqyruar gabimisht duke iu referuar mbylljes së vitit 2021, në shumën prej 306,793,959 lekë, ndërkohë që duhet të ishte në shumën prej 805,735,096 lekë, sipas mbylljes së vitit 2022. Ky gabim ka bërë që ndryshimet e fondeve neto gjatë vitit 2023 të mos pasqyrohen saktë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018, Kap.3,2 pika 44 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 në faqet 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa të korrektojë pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto në Formatin nr. 4, duke siguruar që të dhënat të jenë në përputhje me pasqyrën e pozicionit financiar dhe me parimet kontabël të pranuar.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, në lidhje me plotësimin e strukturës së miratuar rezultoi se: Në fund të vitit 2023 dhe deri në 30.09.2024 struktura paraqitet me realizim në masën 92% dhe numri i vendeve të lira të punës është 24 për vitin 2023 dhe 25 për vitin 2024, të cilat janë në nivele menaxheriale, specialistësh dhe rojesh mjedisore, në AKZM dhe AdZM. Administrata ka funksionuar me rreth 92% të kapacitetit të saj, në mosrespektim të Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, Kreu V (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa për plotësimin e vendeve të lira të punës për të siguruar funksionimin efektiv dhe të qëndrueshëm të institucionit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave dhe i përdorimit të tyre, për periudhën prill 2021 – shtator 2024 rezultoi se:

- Për vitet 2022 dhe 2023 nuk ka pasur një planifikim të qartë të projekteve që në fillim të vitit, por projektet janë miratuar vetëm sipas nevojave të identifikuara nga AKZM, AdZM dhe angazhimeve financiare të viteve të mëparshme, veprime në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores “Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit nga të ardhurat e gjeneruara në zonat e mbrojtura” miratuar me Urdhër nr.106, datë 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së.

-Nga të ardhurat e gjeneruara nga zonat e mbrojtura janë kryer shpenzime si: për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, dieta, shpenzime për sigurinë fizike, rreth 24% në vitin 2023 dhe 21% në vitin 2024, shpenzime të cilat duhej të bëheshin nga fondet buxhetore të vitit përkatës, veprime këto në kundërshtim me qëllimet e përcaktuara në pikën 4 të VKM-së nr. 1156, datë 20.12.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 në faqet 27-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Menaxhimit dhe Monitorimit të sigurojnë një planifikim të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke respektuar plotësisht dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Përdorimi i të ardhurave për zonat e mbrojtura të përputhet me rregullat ligjore dhe të sigurojë një rritje të qëndrueshme dhe një menaxhim të duhur të përdorimit të tyre.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për administrimin dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura rezultoi se: për 45 zona të mbrojtura mjedisore janë në fuqi vetëm 14 plane menaxhimi (31% e totalit), ku 4 nga këto plane kanë përfunduar afatin 10 vjeçar të vlefshmërisë në dhjetor të vitit 2024, veprime në mos përmbushje të detyrimit ligjor Kreu V, Neni 42 pika 4 të Ligjit nr. 81/2017.

-Zonat e mbrojtura nuk janë të regjistruara në zyrat vendore të agjencisë shtetërore të kadastrës dhe ende nuk janë ngritur grupe pune për regjistrimin e tyre, duke penguar krijimin e një fondi të përbashkët të sipërfaqeve të mbrojtura në shkallë qarku dhe republike, veprime në kundërshtim me kërkesat e Nenit 55 të Ligjit nr. 81/2017. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa që të përshpejtohet hartimi dhe miratimi i planeve të menaxhimit për të gjitha zonat e mbrojtura, duke siguruar që ato të jenë funksionale përpara skadimit të afateve të planeve. Gjithashtu, në bashkëpunim me AdZM-të të ngrihen grupet e punës për të bërë regjistrimin e zonave të mbrojtura në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim për të garantuar formimin e të sipërfaqeve të mbrojtura.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të veprimtarisë inspektuese për plotësimin e dokumenteve standarde të inspektimit dhe dokumentimin e tyre në portalin unik e-Inspektim rezultoi se:

Gjatë periudhës Dhjetor 2023 - Shtator 2024, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe AdZM Kukës, Berat, Vlorë janë kryer gjithsej 57 inspektime online dhe nga përzgjedhja e 15 prej tyre, rezultoi që 6 raste: AdZM Berat (3 raste), AdZM Vlorë (2 raste) dhe AdZM Kukës (1 rast), kishin mungesë të dokumentacionit shoqërues dhe vërtetues në sistemin e-Inspektim. Inspektorët nuk kanë marrë masa ndaj subjekteve për mosplotësimin e këtij dokumentacioni, pavarësisht se janë verifikuar shkelje dhe mungesa të dokumentacionit të nevojshëm.

- Dokumentacioni shoqërues dhe vërtetues nuk lë gjurmë në momentin e hedhjes së tyre nga inspektorët, çfarë e bën të pa vërtetueshme kohën e hedhjes së tyre në sistemin e-Inspektim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 39-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, AdZM Kukës, Berat, Vlorë, të marrin masa për hedhjen dhe dokumentimin në sistemin e-Inspektim të të gjithë dokumenteve standarde të inspektimit, monitorimin e procesit dhe të vendosjes së masave administrative për çdo rast të konstatuar me shkelje.

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, AdZM-të në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të marrin masa për evidentimin në sistemin e-Inspektim, të kohës së hedhjes së dokumenteve standarde të inspektimit nga inspektorët, me qëllim gjurmimin e kohës së proceseve.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të lidhjes së kontratave të qirasë për përdorimin e sipërfaqeve në zonë të mbrojtur rezultoi: Parregullsi në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues dhe në procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave nga strukturat e AdZM-ve dhe AKZM, veprime në kundërshtim me përcaktimet e kërkesave të pikës 6.8, 6.10 dhe 7 të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2021 të MTM-së “Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to”.

- Mospërputhje midis përshkrimit të objektit të veprimtarisë në kërkesat e subjekteve me atë të dokumentacionit të vlerësuar nga Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

- Sektori i Menaxhimit në AdZM-të nuk ka përcaktuar dhe përshkruar në mënyrë specifike objektin e veprimtarisë së lejuar që do të ushtrohet në zonën e mbrojtur, siç kërkohet në pikën 3/c të VKM-së nr. 1156, datë 24.12.2020 “Për caktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”. Kjo mungesë detajimi krijon paqartësi në klasifikimin e aktiviteteve dhe në përcaktimin e saktë të vlerës së qirasë vjetore.

- Gjatë periudhës janë lidhur 15 kontrata qiraje me afat 10 vjeçar, ku 5 prej tyre janë miratuar nga MTM, veprime në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 1, datë 10.02.2021 të MTM-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 43-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdZM-të në vijimësi, të marrin masa që nënshkrimi i kontratave të qirasë për dhënien në përdorim të sipërfaqeve zonë e mbrojtur, të jetë i shoqëruar me dokumentacionin e plotë dhe në përputhje me akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rregullshmërisë së veprimtarive të lejuara në zona të mbrojtura u konstatuan 784 ndërtime in formale, të cilat janë krijuar kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. AKZM ka njoftuar institucionet ligj zbatuese si IKMT, Drejtorinë e Policisë dhe Prokurorinë e qarkut përkatës, për të gjitha rastet gjatë periudhës 2022- shtator 2024, prej të cilave nuk konfirmohet të kenë kthyer përgjigje zyrtare, duke mos vijuar me procedurat e mëtejshme, me qëllim ndëshkimin sipas ligjit të

subjekteve/personave përgjegjës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdZM-të të marrin masa për të adresuar aktivitetet in formale dhe ndërtimet e paligjshme brenda zonave të mbrojtura, duke krijuar një plan veprimi të detajuar e duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet lokale dhe institucionet ligj zbatuese IKMT, Drejtoritë e Policisë, Prokuroritë e qarkut përkatës dhe të njoftojnë MTM-në, për nxjerrjen e përgjegjësive dhe ndëshkimin e autorëve sipas legjislacionit për zonat e mbrojtura për 784 rastet in formale.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi në SPE dhe dosjes së prokurimit me objekt “Blerje Fidanësh” u konstatua se, subjekti Person Fizik “Gj. U.” sipas ekstraktit në Q.K.B, nuk ka fushën e veprimtarisë së objektit të prokuruar, veprime në kundërshtim me nenin 35, të Ligjit nr.162/2020 të “Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe nenit 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit” të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Njësia e Prokurimit në kërkesat teknike të DST-së ka vendosur kriteret të pa argumentuara ligjërisht dhe teknikisht. Në pikën 2.3.3 të DT, kërkohet që operatori ekonomik pjesëmarrës, “duhet të ketë pjesë të stafit teknik në licencë të shoqërisë” dhe të punësuar tre muaj të fundit 1 (një) Agronom dhe 1 (një) Inxhinier pyjesh. Sa më sipër konstatua se, ky kriter kualifikues (2.3.3), nuk është në përputhje me natyrën e objektit e prokurimit (Blerje mallrash), duke larguar në mënyrë të padrejtë nga konkurimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe duke favorizuar drejtpërdrejtë OE që disponojnë licenca shoqërie për punime ndërtimi apo jo të përcaktuara sipas DT, kjo në kundërshtim me ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 2 dhe me VKM nr.285, datë 19.5.2021, neni 78 pika 1 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.-

- Në lidhje me vlerësim e ofertave KVO ka kualifikuar OE “A.” sh.p.k dhe “Xh.” sh.p.k, ku ka shpallur fitues OE “A.” Sh.p.k, me vlerë 9,375,000 lekë pa t.v.sh, datë 04.11.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të OE “A.” sh.p.k konstatohet se, nuk disponon asnjë licencë të stafit teknik siç kërkohet në DT. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 55-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa që çdo kriter i veçantë i vendosur duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime, i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi në SPE dhe dosjes së prokurimit me objekt:

“Studim mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave, duke përfshirë statusin e mbrojtjes në varësi të rëndësisë, si dhe nën zonimin përkatës”, datë 15.09.2023, me fond limit 13,816,666 lekë pa T.v.sh, konstatua se, në përllogaritjen e fondit limit, AK ka marrë tre oferta financiare duke mesatarizuar ofertat.

- Nga grupi i ngritur për justifikimin e fondit limit për procedurën “Hartimi i Planeve të Integruara të Menaxhimit” nuk është kërkuar që ofertat e tregut të shoqërohen me analiza të kostos për këtë shërbim, ndërkohë referuar Termave të Referencës zërat e kostos janë të përbërë nga kosto ekspertësh, kosto administrative dhe kosto aktivitetesh.

- Gjithashtu referuar ekstrakteve në QKB, këta ofertues, kanë në fushën e veprimtarisë kryesisht projektme inxhinierie dhe mbikëqyrje kolaudime, por në kohën e studimit të tregut nuk dispononin ekspertët për hartimin e ofertave të sakta për përllogaritjen e fondit limit.

- Në lidhje me vlerësim e ofertave, nga KVO konstatohet s'kualifikim i padrejtë në Fazën I të OE "T." sh.p.k për arsye se, eksperti biolog - për faunën nuk ka paraqitur eksperiencën të ngjashme të punës me faunën dhe eksperti peshkim nuk ka asnjë eksperiencë pune apo studimi në fushën e akuakulturës, të cilat nuk ndikojnë në fazën I të vlerësimit referuar DT.

- Nga KVO për ofertuesin e shpallur fitues "I." sh.p.k kriteri për stafin kryesor të propozuar është vlerësuar me 46 pikë, ku KVO citon se disa nga ekspertët e propozuar nuk kanë kualifikimet akademike apo eksperiencën e kërkuar.

-KVO ka vepruar me 2 standarde në vlerësimin e ofertave, ku ka s'kualifikuar padrejtësisht që në fazën e I, OE "T." sh.p.k për mangësi të cilat nuk përbëjnë shkak për mos kalimin e fazës së II të propozimit teknik dhe vetë KVO konstaton se OE i shpallur fitues ka të njëjtat mangësi si OE "T." sh.p.k. në kundërshtim me DST, neni 92 i ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 68-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa për të dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për hartimin e fondit limit të kontratave duke studiuar tregun, çmimet e kontratave të mëparshme, çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht, me qëllim përcaktimin e vlerës sa më reale të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me dy procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2023, me objekt "Shërbime për hartimin e termave të referencës", me një vlerë totale prej 7,227,472 lekë pa T.v.sh, janë realizuar dy procedura të ndara në lote: "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartimin e planeve të menaxhimit" me një vlerë prej 4,866,222 lekë pa T.v.sh dhe "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartimin e planeve të menaxhimit" me një vlerë prej 2,741,250 lekë pa T.v.sh. Në lidhje me llogaritjen e fondit limit, Agjencia Kombëtare (Autoriteti Kontraktor) ka marrë tre oferta financiare dhe i ka mesatarizuar ato. Grupi i ngritur për justifikimin e fondit limit, nuk ka kërkuar në ofertat e tregut analizë sipas zërave të kostos të përcaktuar në shtojcës 7 në DST Termat e Referencës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 në faqet 74-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa që çdo kriter i vendosur duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës sipas Termave të Referencës me qëllim përcaktimin e vlerës sa më reale të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

C . MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 gërma (b) dhe (c) Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nga ana e Titullarit të Institucionit të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim arkëtimin e vlerës së dëmit prej 4,973,060 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së lidhjes së kontratës së qirasë me subjektin "S." sh.p.k. me Nipt J.....N, Kontratë nr.124 prot., datë 12.06.2021 me afat 10- vjeçar me të drejtë rinovimi, me objekt: "Për përdorim sipërfaqen 2.2 ha fond pyjor publik, në zonë të mbrojtur PK "Lugina e Valbonës" dhe Amendim Kontrate nr.134 prot., datë 09.05.2022 rezultoi

llogaritje e gabuar në ndarjen e sipërfaqes sipas planit të zhvillimit dhe projektit teknik për çdo njësi shërbimi, dhe si rrjedhim dhe diferencë për t'u paguar në vlerë 1,471,640 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me AdZM Kukës të marrin masa, si dhe të ndjekin të gjitha hapat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e plotë të vlerës 1,471,640 lekë nga subjekti "S." sh.p.k.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në SPE dhe dosjes së prokurimit me objekt; "*Hartime Planesh të Integruara të Menaxhimit, ndarë në lote*": datë 15.10.2021, Loti I "Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për Parkun Natyror "Liqeni i Shkodrës", me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh dhe Loti II Hartimi i planit të integruar të menaxhimit për Parkun Kombëtar "Mali i Tomorit", me fond limit 12,500,000 lekë pa t.v.sh u konstatua s'kualifikim i padrejtë i BOE "A." sh.p.k & "T." sh.p.k, pasi referuar Dokumenteve të Tenderit, citohet se: kriteri 2.3.2, do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetë deklarimit sipas shtojcës 9, Në vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, u konstatua se nuk janë vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë. KVO e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e shërbimit me një vlerë me të lartë ekonomike.

Nga kualifikimi i OE "I." sh.p.k dhe s'kualifikimit të padrejtë të BOE "A." u konstatua se veprimet KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor këtij të fundit në vlerën 600,000 lekë (11,200,000 – 10,600,000) si diferenca midis ofertave të BOE në klasifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" neni 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2, faqe 59-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ligjore e financiare të nëpunësve, të cilët kanë kryer veprime në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, me qëllim që të vlerësojnë e të analizojnë shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën prej **600,000 lekë** në dëm të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike me objekt "*Ndërtim i Hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur "Syri i Kaltër"*" sipas kontratës për punë publike me nr.665 prot., datë 28.04.2022 midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, dhe sipërmarrësit "F." sh.p.k, me vlerë të kontratës 33,999,593 lekë me T.V.SH, u konstatuan disa pasaktësi me përfitim të padrejtë të sipërmarrësit të punimeve. Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e zbatimit, tabelës së lëvizjes së volumeve dhe situacionit përfundimtar, kanë rezultuar disa pasaktësi në përlllogaritjen e volumeve të punimeve, të cilat rezultojnë të paguara në situacion përkatësisht për zërin 1 nr. 3,104/b "*Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet*", është paguar në situacion në sasinë 3,577 m³. Ndërkohë, deklarohet i realizuar edhe zëri "*Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri*" me një lartësi 8 cm ose 0.087 m në gjithë sipërfaqen e parkimit prej 5,388 m², në volum prej 468.8 m³ mbushje. Referuar Urdhër ndryshimit, projektit të azhurnuar dhe librezës së masave, sipërmarrësi ka shtuar edhe shtresën e dytë të çakëll t=20 cm, duke realizuar në total 5,388 m² sip parkimit x 2 shtresa = 10,776 m². Referuar përlllogaritjeve të realizuar nga sipërmarrësi, projektit të azhurnuar, kuotave të tokës, argumentimit në kërkesën për ndryshim citohet se ekziston thellësi deri në 1.5 m dhe se zëri nr. 1 "*Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria IV, me shkarkim në mjet*", në sasinë prej 3,577 m³, rezulton i pasaktë, i paargumentuar dhe i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 450 lekë/m³, rezulton vlera prej 1,609,650 lekë e përfituar padrejtësisht. Gjithashtu, Zëri 3 nr. 2.37/5a "*transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5 km*", është

përlllogaritur në të njëjtën sasi të gërmimit të dherave prej 3,577 m³ për transportin e gërmimeve, e cila përsëri është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 250 lekë/m³, rezulton vlera prej 808,200 lekë e përfituar padrejtësisht. Si përfundim sipërmarrësi OE "F." sh.p.k, ka përfituar më tepër vlerën 2,417,850 lekë pa t.v.sh (1,609,650 lekë + 808,200 lekë) ose 2,901,420 lekë me T.v.sh, për punime të pakryera, në kundërshtim me pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve" i ndryshuar dhe Nenin 7 dhe 12 të Ligjit Nr.8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 71-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **2,901,420 lekë**, dëm ekonomik nga kontraktori "F." sh.p.k, për punime të likuiduara, por të parealizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria/Spektori i Monitorimit në AKZM dhe AdZM-të, bazuar në Ligjin nr. 81/2017 dhe VKM-së, nr. 128, datë 13.02.2020 "Për caktimin e vlerës së dëmit", për periudhën Janar 2022 deri më 30.09.2024 ka kryer 636 inspektime dhe sipas procesverbaleve të mbajtur në vend, ka vlerësuar me dëm vlerën prej 590,457,704 lekë, përkatësisht detajuar: nga zjarret 157 raste me vlerë 260,795,000 lekë dhe nga veprimtaritë e kundërligjshme (prej drurësh, gurë dekorativë, etj.) 479 raste me vlerë 329,662,704 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se kjo vlerë nuk është kontabilizuar si detyrim dhe nuk është arkëtuar për periudhën objekt auditimi, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Monitorimit/Inspektimit dhe Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Institucionet ligj zbatuese si, IKMT, Drejtoria e Policisë dhe Prokuroritë e rrethit përkatës, të marrin të gjitha masat administrative dhe ligjore me qëllim arkëtimin e plotë të vlerës së dëmit në shumën prej 590,457,704 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga administratat rajonale të zonave të mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, deri në 30.09.2024 janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje, për dhënie në përdorim të sipërfaqeve në zonë të mbrojtur, ku nga auditimi u konstatua se, 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë rezultuan me detyrime të papaguara dhe të pa kontabilizuara, përkatësisht: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë (16 në proces gjyqësor, 4 kallëzim penal, 7 në negociatë për lidhje akt marrëveshje) dhe 26 HEC-e me detyrime të papaguara në vlerë 367,508,531 lekë (25 në proces gjyqësor, 1 kallëzim penal), të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 41-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të bashkëpunojnë nëpërmjet komunikimit zyrtar me institucionet ligj zbatuese si Gjykatë, Prokurori

përkatëse, për ndjekjen e 53 subjekteve në vlerë 397,013,980 lekë, deri në daljen e vendimit përfundimtar, me qëllim arkëtimin e plotë të vlerës së detyrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administratat e Zonave të Mbrojtura, gjatë periudhës dhjetor 2023-shtator 2024 janë realizuar 57 inspektime online. Për këto inspektime janë vendosur masa administrative në formën e gjobave, të cilat arrijnë në një vlerë totale prej 2,750,000 lekë. Përveç kësaj, janë vendosur dënime plotësuese me një vlerë prej 1,034,800 lekë. Nga ky total, është arritur të arkëtohet shuma prej 860,000 lekë, ndërsa mbetet e pa arkëtuar shuma prej 2,924,800 lekësh, që përfshin dëmin dhe gjobat e vendosura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 39-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria e Financës të ndërmarrin masa administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e plotë të shumës prej 2,924,800 lekë dhe të ndjekin procedurat ligjore për nxjerrjen e titujve ekzekutivë dhe realizimin e pagesave për shumën e papaguar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT